

BIBLIOTEKA
SHTETIT

81H-32
V 79

Gjergj Vlashi

TE
SHTUNEN
PASDITE

tregime

814-32

V.F.G.

GJERGJ VLASHI

TE SHTUNEN PASDITE

— Tregime e novela —



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

TE SHTUNEN PASDITE

Kur trokiti xhami, unë po shkruaja diçka në regjistër. Ishin dy trokitje të lehta, të shkurtëra, sikur xhamin e kishte prekur sqepi i një zogu. E njoha dorën e Lindës. Vazhdova të shkruaja. U përpoqa të jem sa më i përqëndruar. Ajo trokiti edhe dy herë të tjera. Pastaj ngrita kokën.

— Do të nisemi? — tha ajo. Zerin s'e dëgjova mirë, por e kuptova nga lëvizja e buzëve.

— Edhe pak, — thashë pa nxjerrë zë. Lëviza vëtëm buzët. Pse ta fsheh: më pëlqente ta ngacmoja Lindën.

Vazhdova të shkruaja. Ajo trokiti prapë. Nuk e ngrita më kokën. Mbarova faqen e regjistrat deri në fund, pastaj hodha sytë në dritare. Ajo nuk ishte më aty.

U takuam në oborrin e shkollës. Ajo mbante për dore bicikletën e saj të vjetër. Në portabagal kishte vënë çantën e saj të zezë, që unë e quaja me tallje «macja». Kishte mbërthyer deri në fyt paradesynë, kurse flokët i kishte mbledhur me një skufe të bardhë, që e tregonte shumë të re.

— Qenke bërë si njeriu në këllëf, — i thashë.

Ajo vuri buzën në gaz dhe më pyeti:

- Nuk e ke marrë bicikletën?
- Të tjerët ikën?
- Kanë ikur. Jemi të fundit.
- Do t'i arrijmë.

Ndeza një cigare dhe nisa ta thith i aetë. Ajo më shikoi e habitur, pastaj pyeti:

- Ku e ke bicikletën?
- Në stallë.

— Ohu, edhe ti, Kadri, gjithnjë ke qejf të talllesh, — tha me qortim. Sa herë nxehet pak, më thërriste Kadri, sepse zakonisht më thërriste me atë nofkën idiote të fëmijërisë, «Çili».

Oborri ishte i qetë. Nga gjithë zhurmat e zërat e fëmijëve nuk kishte mbetur asgjë. Vetëm diku, në ara, ulërinte një traktor dhe dy gra diç i thoshin njëra-tjetrës, duke folur nga një oborr në tjetrin.

Kaluam nëpër sheshin e ri të fshatit. Dyqani ishte plot me njerëz. Nga dritaret pashë se në klub kishte shumë kooperativistë, që pinin kafe, konjak ose luanin domino. Dy të rinj kishin hipur në çatinë e shtëpisë së kulturës dhe po rregullonin antenët e televizorit, që e kishte shtremberuar era.

— Sonte, në televizor, jepet filmi «Më fal», — tha Linda, duke ecur pranë meje me bicikletën e saj të vjetër.

Unë nuk fola. Dëgjoja zinxhirin e bicikletës së saj që gërvallej.

— Do ta shohësh? — më pyeti ajo.

— Jo. Të shtunën nuk kam dëshirë të trishtohem me kësi filmash idiotë.

Ajo më shikoi e habitur. E dija se asaj i pëlqenin filmat melodramatikë dhe nuk e zgjata. Isha grindur nga dy herë me të pér filma të këtij lloji, por e kisha kuptuar se nuk i mbushej mendja.

Tek stallat e reja pamë disa vajza që mbartnin kovat me qumësht e që qeshnin njëra me tjetren. Disa prej tyre na e bënë me dorë. Njoha Bedrijen, mjelësen e bukur, që, sa herë e shikoja rrugës, m'i ngulte sytë... Isha matur ta ndaloja, por nuk e di as unë se si nuk më është bërë mbarë. «Javën tjetër do ta ndaloj», — vendosa me vete dhe u mëshova pedaleve.

— Sa është ora? — pyeta Lindën, që ishte prapa meje.

— Katër. Ka filluar të zgjatet dita.

— E mora me mend që kështu do të thoshe. Kemi tre vjet në këtë shkollë dhe në shkurt ti thua: ka nisur të zgjatet dita, kurse në shtator: ka nisur të shkurtohet!

E pashë që u mat të thoshte diçka, por atë çast rrota e parë i ra në një gropë dhe bijikleta u drodh e lëshoi një zhurmë të shkurtër, të shurdhët.

— Kujdes, se mos rrëzohesh. Hap sytë, se do të të bjerë macja e zezë rrugës.

Kësaj here Linda zuri të qeshë. Ajo ishte e urtë dhe kurrë nuk nxehet me gjithë mend. Nuk ishte e bukur, por ishte kaq e mirë dhe e padjallëzuar, sa të bënte për vete. Gjatë atyre viteve që isha mësues në atë fshat, shoqërohesha shumë me të. Shpesh shkonim e ktheheshim nga fshati bashkë. Unë nuk e mbaj veten për djale të urtë me vajzat, por me Lindën kurrë nuk më kishte vajtur mendja për keq. Ajo e dinte këtë dhe kishte besim të madh tek unë. Ndonjë mësues, në fillim, pandehte se në mes tonë kishte diçka, por pastaj bindej se nuk ishim veçse shokë. Të shtunave ktheheshim në qytet me bijikleta,

herë me të tjerët e herë na qëllonte të shkonim edhe vetëm, sikurse tani.

Ishim larguar disa kilometra nga fshati, kur vura re se Linda mbetej më prapa se herët e tjera, megjithëse unë nuk nxitoja.

— Ç'ke, Linda? — i thirra.

— Nuk e di, Çili, më kërcet shumë zinxhiri.

— Kur të shkosh në shtëpi, lyeje me vaj, po mos të jetë vaj kikiriku.

Ecëm edhe pak. Posa kaluam kanalin e ri kuillues, dëgjova një krismë të thatë dhe Lindën që lëshoi një thirrmë të mbytur.

— C'pate?

— M'u këput zinxhiri.

— Me shëndet!

Zbrita nga bicikleta dhe i shkova pranë. Kishte qëndruar në mes të rrugës dhe shikonte zinxhirin e varur. Fytyra i ishte skuqur. Kishte varur buzët dhe dukej sikur nga një çast në tjetrin do të niste të qante. Ngjante si ndonjë fëmijë, të cilit i është prishur lodra. Të dy shikuam disa çaste zinxhirin e këputur.

— Ç'do të bëjmë tani, Çili? — pyeti ajo.

— Do të flemë në mes të rrugës.

— Ohu, dhe ti, mendjen tek shakatë e ke...

— Po fillove të qash, unë ika e të lashë këtu, kuptove?

Ajo vuri buzën në gaz. Ishte një buzëqeshje e sforcuar...

— Jemi larg rrugës automobilistike, — tha ajo.

— E di.

Hodha sytë anash. Atje tej ishte një shtëpi e re njëkatëshe, me mure të bardha e tjegulla të kuqe.

— Kush rri në atë shtëpi? — e pyeta.

— Nuk e di. Pse?

— Të lemë bicikletën tënde të prishur. Të hënën sill me vete një zinxhir të ri dhe merre prapë. Ajo nuk foli. Vura re se kishte diçka, që ende nuk e kuptonte.

— Mirë, e lemë, po... unë?

— Ti do të hipësh në bicikletën time dhe do të kthehem bashkë në qytet.

Ajo nuk foli. E kuptova menjëherë se propozimi im ju duk i çuditshëm. I vinte zor të hipte në një bicikletë me mua. Megjithëse e dhashë atë mendim, tani që Linda heshti, edhe mua se si m'u duk. Megjithatë, thashë:

— Hajt, se nuk ka asgjë të keqe.

Ato fjalë pjesërisht ja drejtova edhe vetes.

Tek gardhi thirra. Doli një grua e ngjallur. Nuk e kisha parë ndonjëherë. I tregova si ishte puna. Ajo më dëgjoi dhe nuk bëri zë. Në sallonin e vogël, që ishte në hyrje, pashë një pikture muri. Ishte paraqitur një barkë me vela, që lundronte në një liqen të qetë. Hëna shkëlgente mes resh të bardha. Pranë kallamishteve ishin ulur dy të rinj të përqafuar, që shikonin hënën. Kisha dëgjuar që një piktor matrapaz shkonte fshat më fshat dhe bënte kësi pikturash në faqet e shtëpive të reja.

— Si thua? — e pyeta gruan që më shikonte ftohtë.

— Të pyes burrin, — tha ajo.

— Pyete.

— Po... kur të kthehet. Tani është në qytet.

E humba durimin. Më bënte nevrik edhe dyshimi i kësaj gruaje.

— Biçikleta që do të lemë, nuk do bukë.
— E di, po...

Ktheva kokën. Linda nuk kishte hapur gojë.
Dukej gjithnjë e pikëlluar.

— Keni ndonjë barakë pas shtëpisë? — e pyeta
gruan.

— Kemi.

— Po e le aty deri të hënën. Po të pyeti burri,
thuaji se e kanë lenë dy mësues.

Pa pritur përgjegjen e saj, mora biçikletën e
Lindës, kalova oborrin dhe u futa në barakë, ku
kundërmonte një erë e rëndë.

— Faleminderit, — i thashë gruas së ngjallur,
që vazhdonte të shihte e çuditur. Kur po largohe-
sha, më shkuan sytë edhe një herë te piktura e
murit.

Në fillim ecëm më këmbë. Unë e mbaja biçik-
letën për dore. Linda nuk fliste. Për dreq, unë nuk
kam portabagal dhe duhej ta hipja përpara. Kjo e
bënte edhe më të vështirë punën.

— Hajt, hipë, — i thashë Lindës.

Ajo nuk foli. M'u duk se ishte skuqur. Anova
biçikletën. Ajo vuri këmbët e mbledhura në një krah
dhe me duart shtrëngoi timonin. Çantën e zezë e
vuri mbi timon.

Nisa ta ngas bicikletën. Në fillim edhe për pak
e humba ekuilibrin, por shtrëngova timonin dhe
ecëm mirë.

— Si mos të shkojë udhëtimi ters, kur ke me
vete një «mace të zezë», — thashë për të kthjellu-
ar atmosferën.

— Po unë edhe herë të tjera e kam pasur çan-
tën me vete, — u përgjegj ajo.

Duke ecur, vura re se kisha nisur të lodhesha.

Rruja ishte me gropat dhe unë s'e manovroja lirisht timonin.

Rrugës nuk takuam njerëz, përveç një karroce të kooperativës. Xha Beqiri, karrocieri, na përshëndeti duke ngritur kamxhikun që mbante në dorë. Nuk e pashë me vëmendje, por m'u duk sikur na shikoi i çuditur.

Më në fund, atje tej u duk shiriti i zi i rrugës automobilistike.

— Arritëm, — tha Linda e lehtësuar.

— E shoh, — thashë unë.

Duke kaluar pranë një ndërtese të vjetër, që tē gjithë e quanin «mulli», megjithëse aty kishte zyrat këshilli, pamë një grumbull njerëzish që dolën nga dera e madhe. Ne kaluam para tyre. Padashje u mëshova pedaleve. Ktheva kokën dhe pashë shkarazi disa fytyra të njoitura, por nuk arrita tē përshëndetja njeri.

— Paskan pasur ndonjë mbledhje, — thashë.

— Mbledhjen e këshillit. Ja pashë ftesën drejtorit të shkollës sonë. Edhe ai do tē ketë qenë aty.

— Punë e madhe, — thashë, pasi e kuptova se Linda ishte shqetësuar dhe ai takim nuk i kishte pëlqyer fare.

Dolëm në rrugën automobilistike. Rrotat e bicikletës u fërkuan me asfaltin e zi. Ecja shpejt.

— Tek plepat qëndro, — tha ajo.

— Pse?

— Dë tē shkoj me autobuz.

— Ke frikë mos tē na shohin bashkë. Tani është vonë.

— Është më mirë me autobuz, Çili.

— Si të duash.

Qëndrova tek plepat. Linda kërceu në tokë. U ndamë. Nisa ta ngas biçikletën me shpejtësi. Pas nja njëqind metrash ktheva kokën. Linda ishte pranë stacionit të autobuzit, fill e vetme, me çantën e zezë në dorë. Vazhdova t'u mëshoj pedaleve. Biçikleta gati fluturonte. Era e freskët më rrihte fytyrën.

*

*

*

Që të hënën diç vura re në shkollë, por nuk i dhashë rëndësi. Mërkuri, një mësues me të cilin isha zënë disa herë, se nuk më pëlqente karakteri i tij, më shikoi me vëmendje dhe në fund të syve të tij të vegjël m'u duk sikur pashë një shkëndijë ligësie. Më bëri përshtypje edhe drejtori i shkollës, shoku Maksut. (Thoshin se ky emër nuk i kishte pëlqyer kurrë dhe ishte përpjekur ta bënte Maksim, por, kur vuri re se emrat e huaj nuk pëlqeheshin më, hoqi dorë). Drejtori ynë përgjithësisht ishte i rëndë, por vetëm të hënën. Bëri sikur nuk më pa dhe nuk më përshëndeti fare. Unë nuk i dhashë rëndësi, pasi e njihja çfarë njeriu ishte.

Atë njeri nuk e honepsja. Ishte një burokrat, një pedant, që s'e kishte shokun. Kishte qenë mësues në disa fshatra dhe, para katër muajsh, kur drejtori ynë i vjetër doli në pension, zuri vendin e tij. Ishte nja dyzet e pesë vjeç, i shkurtër, me një fytyrë të rrumbullakët, sy bojë plumbi, pa shprehje, të ftohtë. Flokët i kishte të prerë si furçë e të thinjur anash. Qafë nuk kishte fare. I pëlqenin shu-

më lëvdatat dhe njerëzit që e lanin dhe e lyenin. Po të guxoje t'i kundërshtoje dhe ta kritikoje, e kishe bërë armik. Veç kësaj, ishte i dhënë pas tarafeve; mbante rreth vetes nja dy mësues, që i tregonin se çfarë thoshin për të në shkollë (njëri prej tyre ishte Mërkuri). Shkresat, rregullat e ngurta, orarët, çdo gjë të këtij lloji, i respektonte me fanatizëm. Mund të gjeje belanë me të nëse regjistri, për shembull, ishte shkruar me dy bojë shkrimi. Nuk kishte rëndësi a punoje me nxënësit e si punoje, rëndësi kishte vetëm që fletoret e planeve t'i kishe të përsosura dhe mos t'i kundërshtoje.

Edhe për qëndrimin e mësuesve me nxënësit kishte rregulla të ngurta. Një ditë më gjeti duke qeshur në klasë bashkë me nxënësit dhe në mbledhjen e këshillit pedagogjik më kritikoi «për ulje të autoritetit të mësuesit». Unë i kundërshtova dhe që nga ajo ditë marrëdhënjet tona u acaruan.

Pra, thashë se të hënën në mëngjez ai nuk më pa fare me sy. «Kushedi si e ka hallin», thashë me vete dhe nuk e vrava mendjen më gjatë.

Pasdite i thashë Lindës:

— A shkove ta marrësh bicikletën tek ajo shtëpi?

— Jo, — tha ajo shkurt dhe u mat të largohej.

— Moj, Linda, ç'ke?

Ajo nuk foli. Ishim tek shkallët e hyrjes së shkollës.

— Të pyeta për bicikletën. Pse nuk shkove? Mos ke ndër mend t'u falësh atyre? Nuk besoj që ajo gruaja e ngjallur të dijë ta ngasë...

— Ohu, dhe ti, Kadri...

Shikova fytyrën e saj. Ajo është libër, që lexohet kollaj. Diç kishte.

— Ç'të ka ndodhur? — e pyeta me inat.

Ajo shikoi pérreth, pastaj papritmas desh të hynte brenda. Unë arrita t'i zë dorën.

— S'ke ku vete pa më treguar.

— Jo këtu, — tha ajo shpejt dhe u shkëput nga unë. Hyri brenda gati me vrapt.

Nuk po e merrja dot me mend se ç'mund t'i kishte ndodhur. Për një çast m'u duk se shqetësimi i saj mund të kishte ndonjë lidhje me punën e së-shtunës, por pastaj e hoqa atë mendim.

«Do ta pres sa të mbarojë mësimet, — mendova. — Sot është e hënë, ajo ka tri orë pasdite. Unë jam i lirë». Shkova në klub. Nuk piva asgjë. As kafenë që deshi të më qërasë Lutfiu, bufetieri. Aini si të më tregonte i kishte vajtur gjuetia të die-lën. Nuk e dëgjova me vëmendje. Në mes të tre-gimit u mërzita dhe dola jashtë. Hyra në shtëpinë e kulturës. Mora një libër të ri me tregime. Lexova dy tri faqe dhe e lashë.

— Do të vish të shohim televizor? — më tha përgjegjësi i kulturës.

— Jo, — i thashë dhe dola në rrugë. Ecja lart e poshtë dhe prapë mendoja se ç'mund t'i kishte ngjarë Lindës. Mendimi se shqetësimi i saj mund të kishte lidhje me të shtunën, më kthehej me këmbëngulje, me gjithëse unë e largoja i vendosur. Dëgjova zilen. Mësimet mbaruan. Tani ajo do të dilte. Nxënësit u shpërndanë. Ajo doli e fundit. Ishte errur. Diku dëgjohej zëri i fuqishëm i një radioje. Vaçë Zela këndonte «Këngën e gjyshes».

— Mbarove? — i fola duke i dalë përpara.

— Po.

Zumë të ecim në heshtje. E kuptova se ajo e ndjente veten ngushtë. I vinte zor të fliste.

— Po pres, — e nxita.

Ajo nuk foli. Vazhdonte të ecte në heshtje. Unë përsërita edhe një herë ato fjalë të shkurtëra, duke i mëshuar zërit. Ajo qëndroi.

— Më tha Tefta se sot në mëngjez kanë folur për ne.

— Për çfarë?

— Për punën e...

Ajo nuk vazhdoi. Unë e plotësova:

—...së shtunës?

— Po. Si e gjete?

— Ashtu kot. Kush kishte folur?

— Mërkuri me drejtorin. Tefta e kishte derën e klasës të hapur dhe padashje i kishte dëgjuar duke folur në korridor.

— Ama kjo qenka! Punë e madhe! — thashë duke u përpjekur të tregohesha i qetë. Atë çast godita me forcë një gur, që m'u ndodh para këmbëve. Guri u rrëkellye në rrugë dhe shkoi e ra në hënëdek. Më dhembi gishti i madh i këmbës. Linda ishte larguar, pa thënë asnjë fjalë tjetër, pa më uruar natën e mirë. Qëndrova në mes të rrugës së errët. Ngrita kokën dhe shikova dritaren e ndriçuar të dhomës ku flinin vajzat. Diku lehte një qen.

Lindën e pashtë të nesërmen në mëngjez teksha pija kafenë te klubit. Isha zgjuar shpejt dhe hyra i pari në klub. Lutfiut i bëri përshtypje që isha zgjuar aq shpejt.

— S'më lanë të fle tartabiqet, — thashë, duke ju përgjegjur pyetjes së tij.

— Pse, edhe në fund të shkurtit ka tartabiqe? — u habit ai.

— Ka, pos i nuk ka, ka disa tartabiqë, që janë gjallë tërë vitin.

Kur pashë Lindën që kaloi para klubit, deshatë dilja e ta ftoja të pinte një kafe. E dija se nuk do të pranonte. Nuk lëviza nga vendi. Më vinte shumë keq për të. E njihja sa e ndjeshme ishte. Isha i bindur se tërë natën nuk kishte mbyllur sy. Linda nuk ishte e re, as e bukur dhe u trembej shumë fjalëve. Pastaj kushedi si i mendonte e i zmadhonte pasojat e asaj çështjeje. Merreni me mend: as biçikletën nuk kishte vajtur ta merrte, sikur ajo gjë do ta rëndonte edhe më shumë.

Vura re se në shkollë thuajse të tërë e dinin punën e së shtunës. M'u duk sikur kishte një farë tensioni, si një mjegull e dendur, që dilte nga dhoma e drejtorit dhe përhapej në të gjithë shkollën.

Pasi mbarova mësimet dhe hyra të le regjistrin në sallën e mësuesve, lexova në dërrasën e zezë: «Pasdite tërë kolektivi ka mbledhje në orën 16. Asnjë të mos mungojë. Nga Drejtoria».

Zura vend pas drifores. Aty rri gjithnjë, kur kemi mbledhje. Linda kishte ardhur nga të parat dhe rrinte në cepin përbalë drifores, pranë Sanijes. Mërkuri, si zakonisht, ishte ulur në radhë të parë, mu përparrë tryzës, ku do të zinte vend drejtori. Salla ishte e heshtur. Vetëm Nikoja diç u tregonëtë nja dy të tjerëve për kampionin evropian të futbollit. Isha i qetë. Po shikoja muratorët që ngrinin murin e spitalit të ri të kooperativës. Ndiqja me sy lëvizjet e tyre të qeta, të matura, duart që hidhni plumbçin, shtronin llaçin, vinin tulla njëra mbi tjetrën, duke i rrahir me bishtin e misbrisë.

Nuk e ndjeva kur hyri drejtori. E kuptova që erdhi, pasi në sallë pushuan zërat.

Në fillim Maksuti foli për punët e shkollës, për përparimin e nxënësve dhe për çështje të tjera. Një diskutim i shkurtër nga ana e Sanijes dhe asgjë tjetër. Të gjithë e dinin se ajo mbledhje nuk ishte thirrur për ato çështje, por për diçka tjetër.

Pastaj Maksuti bëri një pauzë të shkurtër dhe hyri në temë:

— Përveç këtyre, këmi edhe një çështje tjetër për të diskutuar: ajo lidhet me figurën morale të mësuesit tonë, të këtij edukatori të brezit të ri të atdheut tonë socialist. Dihet nga të gjithë se mësuesi është pasqyrë e kristaltë e pastërtisë morale. Marrëdhënjet e tij me të tjerët, e në mënyrë të veçantë me kolegët, duhet të jenë shembullore. Në këtë drejtim ne kemi suksese dhe, me ndonjë përjashtim të rrallë, kemi një kolektiv të shëndoshë, me moral të shëndetshëm dhe justifikojmë besimin e prindërve që na kanë besuar fëmijët e tyre të dashur, vajzat e tyre të shtrenjta. Mirëpo... për fat të keq, ka edhe përjashtime të pahijshme, që e cënojnë rëndë figurën morale të mësuesit tonë, të brumosur me ideale të larta, me virtute eprore.

Këtu ai bëri një pauzë tjetër, për të parë efektin e fjälëve të tij. Mori frymë, pshëretiu me një keqardhje të shtirur dhe vazhdoi:

— Në kolektivin tonë ka ngjarë diçka e shëmtuar. Është fjala pér dy anëtarë të kolektivit tonë, mësuesen Lindita dhe mësuesin Kadri, të cilët të shtunën... Po më mirë, shokë, të dëgjojmë nga goja e tyre si qëndron puna. Le të na thonë ata vetë, me kurajo dhe singjeritet, çfarë kanë bërë të shtunën dhe pastaj kolektivi të gjykojë dhe të mbajë qen-

drim. Unë mund të them edhe vetë çfarë kanë bërë, por është më mirë të flasin të interesuarit. Kjo gjë do t'i ndihmojë.

Maksuti u ul me një shqetësim të shtirur në ftyrë, duke mbajtur atë qëndrimin e tij të rëndë. Unë i njihja mirë pozat e tij teatrale. Vendosa të mos fli-sja. Doja që të fliste vetë Maksuti, Mërkuri, ose ndonjë tjetër, pastaj ta merrja fjalën unë. Ndruhesha se mos fliste Linda, dhe, me atë natyrë që kishte ajo, do të ngatérrohej dhe rrezik të pranonte ndonjë faj.

— Kolektivi po pret, — tha pas pak Maksuti dhe rregulloi kravatën.

Në sallë u bë heshtje. Shikoja muratorët. Para kryesisë u ndal një gaz. Skapamentoja lëshoi një varg krismash, si goditje pushke. «Ka ujë benzina», mendova.

— Atëhere nuk keni gjë për të thënë? — tha pas pak Maksuti. — Ju, shoku Kadri, çfarë do t'i thoni kolektivit për çështjen e së shtunës?

— Asgjë tanë për tanë, — thashë qetë, pa e shikuar në sy. Megjithatë, nuk shikoja jashtë, por në sallë. Sytë e mi u ndeshën me sytë e mëdhenj të Lumes, që ishte nën hartën gjeografike dhe me kokën e saj plot flokë të dendur kishte zënë tërë Afrikën. Sytë e Lumes ishin pak të habitur, por, megjithatë, unë pashë një ngrohtësi e dashamirësi, që gjithmonë kisha gjetur te ajo vajzë e gjallë dhe e zgjuar.

Në sallë heshtja po bëhej e rëndë, gjithnjë më e rëndë. Maksuti e kuptoi këtë dhe siç duket vriste mendjen si të vepronte. U ngrit Nikoja dhe tha:

— Fundi, mund ta thoni edhe ju si qëndron puna, shoku drejtor. Më duket se po zgjatemi kot.

Disa miratuan fjalët e tij.

Maksuti u ngrit prapë në këmbë. Hodhi sytë jashtë dritares dhe, me vështrim të përqëndruar, tha:

— Më duket se shoku Niko ngriti një çështje që meriton vëmendje. Shtrohet pyetja: a ta them unë, apo ta dëgjoni nga goja e të interesuarve? Ne, si drejtori, menduam se është mirë ta thonë vetë. Kjo, siç e theksova më lart, do t'i ndihmojë ata. Ndryshe, vetëkuptohet që parashtrimin e çështjes do ta bëjë drejtoria përmes personit tim. Megjithatë, vërejtja e shokut Niko duhet pasur para sysh për zhvillimin e suksesshëm të mbledhjes. Kam vetëm një rezervë: nuk duhet të na shqetësojë faktori kohë, pasi kjo çështje ka një rëndësi, do të thosha, jetike për kolektivin tonë. Dhe nuk mund dhe nuk duhet të kalojë lehtë.


Heshti. Hodhi sytë në sallë për të parë edhe kësaj here efektin e fjalëve të tij. Pasi u ndesh në indiferentizmin thuajse të plotë të të pranishmëve, i dha një drejtim tjetër mbledhjes.

— Ju, shoqja Lindita, besoj se keni çfarë të thoni...

— Unë? — u dëgjua zëri i saj i trembur.

— Po, ju, natyrisht... — vazhdoi Maksuti dhe u gjallërua. Ai e kuptoi se mund të nxirrte diçka prej saj. — Them natyrisht, pasi ju jeni direkt e interesuar në këtë çështje. Të na thoni si qe puna, kur u takuat me shokun Kadri, çfarë ju tha ai, kur u nisët dhe ç'ndodhi më vonë. Të gjithë shokët e kolektivit janë të etshëm të njihen me këtë çështje, se kjo do t'i ndihmojë të diskutojnë.

U ul i kënaqur. Isha i sigurtë se Linda do të ngatërhoj, në fillim edhe mund të fliste mirë, po



pastaj ndërhyrjet e Maksutit, ose të ndonjë tjetri, do ta bënин tē humbte fillin dhe kushedi q'mund tē nxirrte nga goja. Ndoshta do tē kisha bérë më mirë tē flisja vetë i pari. Unë nuk pranova tē flas jo vettém se do tē përlesheshha menjéherë me Maksutin, por sepse, me heshtjen time, doja tē shprehja edhe një farë mospërfilljeje ndaj qëllimeve tē tij tē këqija, ndaj fanatizmit dhe konservatorizmit tē tij me brirë. Megjithatë, do tē kisha bérë mirë tē flisja para Lindës. Por tani ishte vonë. E pat kjo punë.

Linda filloi tē fliste me ngadalë.

— Po, si tē them... ne, domethënë unë dhe... po, ja, tē shtunën unë shkova dhe trokita në xhamin e klasës dhe i thashë Kadriut: a do tē nisemi...

— Kam një pyetje, — foli Mërkuri dhe, pasi mori aprovin me kokë tē Maksutit, vazhdoi: — Shoqja Lindita, i thatë ju, apo erdhì shoku Kadri dhe ju propozoi që atë pasdite tē udhëtonit bashkë?

— C'rëndësi ka kjo? — ndërhyri Lumja me gjalléri. — Ne jemi kolegë dhe shpesh shkojmë ose kthehemë bashkë nga qyteti dhe nuk vëmë re kush propozon i pari.

— Në rastin e tyre, puna ndryshon, — tha Mërkuri dhe vuri buzën në gaz.

— Nuk ndryshon fare, — nguli këmbë Lumja, — ata janë shokë dhe ne i kemi parë dhe herë tē tjera që shoqërohen. Ju, shoku drejtor, jeni i ri në shkollën tonë dhe ndoshta këtë gjë nuk e dini mirë.

— Më falni, shoqja Lumtëri, — tha duke i shkoqitur fjalët Maksuti, — po ndërhyrja juaj nuk më duket e drejtë dhe nuk është në përputhje me rregullat e mbledhjes. Po fliste shoqja Linditë dhe...

— E ndërpren Mërkuri, — u përgjegj flakë për flakë Lumja. — Prandaj më parë i têrhiqni vërej-

tjen shokut Mërkur, se ai i prishi i pari rregullat e mbledhjes.

Nga fundi u dëgjua një e qeshur. Ishte Sandri, iasi ai e ka gazin në majë të gjuhës. Pas tij qeshën edhe disa të tjerë. M'u duk se u hap dera dhe nga jashtë hyri një rrymë e freskët ajri.

— Shoqja Lumtëri, pak kujdes. ju lutem... — e qërttoi butë Maksuti. Ai e dinte se Lumja kishte një xhaxha, që punonte në komitetin e partisë dhe, si çdo burokrat, ishte frikacak dhe nuk i ngatërronte kurrë qetë me Lumen:

Pastaj nuk foli njeri. Linda mbeti në këmbë. Ktheva kokën dhe e shikova. Vura re se ishte skurkur dhe qepallat e dendura i rrihte pareshtur. Me niérën dorë kishte zënë shpinën e karriages që ndodhej para saj, dhe e shtrëngonte fort. «Vajzë e mirë, po, ç'e do, nuk është e fortë», — mendova.

— Atëhere vazhdojmë, shokë, — tha Maksuti, që donte t'i merrte në dorë frenat e mbledhjes. — Ku mbetëm? Hë. Shkuat ju, apo erdhi shoku Kadri dhe ju propozoi të niseshit për në qytet?

— Unë, — tha ajo me një vendosmëri të pa-pritur.

— Vazhdoni, — tha Maksuti.

— Ai po shkruante dicka në regjistër, apo në fletore... jo, ishte regjistër, dhe unë trokita në xham e pastaj mora biçikletën. Jo, e mori Kadriu, se unë e kisha marrë. Pastaj u nisëm. Rrugës ne ecëm, ose, më mire të them, duke udhëtar....

Kuptohej se fliste me shumë vështirësi. Nuk besoj ta ketë ndjerë veten ndonjëherë më keq. Mua më pushtoi një zemërim që... Hodha sytë jashtë dritarës. Muratorët punonin gjithnjë të qetë, të ma-

tur, tē sigurtë nē punën e tyre. Para gazit kishin qëndruar dy njerëz, që bisedonin me ca fshatarë.

Linda u mat tē fliste prapë. Atë çast ndërhyri Maksuti dhe e pyeti:

— Prisni një minutë. Ju, shoqja Lindita, nisët tē tregonit diçka, pastaj e latë përgjysmë dhe nisët tē thoshit diçka tjetër. Çfarë tregon kjo? Mos na fshihni gjë?

— Unë? — thirri Linda. — Po ju tregoj si u nisëm dhe, duke udhëtar...

Nuk foli më. Zëri i dridhej. Unë godita gjurin e e djathtë dhe brofa më këmbë.

— Ajo është e tronditur. Po jua them unë si ndodhi.

— Po ju, shoku Kadri, thatë se s'keni gjë pér tē thënë, — tha Maksuti, tē cilit nuk i erdhi mirë që u ngrita.

— Thashë kur më pyetët ju. Tani ndërrova mendim. Dëgjoni si qe puna. Megjithëse, t'ju them tē drejtën, nuk më duket fare me vend që mbledhja tē bëhet si seancë gjyqi.

— Nuk tha njeri se ky është gjyq, — tha Maksuti. — Ky është një diskutim shoqëror. Fjalën gjyq po e përmendni ju, shoku Kadri.

— Unë po përmend me emrin e vet atë që po zbatoni ju, shoku drejtor. Megjithatë, meqenëse doni tē dini hollësi, po jua tregoj.

Shkurt e shkoqur i tregova tërë ngjarjen e së shtunës. U përpoqa tē jem i qetë e, me sa munda, fola pa pasion.

Në sallë ra një heshtje, që ndryshonit nga tē tjerat. Këtë nuk e thua me fjalë, por e ndjen. Pas pak mësuesit shkëmbyen ndonjë mendim me njëritjetrin. Dikush nga fundi — Sandri besoj — ja

dha një të qeshure. Linda kishte mbetur në këmbë. Vura re se, pas tregimit tim, ajo sikur ishte më e qetë. Lumja shikonte përpara e menduar. Vetëm Mërkuri shikonte Maksutin.

— Ju e treguat shumë shkurt ngjarjen, — zuri të fliste drejtori, që e ndjinte veten ngushtë. — I evituat me qëllim disa hollësi të rëndësishme.

— Cilat janë këto hollësi?

— Atë e dini ju.

— Unë nuk di gjë, në qoftë se dini ju ndonjë gjë që mund të keni parë në ëndërr...

— Shoku Kadri...

Atmosfera u bë e nderë. E pashë që e shkela, dhe nuk e hapa më gojën. Maksuti zuri të fliste, duke e treguar prapë historinë e së shtunës dhe duke e komentuar.

Shikova jashtë drifores. Muratorët punonin. Grupi para gazit nuk ishte më aty. Papritmas qetësinë e prishi uturina e një traktori, që po kthehej nga arat. Zhurma mbushi dhomën. Maksuti u mat të vazhdonte, por zëri i tij mbytej nga zhurma e fuqishme e traktorit. Hodha sytë larg. Pashë traktoristin. E njihja: ishte djali i Xhafës, që kishte punuar tre vjet si mekanik në qytet dhe, para dy muajsh, ishte kthyer prapë në fshat. Kisha nderjur disa herë me të në klub dhe isha shqyer gazit nga qyfyret që tregonte.

Maksuti pushoi derisa u shua zhurma e traktorit. Pastaj zuri të fliste prapë.

— Këtë çështje, shokë, duhet ta konsiderojmë si një shkelje flagrante të moralit. Kështu është. Ngjarja nuk është si e paraqiti shoku Kadri, ajo ka shumë hollësi të tjera, që ai nuk i tregoi. Dhe përkëtë mban përgjegjësi. Por shoku Kadri, siç u duk

edhe nga qëndrimi këtu, nuk ka reflektuar fare. Me këtë rast, po shtoj se aï nuk është në rregull edhe me detyrën e tij si mësues, dhe këto e rëndojnë. Desha të di edhe mendimin tuaj për këtë çësh-tje dhe propozime konkrete për masat që duhen marrë kundër tyre.

Fjalët e fundit të Maksutit shkaktuan një valë murmurimash në sallë. Unë i pari — besoj se edhe një pjesë nga shokët — e kuptova se ai kishte ndër mend të merrte ndonjë masë të rëndë dhe, sidoqë të diskutonin të tjerët, ai atë masë kishte vendosur ta merrte arbitrarisht. Më shkuau sytë te Linda. Pas fjalëve të drejtorit, ajo ishte tulatur. Më vinte keq dhe inat me të. Më dukej sikur më qëndrimin e saj pranonte një faj të paqenë. M'u kujtua çasti kur ju këput zinxhiri dhe ajo e shikonte të varur në tokë dhe fytyra i kishte marrë një shprehje, sikur ishte gati të qante nga një çast në tjetrin. Pse m'u kujtua ky detaj? Nuk e di. Apo ndoshta puna e zinxhirit të këputur... Po, po, ky detaj më solli ndër mend një mendim: Thashethemet, shpifjet i shkak-tojnë njeriut trauma si ajo që ju shkaktua biçikletës: po, edhe atij i thyhet diçka dhe kjo e pengon që të eci përpara.

U ngritën disa të diskutojnë. Përveç Mërkurit, që përsëriti fjalët dhe akuzat e drejtorit, të tjerët nuk u pajtuan me të dhe çështjen e së shtunës e konsideruan si gjë të parëndësishme, bile si veprim që s'duhet keqkuptuar, pasi ka ndodhur në mes kolegësh që kanë marrëdhënje shoqërore. Nuk është nevoja të përsëris fjalët e tyre, pasi të gjithë thuajse thanë po ato gjëra, as ndërhyrjet e Maksutit, pasi edhe ai përsëriste akuzat e bëra me qëllim të keq.

Unë nuk fola më. As Linda. Dëgjoja. Pse ta

fsheh: nuk isha i qetë si përpara, megjithatë e zotë-roja veten. Jashtë kishte nisur të errenj. Muratorët e lanë punën. Pas pak u nis edhe gazi.

Në fund e mori fjalën Maksuti:

— I dëgjova të gjitha diskutimet tuaja. Më vjen keq, po një pjesë e shokëve nuk u thelluan në problemi e rëndësishëm që trajtuam në këtë mbledhje. Pat edhe ndonjë tendencë zbutjeje, që nuk është e pranueshme. Unë, bashkë me disa shokë të tjerë luftarakë, qëndroj në mendimin tim të patundur: kemi të bëjmë me një shkelje të moralit, absolutisht të papranueshëm për figurën e mësuesit tonë të ri. Duke e parë çështjen nga kjo pikëpamje, unë mendoj që shoku Kadri dhe shoqja Lindita nuk mund të punojnë më në shkollën tonë. Që nesër s'kanë pse paraqiten më në shkollë... Nga ana e drejtorisë do të informoj edhe seksionin e arësimit në rrith. Me kaq mbledhja mori fund.

Lumja u ngrit të kundërshtonte. Folën edhe catë tjerë. Maksuti rregulloi kravatën dhe doli nga salla pa shikuar njeri në sy.

Rreth meje dhe Linditës u grumbulluan mësuesit.



E ndjeja se më ishte mpirë njëra këmbë. Kisha kohë pa lëvizur nga vendi. Rrija shtrirë në divan dhe mendoja. Motra e vogël hyri disa herë në dhomë, matej të ndizte radion, por, me të parë fytyrën time të ngrysur, dilte jashtë pa hapur gojën. Babai me nënën ishin në punë. Ai ndoshta po ngjiste qafën e malit me «skodën» e tij, kurse nëna

rrinte përkultur mbi maqinën qepëse në turnin e dytë.

Mund të kisha më shumë se tri orë që nuk lëvizja nga vendi. Kisha dy ditë pa vajtur në shkollë. As aty, as gjëkundi tjetër. Rrija në shtëpi dhe mendohesha. Vetëm në darkë dilja dhe shetitja në rrugën e gjatë e të re, që kalon para hotel turizmit.

Që të nesërmen, me të shkuar në shtëpi, ua tregova punën prindërve.

Babai, si zakonisht, më dëgjoi, u mendua gjatë dhe tha:

— Po të na kesh thënë të vërtetën, nuk ke faj dhe çdo gjë do të rregullohet. Po të kesh bërë ndonjë gabim, atëhere duhet ta lash.

Nuk foli më. Hapi gazetën dhe zuri të lexonte me vëmendje faqen e katërt.

Atmosfera e shtëpisë ndryshoi. Këtë e ndjente edhe motra ime dhjetëvjeçare, që rrinte e menduar dhe më shikonte në një mënyrë të çuditshme.

Mëma nuk ma zuri në gojë atë histori gjatë gjithë asaj dite. Vetëm sot në mëngjez më tha, tekxalante diçka në lavaman:

— Po Linda?

Unë nuk e kuptova pyetjen e saj.

— Desha të them, — shtoi ajo, — si i ka punët ajo vajzë?

— Keq.

— E kuptoj. Ajo e ka më rëndë se ti.

— E di.

— E shkreta vajzë!

Tek solla ndër mend këtë dialog të shkurtër, thashë me vete se nuk do të bëja keq të shkoja tek ajo, ose të paktën të pyesja si i kishte hallet. Jo, në shtëpi nuk bënte t'i shkoja... E pra, unë kisha qenë

disa herë tek ajo... Mirëpo, pas asaj që kishte ndodhur... Çfarë kishte ndodhur? Asgjë. Megjithatë, ndruhesha t'i shkoja në shtëpi. Nuk më vinte mirë të takoja prindërit e saj, pastaj mund të më shihte ndonjë duke hyrë atje dhe kushedi ç'do të mendonte...

M'u kujtua prapë zinxhiri i këputur. Më duket se jo vetëm Lindës, por edhe mua diçka më ishte këputur, diçka që më pengonte të ecja. Sa do të zgjaste kjo?

E ndjeja se këmba më ziente, sikur kalonin në të qindra milingona të padukshme. Shtëpia ishte e qetë, shumë e qetë. Ishte një qetësi që nuk më pëlqente, një qetësi me të cilën nuk jam mësuar. Motra preqatiste mësimet në dhomën e gjumit. Në shtëpinë përballë një djalë i vogël bënte ushtrime violine; qenë disa shkallë kromatike, që përsëriteshin pareshtur... Edhe mendimi im herë ngjitej e ngjitej dhe pastaj prapë zbriste e zbriste. Prapë ngjitej, ngjitej, por shkalla ishte e brishtë dhe ai zbriste.

Në mëngjes desha të shkoja në komitetin ekzekutiv e të takojta ndonjë shok nga të arësimit, ose edhe vetë shefin. Kështu pata vendosur që mbrëmë, por ndërrova mendim. Nuk gjeta ndonjë justifikim bindës dhe hoqa dorë. Se si më vinte, «Ndoshta, — mendoja, — është më mirë që më parë të shkojë relacioni i drejtorit dhe pastaj ata të më thérresin për sqarim. Megjithatë të shkoj vetë përpara, t'i vë në dijeni, t'u them të vërtetën dhe mos ta le që këtë gjë ta bëjë përpara Maksuti». Kështu pata vendosur mbrëmë, mirëpo në mëngjes u ngrita me mendje tjeter.

Që kur më pyeti nëna:

— A do shkosh sot në komitet?

Unë i thashë:

— Të shohim.

Ajo u mat të më thotë diçka, por unë nuk doja të dëgjoja gjë tjetër, se më vinte zor, dhe shkova në dhomën tjetër.

Është e çuditshme: të më pyeste njeri para një muaji se ç'do të bëja po të më ndodhte një gjë e tillë, do t'i thosha: «Është e pamundur të ndodhë, por, edhe sikur, ta zëmë, të më ndodhë, unë bëj namin, nuk le njeri pa kapur, nuk le derë pa trokitur dhe shpifësit do t'i vë me shpatulla në mur!...» Kurse tani që më ndodhi... Si shpjegohej kjo? Mos nuk isha kaq i fortë, sa mendoja? Apo shpifja paska kaq fuqi të madhe, sa mund dhe të të paralizojë për disa kohë. Nuk dija ç'të thosha.

Në murin e komshiut nisi të tingëllojë ora. Gjashtë herë. «Ç'do të jenë duke bërë ata në fshat në këtë orë. Prit të mendohem pak. Lumja me Sanijen kanë mësim. Nikoja jo. Ai do të jetë në klub, duke folur përfutbollin. Mërkuri mund të jetë me Mak-sutin. E ndihmon të përpilojë relacionin për seksionin. Po ndoshta atë e kanë bërë që dje. Po të jetë kështu, atëhere ata e kanë dërguar në seksion dhe nesër do të më thérresin».

Ra zilja e shtëpisë. Një zë pyeti. «Ku është Çili?» Këmba ishte gjithnjë e mpirë. Duhej të lëvizja. Dikush më kërkonte. Kush do ishte? E mbështeta këmbën në dysheme. Po e fërkoja.

U hap dera. Nga mënyra si u hap dera e njoha kush ishte.

— Ku je, mor dhaskal? — thirri Pali dhe erdhi e qëndroi para meje. E kuptova menjëherë se ai din-

te çdo gjë. U përpoq të tregohej sa më i shkujdesur, por unë e mora vesh se ai i dinte.

— Këtu jam. Me këmbë të mpirë.

— Férkoje, se të kalon.

Ai ndezi një cigare. Dëgjova shkrepsen që kërciti. Në rrugë disa fëmijë luanin futboll dhe grinde-shin për numrin e golave.

— Pse nuk më lajmërove? — tha ai duke më shikuar drejt në sy.

— Sonte kisha vendosur të vija andej nga ti.

Po ti, si e more vesh?

— Lajmet kanë këmbë.

— Të mirat, se lajmet e këqia kanë fletë.

Ai vuri buzën në gaz. Më zgjati paqetën.

— Nuk dua, — thashë.

Ai hidhte sytë përreth. Nuk e qëndronte vësh-trimin askund.

Hapi një libër të vendosur mbi radio.

— E ke lexuar? — më pyeti ashtu kot.

— Si e ka titullin?

— «Në luginën e Sierra Altës».

— Jo, kam lexuar njá dy libra të tjerë nga shkrimtarë të panjohur të Amerikës Latine dhe nuk lexoj më...

Ai qeshi dhe shkoi tek dritarja....

— Dalim? — tha pas pak duke shikuar jashtë.

— Dalim, — thashë unë. Këmba m'u shpi. U ngrita dhe vesha xhaketën.

Dolëm në rrugën plot me njerëz. Ishte errur fare.

Mbrëmja e asaj dite në fund të shkurtit ishte e butë, si mbrëmje pranvere. E pyeta Palin si shkon-te me punën e re. Ai më tregoi se i pëlqente ajo ndërmarrje, megjithëse, si inxhinier, kishte telasne.

— Ke laborator? — e pyeta.

— Kam nisur ta ngre.

Para kinemasë ishin mbledhur plot njerëz. Shfaqej një film me Stiv Riversin. Ai u mat të më thoshte diçka, por pastaj ndërroi mendje. Më pyeti si kishte ngjärë puna të shtunën dhe m'u lut t'i tre-gaja hollësish edhe për mbledhjen në shkollë.

Më dëgjoi me vëmendje dhe fytyra e tij, si e një fëmije të rritur para kohe, ishte e përqëndruar.

— Hajde punë, hajde, — tha duke tundur kokën. — Ka akoma njerëz si Maksuti yt që, në vend të ndreqin, prishin punë. Por mos u mërzit. Nuk e kanë të gjatë.

Ecëm në heshtje. Më pëlqente gjallëria e rrugëve të qytetit në mbrëmje.

— Nuk ke vajtur gjëkundi?

— Jo.

— Shumë keq, shoku dhaskal.

— Ke të drejtë, or shoku inxhinier.

Dhe qeshëm. E kisha shok të vjetër Palin, shok që në fëmijëri dhe, sa herë rrija me të, e ndjeja vreten mirë. Ishim rritur bashkë. Pas shkollës së mesme, atij nuk i pëlqeu të vazhdonte shkollën e lartë, u bë mekanik, kurse unë mbarova Institutin dyvjeçar. Më vonë, Palit ju zgjua dëshira për shkollë, ndoqi pa shkëputje fakultetin dhe para gjashtë muajsh u diplomua. Është djalë i zgjuar, megjithëse rrëmbehet shpejt dhe nuk ja përton të ngatërronjë qetë me këdo, kur është i bindur se ka të drejtë.

Teksa kalonim para hotelit, pashë te hyrja xhaxhain e Lindës. Kisha një farë miqësie me të, ndaj u shkëputa nga Pali dhe shkova ta takoj.

Qazimi më njoihu menjëherë dhe më dha dorën,

duke më shikuar në një mënyrë, që tregonte se ai dinte çdo gjë.

— Si është Linda? — e pyeta menjëherë.

— Mirë.

Atë fjalë të shkurtër e shqiptoi me një mënyrë, që m'u duk se tregonte të kundërtën. E kam vënë re edhe herë të tjera: nuk ka fjalë me kuptim më relativ dhe me shumë nuanca se fjala «mirë».

— Nuk është këtu, — tha ai pas pak dhe ndezi një cigare.

Unë nuk fola. Ç'është e vërteta, nuk e kuptova mirë se ç'desh të thoshte me atë fjalë. Ai thithi cigaren dhe tha:

— Im vëlla e ka dërguar në Berat, tek motra e martuar.

— Kur kështu?

— Që sot në mëngjez.

U trondita shumë. Mund edhe të isha zverdhur. Qazimi nuk foli më. Më zgjati dorën dhe u largua duke thithur cigaren.

Pali ishte afruar dhe e kishte dëgjuar tërë bisëdën. Më zuri për krahu. Pas pak u ulëm në cep të brrarisi.

— Birrë apo raki? — më pyeti.

Kaq shumë qenkan tronditür prindërit e saj, mendoja duke shikuar mbulesën me katrorë blu të tryezës, sa e kanë larguar Lindën nga qyteti. Pse e kanë bërë, që njerëzit të pandehin se ajo është gjithnjë në fshat?

— Dy birra e dy meze, — dëgjova Palin. Zëri i tij më dukej sikur vinte nga larg.

Kjo gjë do ta ketë mërzitur shumë Lindën, mendoja, prindët e saj janë ngutur. Hej dreq o punë, më duket sikur kam edhe unë faj për atë që ndodhi. Si u ngatërrua kjo punë kështu...

— Gëzuar! — thirri Pali me gotën e birrës në dorë.

Birra ishte e ftohtë. E piva me fund dhe fshiva buzet me shpinën e dorës. E ndjeva se më bëri mirë. Psherëtiva i kënaqur. Por mendimet për Lindën nuk më shqiteshin.

— Edhe dy të tjera, — porositi Pali. Pastaj ai nisi një bisedë dhe më tregoi se kishte rënë në dashuri me një edukatore çerdheje, ku conte çdo mëngjerez mbesën. Më foli gjatë për të. U përpoqa ta ndjek me vëmendje, megjithëse mendimi për Lindën nuk më linte të qetë.

— Habitët im vëlla me të shoqen kur unë ngul këmbë të çoj e të marr mbesën nga çerdhja, — vazhdoi Pali. — Ku ta dinë ata të shkretët së xhaxhai kërkon të gjejë nuse me ndihmën e mbesës katërvjecare.

Zuri të qeshë. Edhe unë pas tij.

— Domethënë shkon mirë me sektorin e dashurisë, — thashë, pasi piva edhe gotën e dytë.

— Jë, mor Çili, kam shumë deficite nga e kaluara.

Salla zuri të mbushet. Nuk shikoja nërrreth, por dëgjoja zëra dhe zhurma karrigesh aë lëviznin parreshtur. Herë pas here ngrija kokën dhe shikoja një tablo të varur në mur. Ajo paraqiste një kombajnë të kuqe në një det gruri të verdhë.

Unë prapë mendoja për Lindën, megjithëse tanishë më i qetë. Më dukej një marrëzi e madhe ajo aë kishin bërë prindët e saj. Ata me siguri...

— ... Janë ngutur, apo jo, Pali?

— Kush?

— Them se prindët e Lindës janë ngutur, apo jo?

— Posi nuk janë ngutur. Ende për atë mendon?

— Jo, tani se si m'u kujtua, — e gënjeva.

Ai më shikoi ngultas. Bëri buzën në gaz, por sytë i kishte të menduar.

Çfarë të menduari! Aspak nuk i kishte sytë të menduar. Pse t'i kishte? «Edhe unë e kam zmadhuar kot punën time. Më kanë pezulluar disa ditë nga detyra si mësues. Punë e madhe! Do të rregullohet. Që nesër do të shkoj në komitet dhe me siguri do të më japid, të drejtë. Edhe prindërit e Lindës janë tre-guar frikacakë; kot e dërguan vajzën në Berat. Më vjen keq për të. Keq? Po, edhe keq, edhe inat. Është vajzë e mirë, por duhet të jetë më e fortë. Të kundërshtonte, mos të shkonte në Berat. Të vinte nesër me mua në komitet dhe të dy bashkë t'ja tundim dhëmbët atij Maksutit, që është njeri i keq, fanta-tik, konservator dhe një burokrat me brirë. Hej, mor Maksut, ç'na bëre!» Kështu mendoja me vete.

— Pal, të porositim edhe dy birra?

— E lemë me kaq, Çili.

— Porositim.

— Kamerier, edhe dy birra.

Salla oshiëtiu nga zërat. Kush ishte ajo grua që qeshë? Nuk e njihja. Sa do të ishte ora? Nuk kishte rëndësi. Shikoj tablonë në mur. Ja, kombaj-na qëndronte në mes të detit të verdhë të grurit. Kush tha qëndronte? Jo, ajo lëvizte, ajo po ecte, ecte, ecte...

*

*

*

— Si je, mor dhaskal?

Nuk e dëgjova Palin kur hyri brenda. Zëri i tij

gati më trembi. Ai nuk u ul, por qëndroi para meje.

— Ende nuk ke vajtur në komitet? — më pveti përnjëheresh.

— Po ja, unë, Pal...

Ai bëri sikur nuk u vuri vesh fjalëve të mia. Me siguri e kuptoi se unë ngurroja dhe bëri sikur nuk mori vesh gjë.

Më tha:

— Hajde dalim bashkë. Edhe unë kam punë në komitet.

Desha t'i kundërshtoja, ta shtyja vajtjen në komitet por si t'i thosha Palit? E njihja mirë shokun tim: ai do të më merrte me pahir.

Më vuri dorën në sup dhe më ngriti në këmbë.

Pas pak zumë të ecim nëpër rrugët me diell të qytetit. Në fillim këmbët mezi i lëvizja, pastaj zura të ecja gjithnjë më shpejt.

Para disa minutash më vinte shumë rëndë të shkoja në seksion, kurse tanë kisha ndërruar mendim. E ndjeja veten më të shpenguar duke ecur pranë shokut tim. Nuk më kishte kaluar ngurrimi dhe vrisja mendjen si do ta filloja bisedën, çfarë do t'u thosha dhe si do t'ua thosha.

Tek dera e komitetit gati u pëplasa me dy njerëz që sapo dilnin.

— Më falni, — thashë dhe u mata të hyja brenda.

— Kadri, — më thirrën përnjëheresh dy zëra. U ktheva e nuk u besova syve; ishte Lumja dhe Nikoja.

— Po ju, ç'bëni këtu? — u thashë i gëzuar dhe gati sa nuk i përqafova, sikur të kisha një kohë të gjatë pa i parë dy kolegët e shkollës sime.

— Ishim në seksion, — tha Nikoja dhe më shke-
li syrin.

— Për punën tënde, — shtoi Lumja.

Unë nuk po kuptoja gjë. Atëhere ata më tre-
guan se, të nesërmen, mësuesit ishin mbledhur
dhe kishin kundërshtuar vendimin arbitrar të
Maksutit. Disa prej tyre, me Lumen në krye, ki-
shin shkuar dhe kishin biseduar me drejtorin. Ai
nuk kishte pranuar të kthente vendimin e marrë.
Atëhere arësimtarët kishin biseduar përsëri dhe ki-
shin caktuar ata të dy të shkonin në seksion dhe të
shpinin atje zërin dhe mendimin e tërë mësuesve.

— Përveç Mërkurit, kjo dihet, — qeshi Nikoja.

— Folëm me shefin, — tha Lumja. — Ai nuk
dinte gjë. Siç duket, Maksuti nuk ka pasur kurajo të
informojë seksionin, ose donte ta shtynte ditë me di-
të. Shefit ju duk gati i pabesueshëm vendimi i
Maksutit.

— Na porositi që nesër në mëngjez të jetë në
seksion patjetër, — tha Nikoja, kurse neve na tha
që të bëhet një mbledhje tjetër me tërë shkollën,
se donte të vinte dhe ai.

— Duhet lajmëruar edhe Linda, — tha Lumja.

— Mora vesh se ka shkuar në Berat. Tani po i
shkojmë në shtëpi që t'i bëjmë telegram të kthehet
sa më parë.

Mua gati më ishte zënë fryma nga ngashërimi.
Shikoja me sy të çakëritur herë Lumen, herë Nikon.
Pali rrinte pranë meje dhe dy-tri herë më goditi me
brryl dhe thoshte nën zë: «E shikon?»

— Po ti ku po shkon? — pyeti Nikoja.

— Edhe unë tek shefi.

— Shumë mirë. Ai na porositi të të gjenim dhe
të të thoshim se po të pret, — shtoi Nikoja.

— Kurse ti paske qenë afër dhe na kurseve rrugën, — tha duke qeshur Lumja.

Pas saj qeshi edhe Nikoja e pas tyre edhe unë me Palin.

— Tani shko, — tha Pali dhe më vuri dorën në sup.

— Mirë se të vish! — thirri Lumja me Nikon dhe zbritën shkallët e komitetit, duke u zhdukur në sheshin e bardhë të qytetit, në mes të njerëzve.

— Ke nevojë të të çoj deri tek dera? — tha me shaka Pali.

Ngjita me vrapi shkallët. Merrja frymë me vështirësi, jo aq shumë nga lodhja, po ngaqë ende nuk më kishte kaluar ngashërimi. Prita një çast sa të qetësohesha. Ju afrova një dritareje që ishte në koridor. Hodha sytë dhe shikova sheshin e qytetit. Ai ishte plot diell. Në të kalonin pareshtur maqina. Para komitetit po kalonte një biçikletë. E shikova më vëmendje. Dy këmbë të fuqishme u mëshonin pedaleve. Shikova zinxhirin e saj: ishte i ri, i fortë, i ndritur. Ai e bënte biçikletën të ecte përpara me vrull.

U ktheva tek dera dhe trokita.

— Hyrë, — tha një zë nga brenda.

Unë hapa derën.

PANTOMIME

- Të pëlqen dhoma? — më pyeti portieri.
- Nuk është e keqe.
- Është ca e vogël, por nuk kemi dhomë tjetër teke.
- E kuptoj.

Ai doli nga dhoma. Unë nisa të rregulloja plaçkat. Do të rrija dy-tre muaj në atë qytet për të vë-në në skenë një shfaqje dhe kisha marrë shumë plaçka. Vura kostumin e këmishët në raft, vendosa librat, fletoret dhe kutinë e vogël të shahut mbi komodinë, në tavolinë vura xhezvenë, dy queska me kafe e sheqer dhe një shishe me alkool.

Nga dritarja dukej një pjesë e qytetit, që nuk e njihja. Kisha qenë disa herë në atë qytet, por atë lagje nuk e kisha parë kurrë. «Kjo është ana tjetër e hënës», mendova dhe vura buzën në gaz për kë-të krahasim.

Provat me trupën do t'i filloja pas dy ditësh. Atë mbrëmje isha i lirë. Nesër mund të bëja ndonjë takim me trupën për t'u njobur.

Ndeza një cigare dhe qëndrova para dritäres së hapur. Dielli kishte perënduar prapa kodrave të qytetit. Lagjja që shtrihej pas hotelit, kishte shtëpi

të vogla, shumica të ulëta, njëkatëshe, me oborre katrare. Duke i parë nga kati i tretë i hotelit, më dukeshin si shtëpi kukullash. Një rrugë e shtruar me kalldrëm e ndante gati mes për mes tërë lagjen. Anash ngriheshin shtyllat e elektrikut. Pranë dyerive të mëdha kishte nga një gur, ose sofat anash. Kishte pak pemë. Dukej lagje e qetë; nuk dëgjoheshin thirrje fëmijësh, as ndonjë zhurmë tjetër. Ajo vinte pas sheshit kryesor, por dukej si një lagje periferie.

Shikoja shtëpitë, oborret, rrugën e kalldrëmtë dhe mendoja: «Ky është sfondi që do të shoh për dy tre muaj çdo ditë, çdo natë. Këtë lagje do ta shoh çdo mbrëmje, kur të bie për të fjetur, me ato drita të vogla, që do të ndizen e pastaj do të shuhën një nga një, si një grusht bukurrezash të shpërndara aty-këtu, do ta shoh çdo mëngjez, me t'u zgjuar...»

Thithja cigaren dhe mendoja: «Çfarë njerëz banojnë këtu, me ç'punë imerren? Ja, ç'është ai burrë që po punon në oborr me lopatë? Po ajo grua që nder lëveret tek teli, si quhet, sa fëmijë ka, a punon? Sa vjeçë është ajo plaka që rri në atë dritaren e vogël dhe po thur çorape?»

E kam zakon që të marr me mend jetën e njerëzve që shoh dhe që takohem për herë të parë. Kjo më ndodh kur udhëtoj, kur jam në ndonjë dasmë, kur shkoj në teatër, kur ha në restorant. Esh-të gjë interesante dhe e dobishme të mendosh dhe të përfytyrosh jetën e njerëzve të tjerë.

Në mes të shtëpive që shiheshin nga dritarja, më tërhoqi më shumë vëmendje njëra: ishte e vogël, megjithëse me dy kate. Kishte nga një dhomë në çdo kat. Muret bojë trëndafili binin menjëherë në sy, çdo kat kishte nga dy dritare. Pse më tërhoqi vëmen-

djen më shumë? Prej ngjyrës së mureve, apo pse ndodhej më afër hotelit dhe mund ta vështroja më mirë se të tjerat? Në katin e parë ishte kuzhina, se nga dera e hapur shikoja një sobë të vjetër. Lart ishte dhoma e gjumit me një shtrat të madh martese e me një raft, që zinte thuajse tërë faqen e murit. Në njerën nga dritaret e katit të sipërm rrin te një grua. Ajo nuk dukej e qetë. Shikonte përreth, nganjëherë ngrivej, ecte nëpër dhomë e prapë vinte e qëndronte në dritare. Ndoshta priste dikë. Ndosh ta kishte ndonjë hall, ndoshta...

Hodha sytë përreth, kundrova me vëmendje ndonjë hollësi të shtëpive të tjera të lagjes. Pastaj vështrimi prapë m'u përqëndrua te shtëpia e vogël dykatëshe me muret bojë trëndafili, me shtratin e madh të martesës, me raftin që zinte tërë faqen e murit.

Gruaja nuk lëvizte më nëpër dhomë. Dukej më e qetë. Duart i kishte mbështetur mbi parvaz. Nuk ja dalloja mirë tiparet se kishte nisur të errej. Më dukej e bukur dhe e re. Ndoshta nuk ishte e tillë, por mua ashtu më dukej. Kishte veshur një fustan dyngjyrash, pak të gjerë për trupin e saj të hajthët e të gjatë. Flokët e dendur e të butë i binin mbi supet e ngushta.

Cila ishte ajo grua? Ku punonte? A kishte fëmijë? Çfarë po mendonte atë çast? Ishte e shqetësuar, priste ndonjë njeri, apo ndoshta...

Trokiti dera e dhomës sime. Ishte prapë portierja plakë.

— Telefonuan nga teatri. Pyetën për ju dhe më thanë që, po të keni mundësi, të shkoni në teatër, se ju pret drejtori.

— Faleminderit.

U ktheva në dritare. Gruaja ishte ngritur në këmbë dhe bisedonte me një djalë nja dhjetë vjeç, që rrinte në oborr. Ai diç i thoshte. Ajo tundte kokën dhe rrallë përgjigjej. U hap porta e shtëpisë dhe hyri një burrë i shkurtër, me beretë të zezë. Djali foli ca fjalë me të porsaardhurin dhe doli me vrap nga shtëpia. Burri u ngjit lart përmes një shkalle prej druri. Ajo u largua nga dritarja. Ai hyri në dhomë dhe hodhi beretën mbi shtrat. M'u duk se diç folën pa u shikuar në sy. Pastaj ai doli në dritare. Ishte më i shkurtër se ajo. Fytyrën e kishte të gjatë dhe të murme. M'u duk i ngrysur. Ai fliste pareshtur dhe lëvizte duart. Ajo dëgjonte dhe i përgjigjej në të rrallë.

Çfarë i thoshte ai? Kush ishte? Burri i saj? Po për çfarë flisin? Nganjëherë më dukej si një bisedë e zakonshme në mes të burrit e të gruas, nganjëherë më dukej sikur ata bisedonin për diçka të rëndësishme. Por ishte e vështirë ta kuptoje atë pantomimë që zhvillohej në shtëpinë me mure bojë trëndafili.

Burri i ktheu shpinën dritares. Edhe ajo kishte lëvizur nga vendi. Nga lëvizjet e supeve e kuptova se ai prapë po fliste. Shikoja shpinën e burrit dhe sipër tij kokën e gruas. Dukej një gjë shumë e çuditshme: një shpinë burri me një kokë gruaje përsipër, të vendosur nga ana e kundërt.

Papritmas ai u kthyte dhe mbylli dritaren. U zhdukën të dy pas perdeve të trasha. U duk sikur mbi pantomimën e tyre ra sipari. Mbeti e hapur dri-

tarja tjetër. Përtej saj dukej shtrati i madh i martesës dhe mbi të bereta e zezë e burrit, që ngjante si një mace që flinte aty e mbledhur kutullac.

Drejtorin e teatrit e gjeta në zyrë. Nisëm të bisedojmë për shfaqjen që do të vija me trupën e tyre, për ndarjen e roleve, për piktorin e shfaqjes, për orarin e afatin e premierës.

Pastaj dolëm bashkë në qytet. Edhe darkën e hëngrëm bashkë në hotelin e ri të turizmit.

U ktheva vonë në hotelin tim. Shkova para dritäres së dhomës dhe shikova lagjen. M'u duk sikur pashë diçka tjetër, krejt të ndryshme nga ajo që kisha parë pasdite. Kishte pak drita të ndezura. Vetëm rruga ishte e ndriçuar dhe nga shtyllat derdhej një dritë e bardhë mbi gurët e kalldrëmit, mbi portat e mëdha dhe gurët e bardhë që ngriheshin ndanë tyre.

Në fillim nuk e gjeta shtëpinë me muret bojë trëndafili. M'u duk sikur e kishte përpire errësira. Dritat ishin të shuara. Perdet të lëshuara. Diku një radio transmetonte muzikë të Mozartit. Nga pasticeria, që ndodhej në katin e parë të hotelit, vinte uturima monotone e frigoriferit.

U zhvesha dhe zura të lexoja. Frigoriferi pushoi. Radioja vazhdonte të jepte koncertin e Mozartit. U ngrita të shuaja dritën. Hodha edhe një herë sytë përtej dritäres. Lagjja ishte e qetë. Ishin shuar edhe dritat e tjera. Ndriçonin vetëm llambat e rrugës, që hidhnin dritë mbi kalldrëm dhe mbi gurët e bardhë ndanë portave të mëdha.

Disa ditë me radhë nuk vura re asgjë të veçantë

në shtëpinë dykatëshe. Gruaja zgjohej shpejt, rregullonte shtratin, fshinte dhomat e oborrin dhe hynët në kuzhinë e bënte gjellë.

Me sa dukej, ajo nuk ishte në punë. Tërë ditën e shikoja që sillej nëpër shtëpi.

Unë kisha nisur punën. Në fillim e pata të vështirë, pasi punoja me aktorë që nuk i njihja. Puna e cte me zor dhe me disa m'u desh të qëndroja gjatë në studio. Kur kthehesha në hotel, lagjen e gjeja në gjumë. Edhe shtëpia dykatëshe i kishte dritat të shuara dhe perdet të ulura.

Më vonë, puna nisi të më shkonte më mirë. Më mbetej kohë pér të lexuar, pér t'u njojur me qytetin e njerëzit e tij. Qëndroja edhe në dritaren e dhomës së hotelit.

Një pasdite — ka qenë e shtunë — nuk kisha punë në teatër, pasi trupa kishte shfaqje. Pushova, pastaj u ngrita dhe, duke u shtriqur, dola në dritare. Ndeza një cigare dhe u pështeta në parvaz. Tani lagjen e njihja mirë. Madje edhe një pjessë të banorreve të saj. E dija edhe sa fëmijë kishin disa prej familjeve. Si zakonisht, vështrimi im qëndroi mbi shtëpinë me muret bojë trëndafili. Nuk vura re as gjë të veçantë. Kisha përshtypjen — nuk e di sa e drejtë ishte kjo — se diçka nuk shkonte mirë në atë familje të vogël, se ai çift nuk ishte i lumtur. Vuannin të dy. Sidomos gruaja, që rrinte tërë ditën e myllur. Nuk e di, mbase ajo edhe dilte kur nuk isha në hotel, por sa herë që shikoja atë shtëpi, gjithnjë e gjeja aty me atë fustanin dyngjyrash, që i rrinte pak i gjerë.

Pra, atë të shtunë, në fillim m'u duk sikur gjithshka shkonte si ditët e tjera. Burri ishte shtrirë në shtrat dhe flinte. Beretën e kishte vënë mbi fytyrë, që t'i priste dritën. Gruaja po fshinte oborrin. Unë ndiqja lëvizjet e saj të ngadalta, të qeta, por në të njëjtën kohë të vendosura. Papritmas i shoqi u ngrit shesh mbi shtratin e madh dhe thirri. Pastaj doli në dritare. I foli diçka me të egër. Ajo shtrëngoi fshesën ndër duar dhe qëndroi si e ngrirë. Ai filloj të fliste duke lëvizur duart. Dukej i zemëruar. Ajo nuk ngriti kokën pér ta shikuar.

Gruaja la fshesën e hyri në kuzhinë. Doli me një gotë uji të vendosur mbi një tabaka. Ngjiti ngadalë shkallët dhe ju afrua të shoqit. Ai mori gotën dhe e vuri në buzë. Pastaj me një lëvizje të papritur e hoqi gotën dhe ja flaku ujin në fytyrë. Ajo nuk lëvizi. Uji i rridhte nga sytë, nga mollëzat, nga goja. Ai vuri gotën mbi tabaka, mori beretën dhe doli nga shtëpia duke përplasur portën.

Ajo qëndroi disa çaste pa luajtur nga vendi. U kthyte nga dritarja dhe me kurrizin e dorës fshiu ujin nga fytyra. Qëndronte si e ngurtësuar.

C'kishte ngjarë? Pse ja flaku ujin në fytyrë i shoqi? Pse i thirri dhe e shau nga dritarja tekxa ajo pastronte oborrin?

Trokiti porta. Ajo u shkund gati e trembur. Zbriti poshtë. Ishin dy gra. Pér herë të parë shikoja njerëz që hynin në shtëpinë e saj. Morën nga një karrige dhe u ulën të tria në oborr. Bisedonin qetësisht. Gruaja me fustanin dyngjyrash fliste pak. Njëra nga të dy dy gratë, një grua pak e ngjalur, fliste pareshtur e shpesh, queshte, duke ngritur kokën lart. Tjetra ishte më e moshuar dhe fliste më rrallë. Sidoqoftë, dukej se ato bisedonin

për të zonjën e shtëpisë dhe vija re që i drejtoheshin asaj dhe prisin përgjegje pér ndonjë pyetje që i bënин.

Pas disa ditësh. Isha kthyer në hotel dhe po rruhesha. Duke zbutur faqet me shkumë sapuni, më shkuan sytë te shtëpia e tyre. Nuk pashë njeri. Gruaja nuk ishte aty. Kjo gjë ndodhë pér herë të parë. Pastaj u hap porta e oborrit. Nuk ishte i shoqi. Ishte ajo. Mbante ndër duar një çantë të vjetër, me të cilën, siç dukej, kishte marrë drekën me vete. Apo kishte qenë në pazar? Në atë orë? Mundet që ajo të kishte hyrë në punë.

Po, po, kishte hyrë në punë. Pas disa ditësh u binda pér këtë: e pashë disa herë duke u kthyer në atë orë me atë çantë në dorë. Ku kishte filluar punën? Më erdhën ndër mend qendrat e mëdha të punës që ishin në qytet.

Edhe pasi hyri në punë, nuk m'u duk se pati ndonjë ndryshim të ndijëshëm në jetën e saj; gjithnjë si përpara. I shoqi vinte pas saj. Hynte në dhomë, hidhte beretën mbi shtrat dhe shtrihej të flinte. Ajo bënte punët. Pastaj ai zgjohet. Ajo i bënte kafenë dhe prapë zbriste poshtë. Ai vinte beretën dhe, pa folur njëri me tjetrin, qëndronin ashtu të ndarë: njëri poshtë dhe tjetri lart, në dritare. Pastaj ai dilte nga shtëpia, kurse ajo rrinte vetëm tërë pasditen.

Pas një javë. Ai po flinte. Ajo lante teshat në një govatë në mes të oborrit. Ai u zgjua dhe doli në dritare. I thirri duke i folur me inat. Ajo nuk ktheu kokën. Atëherë ai zbriti poshtë dhe hyri në kuzhinë. Nga dera e hapur e pashë që piu një gotë ujë. Kur doli nga kuzhina, qëndroi para saj dhe diç i tha duke e kërcënuar. Ajo vazhdoi të lante e heshtur, e qetë. Ai goditi me shqelm një kovë plot me ujë, pastaj me hap të shpejtë doli nga shtëpia.

Një natë u ktheva vonë nga provat. Isha lodhur. Kishim nisur të hidhnikm në mizanskenë pjesën e parë të shfaqjes. Duke hequr xhaketën, hodha sytë nga lagjja e qetë. Jo vetëm më ishte bërë zakon një veprim i tillë; por ndjeja edhe kënaqësi kur vështroja atë vend të bukur, me ato shtëpi të vogla, të pastra, me atë rrugë me kalldrëm, që e ndriçonin dritat. Diku larg bëhej një dasmë dhe dëgjoja piskamën e një klarinetë. Nga pastiçeria vinte zukatja e frigoriferit.

Për çudi, shtëpia me muret bojë trëndafili e kishte të ndezur dritën e katit të sipërm. Netët ishin ngrohur dhe në lagje thuajse të gjithë flinin me dritare të hapura. Pashë gruan, që ishte shtrirë në shtrat e po flinte. Pjesa tjetër e shtratit ishte e zbrazët. Ajo ishte kthyer në një krah dhe flokët e gjatë i qenë shpérndarë në jastëkun e bardhë.

U hap porta e shtëpisë dhe hyri i shoqi. Nga mënyra si ecte e kuptova se kishte pirë. Lëvizjet i kishte të kontraktuara dhe gjymtyrët të mpira. Hyri në dhomën e gjumit dhe, si zakonisht, hodhi bere-tën mbi shtrat. Bëri disa hapa nëpër dhomë dhe shkoi e u ul në një karrige pranë raftit. Qëndroi me këmbët e hapura, kokën pështetur në shpinën e karriges dhe me duart e lëshuara anash, pa jetë. Gruaja nuk lëvizi fare. Ai i foli. Ajo nuk ju përgjegj. Isha i bindur se ajo nuk flinte.

Papritmas ai kërceu në këmbë si ta kishte shtyrë një sustë e padukshme. Shkoi pranë gruas së shtrirë. Zgjati duart drejt saj. Ajo i ktheu shpinën. Ai i zuri flokët. Ja shtrëngoi. Ajo prapë nuk lëvizi. Ai ja mbajti për një kohë flokët të shtrënguar, pastaj shkoi e fiku dritën.

Unë qëndrova aty, pa luajtur nga vendi. Men-

doja për dramën që luhej çdo ditë në atë shtëpi muret bojë trandafili. Përsërita me mend pantomimën e gjatë, që ishte zhvilluar për një muaj e gjysmë para syve të mi. Solla ndër mend disa episode të rëndësishme të saj, i lidha njëri me tjetrin, si gurët e një mozaiku, dhe kuptova shumë gjëra; e kisha tashmë të qartë tablonë e atij çifti, që nuk shkonin mirë njëri me tjetrin.

Pregatitja e shfaqjes së re shkonte mirë. Kisha hedhur në skenë edhe pjesën e dytë dhe së shpejti do të lidhja dy pjesët. Mendoja që pas një jave të bëja provën e përgjithshme dhe pastaj premierën. Ishin ditë dhe net pune intensive.

Disa ditë nuk pashë asgjë të veçantë tek shtëpia dykatëshe. Kur zgjohesha në mëngjez, burrë e grua kishin shkuar në punë. Në drekë, kur shkoja për pak kohë në hotel, i shikoja që ktheheshin nga puna. Nuk flisnin thuajse fare me njëri-tjetrin. Pastaj ai flinte, kurse ajo bënte punët. Unë shkoja në prova dhe, kur kthehesha natën, shtëpia i kishëte dritat të shuara dhe lagjja ishte e qetë. Vetëm llambat e rrugës lëshonin dritë mbi kalldrëm, mbi muret dhe mbi gurët e bardhë që ngriheshin ndanë dyerve të mëdha.

Prova e përgjithshme shkoi mirë. Këshilli artistik e aprovoi shfaqjen dhe kishte pak vërejtje. U vendos që të dielën të jepej premiera. Vendosa që të hënën të largohesha nga qyteti, se më priste troupa ime për të nisur një shfaqje të re.

Të dielën isha i lirë. Bëra disa vërejtje, dhashë porositë për premierën dhe ndryshova dritat në finale të shfaqjes. Isha i emocionuar dhe nuk shkova fare në hotel. Hëngra drekë dhe u solla ca kohë rrugëve. Pastaj shkova në teatër.

Premiera u prit mirë. Publiku e ndoqi me interesim. Unë isha gjithnjë i emocionuar, megjithëse e dija se puna kishte vajtur mirë. Pas shfaqjes shkuam me gjithë aktorët e shokët e tjerë të teatrit në klubin e pallatit të kulturës dhe pimë nga një birrë edhe për premierën, edhe për largimin tim.

U ktheva në hotel pas orës njëmbëdhjetë. Futa në valixhe plaçkat dhe librat. Gjumë nuk kisha. Shkova para dritares. Shikova lagjen. Ishte hera e fundit që e shihja natën. Më erdhi keq. Ndjeva se po ndahesha nga diçka që vërtet kishte hyrë në jetën time, më ishte bërë e afërt, e dashur. Gjatë më shumë se dy muajve ajo më kishte përfshuar ndjenja e mendime nga më të ndryshmet. Kryesisht kjo ndodhë prej shtëpisë dykatëshe me muret bojë trëndafili dhe prej jetës së atij çifti, që më kishte tërhequr aq shumë, duke më bërë të mendohem gjatë për të kuptuar pantomimën e tyre.

E kalova shikimin nga një shtëpi në tjetrën, nga oborret, nga rruga me kalldrëm, nga gurët e bardhë ndanë dyerive dhe pastaj sytë qëndruan tek shtëpia që e njihja aq mirë. Po ç'është kështu... Aty ishin ndezur të gjitha dritat. Ishte gati mesnatë dhe ajo shtëpi ishte e zgjuar. Po, po, dritë poshtë dhe lart. Në kuzhinë tre burra, bashkë me të shoqin, ishin ulur rrëth tryezës. Siç duket po pinin. Lart, në dritare, rrinte gruaja dhe shikonte natën, pështetur në parvazin e dritares.

Burrat poshtë pinin e qeshnin. I shoqi doli në oborr dhe i thirri. Ajo në fillim nuk ju përgjegj, pastaj me ca lëvizje të ngadalta zbriti poshtë dhe hyri në kuzhinë. U shtroi diçka dhe, pa shikuar asnjërin prej tyre, u ngjit prapë lart. Burrat heshtën. I shoqi e ndjeu veten ngshtë. Doli në oborr dhe e

thirri prapë. Kësaj here ajo nuk ju përgjegj dhe nuk lëvizi nga vendi. Ai vazhdoi të fliste dhe të tundte duart. Ajo qëndronte si një statujë pranë drifores, duke shikuar natën.

Pas pak burrat u ngritën. I shoqi i përçolli dhe mbylli derën. U ngjit menjëherë lart. Filluan të grindeshin. Në fillim foli vetëm ai. Gruaja nuk u përgjegj. Pastaj nisi të fliste dhe ajo. Kjo e inatosi më keq të shoqin. Ai ju afrua dhe e qëlloi me shuplakë. Ajo u shtri përmbyss mbi shtrat dhe flokët ju përhapën mbi çarçafin e bardhë. Ai i shkoi pranë, e zuri për flokësh dhe e goditi. Atëhere ajo u ngrit, e shtyu dhe me hap të vendosur doli nga dhoma. Zbriti shkallët dhe ju afrua derës së oborrit. I shoqi e ndoqi. Ajo desh të hapte derën, ai e shtyu dhe e kapit pér supesh. Ajo u pérpoq të shkëputej, por nuk ja arriti. Ai e shtrëngonte fort. Gruaja i ktheu shpinën derës dhe u ngjit lart me hap të ngadalshëm. Burri i shkoi pas. Por ajo nuk u shtri në shtrat. E lëshoi veteen pa fuqi mbi karrige dhe mbuloi fityrën me duar. I shoqi qëndroi në mes të dhomës, e shikoi, pastaj fiku drithën.

Atë natë më mori gjumi vonë. Sillja ndër mend premierën, pritjen që i bëri publiku shfaqjes, dhe njëkohësisht në këto mendime përzuhej edhe mendi-mi pér çiftin që banonte në shtëpinë me muret bojë trëndafili, dhe pér ngjarjen e asaj nate.

Nuk e di se kur më zuri gjumi. U zgjova vonë. Shikova orën. Autobuzi nisej pas një ore. Kisha disa plaçka pa rregulluar dhe duhej të paguaja hotelin.

U ngrita me një frymë dhe pa humbur kohë futta plaçkat e fundit në valixhe. Pashë në raft dhe në komodinë se mos kisha harruar gjë.

Duke veshur xhaketën, hodha sytë pér herë

të fundit nga lagjja. Ajo ishte e qetë. Dielli derdhej mbi pullaze, oborre dhe mbi kalldrëmin e rrugës. Shtëpia dykatëshe ishte e heshtur, e zbrazur. Ata kishin shkuar në punë.

Poshtë më prisnin disa aktorë dhe drejtori i teatrit.

— Keni kohë, — më tha njëri prej tyre, duke më parë që nxitoheshha.

— Nuk niset në orën tetë autobuzi?

— Po tani është tetë pa njëzet. Ja ku është axhensia, dy hapa.

Filluam të ecnim pa u ngutur. Papritmas qëndrova, sikur të më kishte goditur njeri. Para meje ishte ajo gruaja që banonte në shtëpinë dykatëshe. Po, ajo ishte. E njihja nga të ecurit, nga fustani dngjyrash, nga mënyra si i kishte flokët, nga çanta që mbante në duar.

Ajo ecte para meje me hap të shpejtë, të vendosur, pa kthyer kokën anash.

Papritmas ajo qëndroi. U mendua një çast, vetëm një çast dhe pastaj ktheu rrugë dhe hyri në një ndërtesë të madhe.

— Çfarë është këtu? — pyeta.

— Gjykata e rrëthit, — m'u përgjegjën.

RRUGË TË MBARE, DIZI!

Përmes korridorit të gjatë, të ndriçuar, Ana pa Dizin që ishte në vagonin e dytë. Ajo nuk pastronte. Rinte pa lëvizur para dritares. Shikonte jashtë.

Treni i natës, që kishte mbërritur në stacion para një ore, rrinte i qetë mbi shinat e stacionit. Vagonat e zbrazur mbanin ende erë duhan, mollë, sendesh e ushqimesh të tjera, që nuk i përcaktoje dot. Maqinistët kishin ikur në shtëpi dhe tërë garnitura, me vagonat bojë deti, rrinte palëvizur në stacionin e qetë. Dy konduktoret po bënин pastrimin e vagonave.

Anës prapë i bëri pështypje qëndrimi i Dizit. Edhe gjatë ditës ajo kishte vënë re se shoqja rrinte si e hutuar, e myllur dhe kishte folur shumë pak. Madje dy herë e kishte gjetur të fshehur në dhomën e vogël të konduktorëve.

E la punën dhe eci drejt vagonit të dytë. Hapi i saj ushtonte nëpër vagonat e heshtur dhe figura i reflektuhej e turbullt nëpër xhamat e dritareve.

Dizi nuk e ndjeu kur ju afrua. Shikonte jashtë dritares. Një lokomotivë e vetmuar ecte tutje-tëhu mbi shinat e stacionit, duke dihatur rëndë. Diku, në errësirë, dëgjohej një bilbil që fishkëllente herë

pas here, duke drejtuar manevrat e një garniture me vagona mallrash.

Ana e shikoi një copë herë, pastaj e pyeti:

— Çfarë bën, Dizi?

Ajo nuk e ktheu kokën. Anës ju duk se ajo e dëgjoi pyetjen, megjithatë nuk lëvizi.

— Me ty po flas, Dizi.

— Hë, Ana? — tha Dizi. Zëri i saj dukej sikur vinte nga larg.

— Çfarë po bën? — e pyeti prapë Ana.

— Nuk e shikon? Po rri.

— Pse nuk pastron?

— U lodha. Po pushoj pak.

Të gjitha këto Dizi i tha me zë të zvargur dhe çuditërisht të qetë. Pastaj u largua nga dritarja, u ul në sedilen e butë dhe mbështeti duart mbi tryezën e vogël.

Nuk ja shqiste sytë. Ju duk se fytyra e Dizit ishte më e hequr dhe tiparet më të zvogëluara, gati si të një fëmije. Mollëzat pak të dala ishin të skuqura dhe buzët e fryra i mbante gjysmë të hapura. Sytë e saj të bukur shikonin ngultas përpëra, por vështrimi dukej i zbraszur.

— Çfarë ke? — e pyeti Ana.

— Asgjë, — ju përgjegj Dizi.

Lokomotiva e vëtmuar ecte poshtë e lart nëpër stacion. Papritmas ushtoi sirena e saj, që u përzie me fishkëllimën e bilbilit. Pas pak lokomotiva u largua përsëri duke dihatur rëndë.

Ana la fshesën dhe u ul përballë Dizit. Për një çast e harroi shqetësimin e shoqes dhe vuri buzën në gaz: ju duk vetja si udhëtare. Ato udhëtonin çdo ditë, megjithatë nuk e ndjenin kurrë veten si udhëtare. Edhe kur treni s'kishte njerëz, nuk uleshin ku-

rrë nëpër sedile dhe nuk vështronin jashtë të qeta, të shkujdesura, ashtu si udhëtarët.

Ana kishte më se tre vjet që bënte atë punë dhe ishte mësuar shumë, sa, kur i thanë të punonte në zyrën e dispeçerit, kundërshtoi, se nuk donte të largohej nga treni, nga ato udhëtime të pandërpresa, nga takimet me njerëzit, që gjithmonë ndryshonin dhe gjithmonë ishin interesantë; prej secilit mund të mësoje diçka të dobishme dhe têrheqëse.

Dizi ishte e re në atë punë. Ajo nuk kishte mbushur as gjashtë muaj që kur ishte bërë konduktore e udhëtonte me garniturën bojë deti që nga Tirana në Durrës, që nga Laçi në fushat e gjera të Myzeqesë. Megjithatë, edhe ajo ishte dashuruar pas asaj pune të bukur. Kishte një vit e gjysmë që ishte martuar. Në fillim i shoqi nuk e kishte futur në punë. Me zor ishte bindur ta lejonte që të bëhej konduktore.

— Po më duket vetja si udhëtare, — tha me zë të lartë Ana dhe e shikoi Dizin buzagaz.

Edhe Dizi ngriti sytë dhe e shikoi. Ana vuri re se shikimi i saj ishte i turbullt, i shqetësuar, me gjithëse asnijë muskul i fytyrës nuk i lëvizte.

Diku pranë tyre ushtoi edhe një herë sirena e lokomotivës endacake.

— Ja, edhe sirena ra. Gati për nisje! — shtoi pas pak Ana. — Ku ke qejf të shkojmë, Dizi, hë, caktoje, t'i themi maqinistit të na çojë sonte vetëm ne të dyjave.

Në fytyrën e Dizit kaloi hija e një buzëqeshjeje, po kaloi shumë shpejt dhe fytyra e Dizit mbeti prapë e palëvizur, si një maskë.

Ana e shikoi me keqardhje dhe me qortim shqen e saj. që rrinte mbështetur mbi sedilen me

shpinë të lartë, aty në vagonin e zbrazur të garnitu-
rës bojë deti

— Moj Dizi, po çfarë ke? Hajt më trego! — tha
me zë të lartë e me ton gati urdhërues. Priti pak,
pastaj shtoi: — Kam vënë re se sot tërë ditën nuk
ke qenë në rregull. Çfarë të ka ngjarë? Hajt, më tre-
go!

Në peron-kaluan dy burra duke biseduar me
gjallëri. Lokomotiva nuk dëgjohej. Edhe bilbili ki-
shte heshtur.

— Sot qe dita e fundit që unë punova si kon-
duktore dhe ky qe udhëtimi i fundit, — tha më në
fund Dizi me zë të lehtë. — Ferhati do të më largo-
jë nga kjo punë.

Ana nuk foli. Shikoi duart e Dizit. Ato ishin të
mbështetura mbi tryezën e vogël dhe herë shtrën-
gonin njëra-tjetren, herë ndaheshin, pastaj njëra
rrinte aty, kurse tjetra lëvizte mbi tryezë dhe ba-
shkohej me tjetren dhe të dyja shtrëngoheshin, sa-
që lëkura tendosej dhe zbardhej.

-- Ai që në fillim nuk kishte dëshirë të më lin-
te në këtë punë, — vijoi Dizi. — Donte të më fuste
në ndonjë rrobaqepësi, në repartin e fitilave, ose të
qilimave, ku janë vetëm vajza e gra. Ti nuk e njeh,
Ana. Ferhati është xheloz i tmerrshëm. Që në fi-
llim nuk i pëlqeu puna e konduktores. Vazhdimisht
të njëjtat fjalë dëgjoj prej tij: jo po ju bridhni lart
e poshtë, jo po keni punë me burra e djem të rinj
dhe ndonjëri mund të ketë edhe qëllime të këqia, jo
po kështu, jo po ashtu. Unë i kam kundërshtuar.
Ai është nxehur më keq e ka arritur të më thotë:
«Ti ke qejf vetë të bredhësh, ke dëshirë të rrish larg
syve të mi, atje në vagon, në mes të burrave e të
djemve të panjohur». Kjo histori ka disa muaj që

vazhdon. Shpresoja se ai do të bindej dhe do t'i flakte tej dyshimet e tij. Mirëpo pardje dikush i kishte thënë se më kishte parë duke biseduar tërë rrugës Durrës-Tiranë me një djalë të ri. Është bërë si i tërbuar dhe kërkon të më largojoë nga puna. Mbrëmë më tha: «Nesër është dita e fundit e pesëmbëdhjetëdithit, prandaj lajmëroji ata të punës se do të largohesh dhe pasnesër mos u paraqit më atje. Unë kam folur me një shok që të të rregulloj një punë në repartin e qilimave. Atje ka vetëm femra». Kështu më tha, Ana, prandaj për mua sot është dita e fundit e punës në tren.

Në vagonin e zbrazur e të ndriçuar ra heshtja. Dizi ktheu kokën dhe shikoi jashtë. Ana nuk ua shqiste sytë duarve të shoqes, që shprehnin shqetësimin dhe tronditjen e saj.

— Domethënë, deri këtu mbërriti yt shoq! — tha Ana me zë të ulët, sikur fliste me vete.

— Ti nuk e njeh, Ana. Ai nuk ka fare besim tek unë dhe kjo gjë më fyen, më poshtëron.

— Të kuptoj, — ja ktheu Ana, — edhe im shoq në fillim nuk kishte qejf të isha konduktore, por unë i fola, kundërshtova dhe ai u bind dhe tani as që e zë në gojë këtë punë.

— Mihali yt është tjetër njeri. Duke punuar si magazinier në ato depot e mëdha e gjysmë të errëta, është bërë...

— Nuk kanë asnë faj depot as profesioni i tij, moj Dizi.

Dizi e kuptoi se kishte thënë një gjë që nuk ishte e drejtë dhe nuk kishte asnë lidhje me karakterin dhe me mendimet e të shoqit, dhe vazhdoi.

— E kuptoj, por nuk di si ta shpjegoj sjelljen e tij. E beson që ai ka mbërritur deri aty, sa ka po-

rositur njerëz që të më ndjekin për të parë si silem, me kë rri, me kë bisedoj. Sa herë jam me shërbim natën, Ferhati vjen e më pret tek hyrja e stacionit, për të shkuar bashkë në shtëpi. Këtë gjë nuk e bën as nga kujdesi, as nga dashuria. Nuk ka besim tek unë, — tha ajo me zë të lartë.

Ana e pa e habitur. Ajo e njihte Dizin që ditën e parë që kishte ardhur aty, dhe e dinte sa e urtë, sa e përbajtur, sa e qetë ishte. Atë natë, pas punës, aty, në trenin e heshtur e të lodhur nga udhëtimet e ditës, ajo po dëgjonte e po shikonte një Dizi që nuk e njihte. Ne pandehim se dimë çdo gjë për njerëzit me të cilët rrимë me javë ose me muaj të tërë, por në raste të veçanta zbulojmë tek ata cilësi e tipare që nuk i kemi njojur.

Kështu mendonte Ana ndërsa Dizi heshtte dhe shikonte jashtë natën e qetë të shtatorit, të mbushur me nostalginë e verës që sapo kishte mbaruar.

— Çfarë ke ndër mend të bësh? — e pyeti Ana.

Dizi nuk u përgjegj. Ngriti supet dhe e shikoi ngultas shoqen.

— Unë të këshilloj të mos largohesh, — tha Ana dhe ndjeu se një valë e papritur zemërimi po e mbulonte. — Ferhati le të bëjë ç'të dojë. Ti mos ikë nga kjo punë. Ti duhet të kuptosh se këtu nuk është çështja që të ndryshosh vendin e punës, por që t'i bindesh një urdhëri të padrejtë, të përulesh, të pranosh në heshtje një faj që nuk e ke bërë, dhe të heqësh dorë nga një punë që të pëlqen. Apo nuk është kështu.

Dizi nuk u përgjegj. Ajo e ndjeu se shoqja e saj thoshte fjalë me mend, fliste gjëra të vërteta. Ajo kishte vënë re prej kohësh se marrëdhënjet e saj

me Ferhatin nuk ishin të mira, se ai i binte më qafë kot, e merrte nëpër këmbë, e torturonte me xhelozinë e tij dhe ajo deri tani pak kishte luftuar kundër mendimeve e dyshimeve të tij. Sot, tërë ditën, ishte matur t'i thoshte përgjegjësit se do të largohej nga puna, siç e kishte porositur i shoqi, e, me gjithatë, e kishte mposhtur veten dhe nuk kishte hapur gojë. E ndjente se me këtë diçka kishte fituar dhe kjo i kishte dhënë zemër. Por a do ta çonte deri në fund luftën? A do të gjente forca për t'u bërë ballë orteqeve që lëshonte mbi të Ferhati?

Puna e konduktoreve i pëlqente sa s'thuhej. Tërë ajo gjallëri, ato turma njerëzish, me të cilët takohej çdo ditë, e kishin bërë për vete dhe në mes tyre ndjehej e gjuar, e lumtur. Bisedonte përzemërsisht me ndonjë fshatare, që shkonte vullnetare në hekurudhën e re, me ndonjë mësues, që punonte në fshatrat e thella, me ndonjë fëmijë që udhëtonte për herë të parë, njihej me njerëz, mësonte për jetën e tyre, takohej më eskursionistë gazmorë, me grupe amatore, që shkonin në turne, me sportistë zhurmatorë, me pleq, të zgjuar, me vajza që studjojnë në universitet dhe që shkëmbenin fshehurazi shikime me ndonjë shok të kursit, që hypte përpara në tren dhe i zinte vendin.

— Dëgjo, Dizi, hiç mos u dëshpëro, — zuri të flasë prapë me zë të lartë Ana. — Folë edhe një herë me Ferhatin, por tregohu e prerë, mos rri e urtë si manare, se ai atëhere do ta ndjejë veten si dash i fuqishëm. Mos prano, dëgjove, mos prano. Fundi, po nuk u bind, do të kërkojmë të bëhet mbledhja e kolektivit dhe ta thérresim të vijë këtu e të përgjigjet. Hiç mos prano.

— Nuk e kam të lehtë...

— E di. E lehtë nuk éshtë, por edhe e pamundur jo.

— Ashtu éshtë, megjithatë...

— Nuk ka asnje «megjithatë». Ti lufto ta bin-dësh dhe vazhdo punën që ke.

Papritmas Dizi u ngrit në këmbë e zuri të pastronte.

— Ke edhe shumë? — e pyeti Ana.

— Edhe këtë vagon.

— Hajde ta pastrojmë bashkë.

Pas pak ato çuan fshesat tek dhoma e tyre e vogël, që ndodhej në hyrje të vagonit të tretë.

— Nuk e ke marrë pardesynë? — e pyeti Ana, duke veshur fëshfëshen e vet bojëmjalti.

— Jo, nuk m'u duk ftohtë.

— Ditën éshtë vapë, por netët janë freskuar.

Kur zbritën nga treni, stacioni ishte i heshtur. Papritmas u dëgjua dihatja e rëndë e lokomotivës, që endej tutje-tëhu nëpër shinat e stacionit. Nga gjithë zyrat, vetëm ajo e dispeçerit kishte dritë.

Porsa kaluan hyrjen, një hije u shkëput nga errësira. Dizi ktheu kokën nga Ana, mërmëriti «natën e mirë» nëpër dhëmbë dhe shkoi drejt hijes. Pastaj zuri të ecë e heshtur pranë saj.

Ana qëndroi një çast, i ndoqi me sy, pastaj tun-di kokën dhe futi duart në xhepat e ftohtë të pardesysë.

Në stacion, lokomotiva ecte pareshtur dhe dukej e shqetësuar.

* * *

Ushtoi për të dytën herë sirena e lokomotivës së garniturës bojë deti, që ishte gati në nisje. Në peron vrapuan disa udhëtarë. U dëgjua një derë që u mbyll me një krismë të rëndë.

Ana ishte varur tek shkallët e një vagoni me trupin përpëra dhe sytë nuk ja shqiste hyrjes së stacionit. Dizi ende nuk ishte paraqitur në punë. Mos vallë?... Ajo nuk donte të besonte se shoqja e saj i ishte nënshtruar kërkesës së padrejtë të Ferhatit dhe kishte pranuar të largohej nga ajo punë. Megjithatë, derisa ajo nuk kishte ardhur, dome-thënë...

Pranë saj kaluan me vrap disa të rinj, duke folur e qeshur me njëri-tjetrin. Në një dritare, pranë derës së vagonit ku rrinte Ana, ishte një grua, që shikonte pareshtur hyrjen e stacionit. Një burrë me biçikletë e cte poshtë e lart peronit me një zarf në dorë: ishte korrespondenti i gazetës, që conte në Tiranë ndonjë artikull. Inspektori i shërbimit rrinte me fytyrë të kthyer nga lokomotiva dhe nën sqetull mbante tabelën, me të cilën jepte shenjën e nisjes. Ai shikoi orën, rregulloi kapelen e kuqe dhe ngriti tabelën.

Ushtoi për të tretën herë sirena e lokomotivës. U dëgjua një derë duke u mbyllur... Pastaj edhe një tjetër... edhe një tjetër... Të gjitha dyert po mbylleshin. Vetëm Ana nuk e kishte mbyllur derën. Diçka i ishte mbledhur komb në grykë. Treni zuri të lëvizë... Ajo kapi dorezën dhe u mat të tërhiqte derën. Por ja, në hyrje të stacionit ajo vuri re një njeri që

po vinte me vrap. Pa e njohur mirë, e ndjeu se ishte Dizi. Ajo po vraponte drejt trenit.

Anës i rrahu zemra nga gëzimi. Pas pak Dizi mbërriti pranë saj dhe hipi shkallët e vagonit, duke u mbajtur tek parmaku.

— Erdhe, Dizi? — e pyeti ajo dhe shtoi: — Hë, si shkoi puna, bisedove me Ferhatin?

— Po. Qe një bisedë e vështirë për të dy, por ajo duhej bërë. Vura re se atë e nxisin të tjerët, sidomos nga familja e tij. Biseduam gjatë. Nga fundi, Ferhati filloi të flasë pak. Ajo heshtje tregonte se ai zuri të mendohej. Në mëngjerez prapë folëm për çështjen e punës sime. Kur erdhi koha të dal nga shtëpia, i thashë:

— «Unë po shkoj në punë, Ferhat!» Ai më shikoi gjatë dhe nuk foli. Hapa derën dhe erdha me vrap, se isha vonuar.

— Shumë mirë, Dizi, — tha Ana. — Hajde, futu brenda.

— Hyrë ti. Unë do të rri edhe pak këtu.

Treni shtoi shpejtësinë. Dizi rrinte tek shkallët, duke shtrënguar fort parmakun. Dielli i shtatorit ja rrihte fytyrën e skuqur dhe para saj shtrihej rruga. Era e freskët ja shpupuriste flokët e butë dhe i pëshpériste në vesh fjalë të bukura, që e bënin të buzëqeshë. Rrotat e vagonave, me traktrukun e tyre të pandërpërre, dukej sikur i thoshin: «Rrugë të mbarë, Dizi! Rrugë të mbarë, Dizi! Rrugë të mbarë, Dizi!»

MONOLOG

«Ç'kemi, Fatos? Ku je zhdukur? Kam më se dy javë pa të parë. E di që ke qenë në K. për të parë ndërtimin e bicikletës së re. Atje ke ndenjur gjithsej pesë ditë. Që kur je kthyer, nuk jemi parë fare. Ke qenë shumë i zënë? Nuk ke pasur një orë të lirë të vije e të rrinim bashkë, nuk ke gjetur as pesë minuta të më telefonoje?

E di që ke qenë në K. Pse ma përsërit? Më duket sikur e shqipton në mënyrë të çuditshme atë emër të shkurtër. Si the? Ai emër duhet të më kujtojë diçka? S'të kuptoj. Në K. kam qenë më se një herë. Kam dy vjet që punoj në teatër dhe kam bërë turne në gjithë Shqipërinë. Nuk e marr dot me mend se ç'gjë të veçantë ka K. për mua. Të mendohem? Mirë, ja po mendohem dhe nuk më kujtohet asgjë. Meqë ngul këmbë, atëhere më thuaj ti si është puna.

Alo, Fatos, më dëgjon? Ma thuaj ti si është puna. Do të më përmendësh një emër dhe të tjerat duhet t'i kuptoj vetë? Mirë, ma thuaj atë emër. Berti? Mos është dentist ky Berti? Dora vetë? Po, tani më kujtohet. Jam përpjekur ta harroj atë ngjarje dhe këtë emër ta fshij nga kujtesa. Pse thua që tani po

flas si aktore? Ç'kemi tē veçantë ne, aktorët? Dome-thënë edhe ti mendon se, duke luajtur në skenë, nganjëherë vazhdojmë tē luajmë edhe në jetë. Nuk ke tē drejtë. Më vjen keq që flet kështu. Sigurisht që u preka. Fjalët e tua duan tē thonë se puna jonë qen-ka një profesion që na bën hipokritë.

Mirë, nuk po e zgjas këtë çështje. Mos kujto se me këtë dua tē le mënjanë punën e atij Bertit. Posi, po tē duash po ta tregoj fill e për pe.

Në K. kam qenë para një viti. Mbaj mend që ishte fillim vere. Autobuzi arriti në mbrëmje. Siç ndodh në qytetet e vogla, në sheshin e axhensisë ishin grumbulluar shumë njerëz: dikush priste ndonjë tē afërt, dikush tjetër një pako, kurse tē tjerë vinin për tē bërë sehir se kush kishte ardhur në qytet.

Na priti regjizori i trupës sonë, që kishte ardhur një ditë më parë me dekoret. U nisëm drejt hotelit tē ri, që ishte pranë axhensisë.

— Ky është një miku im, — tha regjizori teksha ecnim. Ktheva kokën dhe në krah tē tij pashë një djalë tē ri, trupgjatë, me një fytyrë tē rrumbullakët e lëkurë tē bardhë. Ai po buzëqeshte.

I dhashë dorën dhe u njohëm. E quanin Berti. Atë çast buzëqeshja e tij u zmadhua, si një pikë vaji në letër, dhe i pushtoi tërë fytyrën. Më bënë përshtypje dhëmbët e tij tē bardhë, tē rregulit dhe tē pastruar me kujdes.

— Është dentist, — tha regjizori dhe u nis përpara për tē biseduar me përgjegjësin e hotelit për shpërndarjen e dhomave.

— Më thanë se në këtë shfaqje keni realizuar një figurë tē shkëlqyer, — tha Berti.

— Nuk e di si tē them...

- Më dukeni fytyrë e parë.
- Jam aktore e re. Para dy vjetësh kam mba-ruar institutin.
- Ju kam parë me siguri në Tiranë. Vija shpesh nga instituti juaj.
- Mundet.

U ndamë dhe unë nxitova drejt shkallëve. Mora një dhomë bashkë me Zanën, në katin e dytë, nga ana e sheshit.

Atë natë nuk kishim shfaqje, se ishim lodhur nga rruga e gjatë. U lamë, u ndërruam dhe shkuam të hanim darkë.

Në restorantin e hotel turizmit takova prapë Bertin. E përshëndeta me kokë dhe u nisa drejt një tryze pranë drithares. Pa arritur mirë, ai u ndodh pranë meje.

- Ejani në atë tryezën pranë orkestrës.
- Faleminderit, po edhe këtu nuk është keq.
- Si të doni. Unë për ju e rezervova tryezën atje.
- Për mua, pse?
- Kot. Të hanim darkë bashkë.

Vura re se njerëzit e ulur nëpër tryeza kishin kthyer kokën e po na shihnin. Isha fytyrë e re në atë qytet të vogël dhe kjo tërhiqte vëmendjen e njerezve. Për t'i dhënë fund asaj skene, shkova pas tij dhe u ula në një tryezë me të. Erdhi edhe regjizori aty dhe hëngrëm darkë të tre. Regjizori u ngrit shpejt, se do të shkonte në teatër për të ndjekur montimin e dekoreve.

- Ju pëlqen ky qytet? — pyeti Berti teksha hanim frutat.
- Po.
- Për disa ditë edhe mund ta pëlqesh, po kur

rri një kohë të gjatë, si unë... Ç'tju them... qytet i vogël, provincë e thellë... Nuk ke me kë të bisedosh e të shkëmbesh një mendim për artin, për letërsinë...

— Po edhe këtu ka plot intelektualë, një trupë profesioniste estrade, disa njerëz që merren me letërsi, dhe nuk ma merr mendja të jetë kaq e vësh-tirë të gjesh njerëz që të bisedosh për artin ose për letërsinë.

— Nuk e mohoj, ka disa... por nuk ndjej asnë kënaqësi të flas me ta. Janë njerëz tepër mediokër, se ju e dini që mediokriteti është veçoria tipike e provincës, madje do të thosha se provinca është mbretëria e pafund e mediokritetit.

— Nuk jam në një mendje me ju.

— Ju nuk e kuptioni dot, se vini këtu e rrini disa ditë si turiste. E shikoni jetën në sipërfaqe, njihni vetëm hotelin, teatrin dhe turizmin. Po pa më pyetni mua...

Ishë e kotë ta zgjatja atë bisedë. E kuptova se ai e kishte vënë veten në pozën e intelektualit të sakrifikuar. Unë isha e lodhur nga rruga dhe nuk doja të bëja biseda të gjata.

Folëm pak edhe për disa gjëra të ndryshme, për shfaqje filmash, për shkrimitarë që ai i njinte mirë, ose të paktën kështu shtirej.

U çova shpejt nga tryesa. U mata të paguaja, por kamerieri më tha se llogaria ishte paguar. Shikova Bertin. Ai bëri sikur nuk vuri re asgjë, me gjithëse e kuptoi shikimin tim.

— Pse e bëtë këtë? — i thashë.

— Çfarë?

— Pse e paguat darkën?

— Për këtë e keni fjalën? Gjëra pa rëndësi. U gëzova shumë që hëngrëm darkë bashkë. Pastaj ju

do tē ma shpërbleni nesër, duke më siguruar një biletë pér shfaqje. Mirë? Do tē ikim?

— Po.

Duke ecur pér në hotel, ai zuri tē tregonte diçka pér jetën e tij. Qëndruam para hyrjes. Ai vazhdonte tē fliste. Mua më erdhi zor ta ndërprisja. Sheishi ishte i qetë. Vetëm nga një dritare e hapur vinte një muzikë e ëmbël.

— Koncerti i Dvorzhakut pér violinë e orkستر, — ndërpreu bisedën Berti dhe zuri tē këndon te nën zë. Unë i zgjata dorën. Ai filloi bisedën e ndërprerë. Pas pak kaluan andej disa djem tē rinj.

— Mirëmbrëma, doktor! — thirrën ata dhe na shikuani me vëmendje.

Unë përfitova nga kjo ndërprerje e re, i zgjata dorën e u largova.

— Kur do tē takohemi nesër? — thirri ai pas meje.

— Nuk do tē kem kohë. Jam në prova.

— Mos harroni biletën! — thirri ai prapë. Zana nuk kishte fjetur. Po lexonte. Nuk tha asnë fjalë pér punën e darkës.

U zhvesha dhe hyra në shtrat. Nga dritarja e hapur viniñ notat e koncertit tē Dvorzhakut.

Të nesërmen, nga ora njëmbëdhjetë, duke bërë provën e tablosë së fundit pér t'u ambientuar me skenën e re, më afrohet një nga punëtorët e skenës.

— Të kërkojnë jashtë, Flora.

— Kush është? — pyeta, megjithëse e mora me mend.

— Nuk e njoh. Më tha se e quajnë Berti.

— I thuaj se jam e zënë në prova.

Ai u kthyte pas disa minutash. E pashë që rrinte

e më vështronte. Porsa mbarova rolin tim, m'u afroa:

— Më tha se të pret në drekë në turizëm, — tha me një ton fshehtësie dhe intimiteti.

Nuk ishte vështirë të kuptoja se ai po më vinte rrotull, duke menduar se nuk ishte ndonjë mundim i madh të shtije në dorë një artiste. Ka plot njerëz që mendojnë kështu. Edhe ti nuk ke mendime të drejta për ne, aktoret, Fatos. Mos kundërshto, ashtu është. E kam vënë re disa herë dhe sot u binda edhe më mirë. Nejse, po vazhdoj, megjithëse nuk kam asnje dëshirë të sjell ndër mend këto gjëra.

Ku mbeta? Ah, po, faleminderit që ma kujtovë. Atë drekë nuk shkova të haja në turizëm. Mora Zanën dhe shkuam në një restorant të vogël afër pazarit. Ishte vend shumë i bukur. Nga dritarja dukej zalli i bardhë i lumbit. Në zall kishte një grumbull fëmijësh, që laheshin në vijën e hollë të ujit të lumbit.

Porsa kamerieri na solli supën, në restorant hyri Berti. Në atë qytet të vogël nuk ishte vështirë të na gjente. Vura re se kishte ndërruar kostum. Hoxhi syzet e diellit dhe u drejtua nga tryeza jonë me atë buzëqeshje që s'i ndahej nga buzët.

— Mund të ulem? — tha ai dhe, pa pritur përgjegjen, u ul.

Shikova Zanën. Ajo hante e qetë. Më erdhi inat dhe fillova ta haja supën me nxitim.

Berti dukej shumë i qetë dhe i kënaqur. Porositi drekën dhe zuri të fliste. Bënte edhe ndonjë pyetje, që unë i përgjigjesha shkurt. Ai s'e prishte terezinë dhe shihte punën e tij. Nisi të tregonte ngjarje të ndryshme, fliste për shkrimitarë, piktorë, artistë kinemaje.

Nuk mohoj se kishte një kujtesë të fortë pér tē mbajtur mend emra pas emrash.

Sa mbaruam drekën, u ngritëm menjëherë. Ai u çua pas nesh.

— Prit tē tē sjell tē dytën, doktor, — i tha kamerieri.

— U ngopa. Nuk dua tē ngjallem.

Kamerieri e shikoi me një buzëqeshje plot djallëzi. Zumë tē ecim nëpër rrugët e mbushura me njerëz. Berti përshëndeste pareshtur kalimtarët, që na shikonin me kujdes.

Para hotelit u përpoq tē na mbante me muhabet, po ne ja premë shkurt dhe u ndamë.

— Mos harro biletën, — thirri ai nga prapa.

— Mirë, — i thashë unë dhe hymë në holl tē hotelit.

Kur morëm çelësin, portieri plak, duke më shikuar sipër syzeve, më pyeti:

— Doktor Berti ishte ai?

Ne e shikuam tē çuditur. Ai tundi kokën dhe na zgjati çelësin pa folur më.

Pasdite, kur shkova në teatër pér shfaqjen, e gjeta Bertin që më priste nja dyqind metra pàra teatrit. U afrua me buzëqeshjen e tij tē pandarë dhe më tha:

— Pregatitem tē shoh një shfaqje tē mrekulluese dhe ju do t'ju duartrokas me gjithë shpirt.

Nuk fola. Vazduham tē ecnim drejt teatrit në heshtje. Që në drekë i kisha dhënë tē kuptonte se nuk kisha dëshirë tē rrija e tē bisedoja me tē, me gjithatë, Berti bënte sikur nuk e vinte re fare këtë gjë. Unë bëja timen, ai tē vetën. C'dreq njeriu është ky! — thosha pareshtur me vete.

Para teatrit ishin grumbulluar shumë njerëz.

Kjo gjë sikur e gjalleroi më shumë dentistin. Filloj të fliste me zë të lartë, duke buzëqeshur papushim e duke zbuluar kështu dhëmbët e bardhë, të rregullt, të pastruar me kujdes.

— Tani do t'ju sjell biletën, — thashë pa e shikuar dhe çava në mes të njerëzve.

Duke ecur, dëgjova që ai u tha disa njerëzve që kërkonin biletat: «Nuk kam. Mua më ka siguruar Flora. Është ajo aktorja që luan rolin kryesor. Ç't'i bësh!»

I dërgova biletën me inspektorin e skenës dhe nisa të bëja grimin, duke përsëritur bëtat e para të dramës.

Pasi u mbyll sipari dhe u shuan prozhektorët, hyra prapë në kabinë për të hequr grimin.

— Ku do të hamë sonte? — më pyeti Zana duke lyer fytyrën me vazelinë.

— Të shohim, — i thashë.

— Apo do të hash me atë dentistin, — tha ajo pa të keq.

— Je në vete? Pse ç'kujton ti se jam unë?

— Më fal, nuk desha të të fyeja, — tha ajo menjëherë. Vura re se u skuq.

U pendova që i fola ashtu. Ajo nuk kishte asnje faj. Isha shumë e zemëruar me veten time dhe me atë dentistin që buzëqeshte, dhe ju shkreha pa të drejtë Zanës.

Ajo hoqi grimin dhe doli nga kabina pa folur. Unë u vesha ngadalë dhe dola e fundit nga teatri. Mendova se Berti, duke parë se nuk po dilja, do të mërzitez dhe do të largohej. Më kishte gënjer men-dja. Kjo mund të ndodhte me ndonjë djali, që e di fjalën «turp» dhe «mirësjellje», por jo me Bertin. Ai po rrinte para teatrit.

M'u afrua dhe më derdhi një ortek me komplimenta. Ju përgjegja shkurt dhe vazhdova të ecja shpejt drejt hotelit. Para turizmit ai qëndroi dhe më pyeti:

- Nuk do të hysh?
- Do të shkoj të fle, më dhemb koka.
- Pas suksesit që korrët, duhet ta lagim....
- Jo, do të shkoj.

Nuk qëndrova fare para hotelit. As ai nuk u ndal. Tek shkallët u ktheva dhe e shikova ashpër. Në holl i thashë: — Natën e mirë.

Ai tha:

— Keni nevojë për ndonjë gjë? Të thërras ndonjë mjek?

— Jo. Faleminderit.

Duke ngjitur shkallët, dëgjova që foli:

— Takohemi nesër, Flora.

Në krye të shkallëve takova portierin. Më shikoi me vëmendje, me ata sytë e tij të vegjël, të qetë, të zgjuar. Shikimi i tij më bëri përshtypje.

U shtriva në shtrat pa e ndezur fare dritën.

Ekuptoja se nuk kisha asnë gabim, as ndonjë faj e, megjithatë, sikur e ndjeja veten fajtore përdicë. Më vinte inat që më ishte qepur prapa ai dentisti, me atë buzëqeshje të ngrirë e të shtirë në buzë.

Gjumi s'po më zinte. Dëgjova Zanën që u kthyesh pas ndonjë ore. Hyri në majë të gishtave, nuk e ndezi dritën që të mos më shqetësonte.

Të nesërmen shkuam me disa shokë të trupës nga lumi. Moti ishte i bukur dhe një pluhur i artë që derdhur mbi shtëpitë e reja, mbi rrugët, mbi zallin dhe mbi kodrat rrreth qytetit.

Atë paradite bëmë shaka, dolëm në fotografi

dhe thithëm ajrin plot kundërmime që vinte nga kodrat e blerta. U përpoqa ta harroja fare Bertin. Ai më dukej shumë larg, diku, përtej kodrave e maleve. Një shoku im, Koli, që shakanë e ka në majë të gjuhës, bëri nja dy aluzione për të. Unë nuk ja vura veshin dhe ai nuk e zgjati.

Në drekë e takuam në turizëm. Po më priste. Unë bëra sikur nuk e pashë. U ula me shokët e trupës. Mirëpo Berti, si pa gjë të keq, erdhi e u ul në tryezën tonë. Nisa të haja pa e vënë re. Në atë mënyrë ndoshta po i shtyja shokët të mendonin sikur kishte gjë në mes tonë, po nuk munda të veproja ndryshe. E dija se nuk do të fitoja gjë, pasi ai djalë, siç dukej në fytyrë, nuk kishte lëkurë, por shuall.

Edhe në darkë m'u qep prapa. Erdhi në shfaqje dhe pastaj përséri u ul me ne në restorant. Madje pagoi edhe darkën për të gjithë. Unë i rrija ftohtë, por atij kjo gjë nuk i bënte fare përshtypje dhe nuk i shuhej për asnjë çast ajo buzëqeshja e pështirë.

Sapo më zinte gjumi, kur dëgjova tingujt e një kitare, që hynë nga dritarja e hapur si një tufë fluturash nate. Në fillim nuk e kuptova si ishte puna dhe ashtu si nëpër gjumë, dëgjoja e kënaqur muzikën. Më dukej sikur ishte zëri i asaj nate të bukur në fillim të verës. Pas pak dikush zuri të këndonte.

— Janë poshtë dritares sonë, — tha Zana dhe u ngrit.

E kuptova menjëherë si qe puna. Berti, me ndonjë shok të tij, po na bënte serenatë. Edhe kjo mungonte. Tani do ta marrin vesh të gjithë se na ka bërë serenatë. Gojët e këqia do të thonë: «Epo ç'pret prej saj? Aktore hesapi! Kështu janë ato!»

Më pu^{sh}toi një zemërim, që s'e them dot. Por

nuk kisha ç'të bëja. Muzika vazhdonte. Dëgjova zëra. Disa klientë të hotelit kishin dalë në dritare. Nga sheshi dikush thirri. Një tjetër ju përgjegj. Pastaj u dëgjua një e qeshur e fortë. Kënga nisi të dëgjohej gjithnjë më pak. Ata u larguan. Dëgjova zhurmën e hapave nëpër sheshin e shkretë.

Prapë s'kisha gjumë. Isha e shqetësuar, më vinte inat. E dija se nuk kisha faj, por nuk mund të bëja asgjë. Zura të merrja me mend se ç'mund të thoshin klientët e hotelit, shokët e trupës, njerëzit e qytetit.

Zana u mat të thoshte diçka. Nuk foli. Edhe unë nuk bëra zë. Kapa jastëkun me inat, e mblodha shuk dhe e vura nën kokë. Sytë i drejtova nga dritarja e hapur, prej nga shikonte nata e qetë e qershorit.

Të nesërmen ishte dita e fundit që do të jepnim shfaqje në K. Ai turne i shqetësuar do të merrete fund. Por kisha përpëra edhe një ditë tjetër. Më dukej, se, ngado që shkoja, njerëzit më shikonin dhe më dukej sikur thoshin: «Kjo është ajo...» Ndonjë nga trupa jonë vinte buzën në gaz. Nikoja tha: «Mbrëmë m'u kujtua skena e ballkonit nga Romeo e Zhuljeta!»

Bertin nuk e pashtë gjithë ditën. Qëndrova shumë kohë në hotel. Nuk guxoja të dilja rrugëve. Nuk veproja mirë, por nuk kisha ç'të bëja. Kështu jemi ne, vajzat. Ose, më mirë, shumica jonë. Mund të na paraqesin autorët e dramave si heroina të përparuara, si luftëtare të pamposhtura, por në jetë është ndryshe. Shumë nga ne nuk kanë ende besim e kurajo t'i bëjnë ballë sulmit të fjalëve, të dyshimeve të kota, të thashethemeve, të aluzioneve të këqia...

Natën e fundit që do të rrinim në K, drejtoria e

shtëpisë së kulturës shtroi një darkë për ne. Nuk kisha ç'të bëja. Isha e detyruar të shkoja, pasi unë interpretetoja rolin kryesor dhe mungesa ime do të binte në sý.

Në darkë ishte edhe Berti. Kishte veshur një kostum të ri, me këmishë të bardhë dhe kravatë bojë argjendi. Ai m'u afrua menjëherë. Unë bëra sikur s'e vura re dhe shkova në një tryezë, ku ishin shumë shokë e shoqe të trupës. Si zakonisht, dentistit nuk i bëri përshtypje kjo gjë dhe u afrua tek tryeza jonë, më drejtoi dy-tri herë fjalën. Unë mezi ju përgjegja. Na shikonin dhjetëra sy dhe shumë prej tyre mendonin se midis nesh «diçka kishte». E kuptoja, ashtu si në disa raste të tjera, se qëndrimi im e forconte atë dyshim.

U ngrita para të tjerëve dhe u nisa për në hotel. Berti doli menjëherë pas meje. «Kushedi ç'do të pëshpërisin ata në sallë», — mendoja duke ecur. Ai nuk pati guxim të më ndalte. Ekte disa metra larg meje. Dëgjoja pas vetes hapin e tij. Ai më ndiqte nga pas si një hije.

Kur shkova të merrja çelësin, portieri më tha duke më shikuar sipër syzeve të tij të bardha:

— Mbaroi darka?

— Jo.

— Aha, qenke ngritur para të tjerëve.

Nuk fola. Ai më shikoi gjatë. Edhe unë nuk lëviza nga vendi. Qëndrova para sportelit, pa ditur ç'të bëja.

— Ta kuptoj hallin, moj vajzë, — tha papritmas plaku.

Nuk u zemërova me fjalët e tij. As nuk më erdhi çudi. Isha e qetë, e nënshtuar, pasive. Më

ndodh nganjëherë të bëhem e tillë. Nuk doja të shkoja në dhomë e të mbetesha vetëm në mes të katër mureve. Edhe të rrija aty nuk kisha dëshirë. Megjithatë, qëndroja aty. Isha indiferente për çdo gjë, madje gati si e mpirë.

E lashë plakun të flasë. Ai vijoi:

— E njoh mirë atë Bertin. Kështu bën ai. Ka qejf të shoqërohet me vajza të bukura. Do që të duket dhe të besojnë të tjerët se asnje vajzë nuk i bën dot ballë. Kam kohë që punoj në këtë hotel dhe di ç'flas...

Fjalët e plakut më bënë të mendohem. Ç'është e vërteta, edhe unë kisha kuptuar tanimë shumë gjëra, megjithatë, plaku e bëri më të plotë portretin e atij Tartarini, që jetonte në K.

Të nesërmen u nisëm. Ai, si pa gjë të keqe, erdhë të përshëndetej me mua. Unë hipë në autobuz pa e shikuar fare. E marr me mend se kjo nuk do t'i ketë bërë fare përshtypje dhe nuk do t'ja ketë shuar buzëqeshjen nga ftyra e tij lëkurbardhë.

Berti ndenji me shokët e trupës, foli me regjizorin dhe në fund u përqafua me dashuri të madhe. Kaloi nja dy herë para xhamit. Unë kisha ngritur sytë dhe shikoja kodrat rrëth qytetit.

Kjo është e tëra, Fatos. Nuk di a më beson. Sigurisht, ti mund të kesh dyshimet e tua, megjithatë, të siguroj se nuk të fsheha asgjë. Tani që e mbarova tregimin tim, jam e qetë, shumë e qetë. Më iku ai shqetësimi që kisha në fillim. Si the? Po, ndoshta ke të drejtë: është një gjendje shpirtërore e ngjashme me atë që ndjeva tek sporteli i hotelit K. Kështu më ndodh nganjëherë, sidomos kur pësoj ndonjë zhgë-

njim... Si? Si? Të ka treguar dashurinë e madhe që
pati me mua! Dhe ti e ke besuar. Po pse të mos e
besoje? Aktore jam unë...

Si the? Jo, jo, s'kemi ç'të bisedojmë tani për
tani. Më vonë? Shohim e bëjmë...»

H E S H T J A

Një ditë, më duket ka qenë e hënë, shkova bashkë me shefin tonë për të filluar punën. Kur hymë në oborrin e ndërmarrjes, ai më tha duke më treguar një ndërtesë të re.

— Ja, ky është vendi ku do të punosh, Erzie.

Brenda ishte një sallë e madhe, me shumë tryeza e shumë shtylla. Vendi i bufesë ishte i gjerë, pasi mendohej që aty më vonë do të vendoseshin slobat elektrike për të gatuar gjellët e mensës së ardhshme. Në një cep ishte një raft i zbrazur, furnella, lavamani me rubinet të verdhë. Brenda kishte kundërmime të përziera djathi, sallami,ëmbëlsirash e kafeje. Përtokë ishin disa letra të hedhura. Gjithashka ishte siç e kishte lënë bufetierja tjetër, para se të merrte lejen e lindjes.

— Fillo pastrimin, — më tha shefi. — Po shkoj të porosis të të sjellin furnizimin.

Kur erdhi karroca e furnizimit, unë kisha mbaruar punë. Vendosa gjérat nëpër vende, vura ujin mbi furnellë dhe nxora kokën në sportel, duke pështetur brrylet mbi dërrasën e lëmuar.

Në sallë nuk kishte njeri. Punëtorët ishin në-

për reparte. Donte edhe një orë të bëhen pushimi i drekës.

— Ti je bufetierja, banakierja e re — dëgjova një zë të thellë gruaje, që foli dilku pranë meje. Ktheva kokën. Në një anë të sportelit pashë një grua të moshuar, me një trup shulak, me flokë të thinjur, të mbledhur shtuk pas zverkut, dhe me sy të ashpër. Në dorë mbante një fshesë.

— Dora vetë. Po ti, pastruese je?

— Pastruese, — u përgjegj menjëherë, sikur ta priste atë pyetje, dhe shtoi: — Kam pesëmbëdhjetë vjet këtu. Ca kohë më çuan të punoja në teatër, pastaj në turizëm, por u ktheva prapë këtu. Jam mësuar, nuk largohem dot nga ndërmarrja.

E shikova e habitur. Po të më thoshte njeri se ajo grua e moshuar, me ata sy të ashpër, ishte kaq e muhabitetit, nuk do t'i kisha besuar. Pas pak ajo nisi të më tregojë për jetën e saj. Ishte ndarë me burrin dhe i kishte rritur vetë fëmijët. Dukej grua e fortë, e vendosur dhe çdo gjë, të mirën dhe të keqen, e shikonte drejt, me sytë e saj të ashpër.

Në fund tha:

— Ma bëj një kafe me pak.

Ja preqatita kafenë dhe i thashë me buzë në gaz:

— Ti je klientja e parë.

Por ajo nuk foli më. Rufiti kafenë, pagoi dhe doli nga salla duke tërhequr fshesën.

Atë kohë u bë pushimi i drekës. Salla e qetë ushtoi nga zérat dhe hapat e njerëzve. Para sportelit u grumbulluan shumë punëtorë. Zura t'u shërbuja. Vura re se shumica ishin të reja e të rinj. Në mes tyre kishte edhe të moshuar. Klubi gumëzhinte si zgjua. Tryezat u mbushën plot, karriget lëviznin

me zhurmë dhe në çdo cep dëgjoheshin copa bise-dash, thirrje, qeshje. Të them të drejtën, ajo gjallëri e menjëhershme sikur më hutoi në fillim.

Kur grumbulli filloi të rrallohej, pashë Refiku. Ai po rrinte në një cep të sportelit dhe më shikonte me buzë në gaz.

— Fillove? — më tha pas pak. — Hajt me këmbë të mbarë! Tani më bëj një kafe për merak. Ti e di si e pi unë, Erzie.

Disa kthyen kokën dhe e shikuan. Mua se si më erdhi. Refiku nuk e prishi gjakun, por tha:

— E, ç'keni që shikoni. Është gruaja ime. Ka gjë për t'u habitur këtu?

Dhe qeshi. Të tjerët vunë buzën në gaz. Edhe ata, si unë, e dinin që Refiku ishte njeri i shakave dhe që s'e vriste mendjen shumë. Vjehërrı im gjithmonë i thoshte, kur ishte gjallë: «Ej, Refik, po dymbëdhjetë të bie ajo orë e shkretë!»

Atë mbrëmje u ktheva në shtëpi e gjëzuar. Puna e re më doli pikërisht ashtu siç e kisha menduar. E bukur, tërheqëse. Kohët e fundit kisha shërbyer nëpër kafene të mërzitshme në periferi të qytetit, shpesh kisha bërë fjalë me kamerierë grindavecë e klientë të pakënaqur. Kurse aty ishte krejt ndryshe.

Një ditë, nja dy javë pasi kisha filluar punën, po rrija duke biseduar me Rebien, punëtoren e shërbimit me sy të ashpër. Ajo më tregonte disa gjëra të reja ngajeta e saj. E dëgjoja me vëmendje, pasi ishte grua e zgjuar, e rrahur ngajeta dhe gjërat i kuptonte shumë mirë. Punëtorët ishin të gjithë nëpër reparte dhe klubit ishte i qetë.

Mund të ketë qenë ora tetë ose nëntë, nuk e mbaj mend mirë. Nëjse, kjo nuk ka rëndësi. Në klub erdhi Refiku.

— Erzi, më bëj një kafe.

U mata ta pyesja se përse nuk ishte në punë, por nuk fola. Sa vura xhezvenë, ai tha:

— Ma mbush edhe një fernet.

Ai mori gotën, vuri brrylin në sportel, më shkeli syrin dhe tha:

— Gëzuar, nuse!

Pasi i dhashë kafenë, nisa të bëja llogaritë, se do të shkoja pér të dorëzuar paratë. Kur u ktheva në sportel, Refiku nuk ishte më aty. Kishte lenë gotën e filxhanin e zbrazur dhe kishte ikur. Më erdhi qudi. Si iku pa paguar? Të paktën të më përshëndeste, të më thoshte nuk kam para me vete, nuk kam të vogla, ose diçka tjetër, por jo të zhdukej ashtu fshehurazi, si një... nuk ma mban goja ta them.

Në drekë erdhi prapë. Mori një panine me sallam dhe futi dorën në xhep. Mora frymë e lehtësuar. Por Refiku pagoi vetëm paninen dhe shkoi e u ul në një cep të sallës, pa kthyer kokën nga unë.

Tërë atë ditë isha e shqetësuar. Nuk qe puna vetëm te kafeja dhe gota e fërnetit e asaj dite, por mendja më shkonte tek rastet e tjera që mund të përsëritheshin në forma edhe më të ngatërruara. Kisha shtatë vjet që punoja, dhe gjithmonë kisha qenë e rregullt. Nganjëherë isha zënë edhe me ndonjë kamerier, kur shikoja që ai vepronte keq dhe i bënte llogaritë «gabim».

Në darkë prita që ai të më thoshte ndonjë gjë pér atë që ndodhi në mëngjez. Ai bëri sikur nuk kishte ngjarë gjë. Foli e qeshi me fëmijët, madje edhe me mua bëri shaka dhe pas pak, duke fishkëllyer, shkoi në dhomën e gjumit.

Kur po kapërcente prakun e dhomës, desha t'i flisja, t'i thosha çfarë kishte bërë atë ditë, por heshta dhe i përtypa fjalët. Mirëpo pikërisht ajo heshtja ime atë natë u bë burimi i të gjitha të këqiave që ndodhën më pas. Sikur t'i kisha folur, madje edhe sikur të isha grindur, ndoshta kjo gjë do ta bënte të mendohej dhe puna do të kishte marrë një rrugë tjetër. Mirëpo heshta dhe ai shkoi të flinte duke fishkëllyer.

Të nesërmen futa paratë nga xhepi dhe kjo punë u mbyll me kaq.

Një para dite, punëtorët hëngrën mëngjezin, dhe u shpërndanë nëpër reparte. Salla u zbraz. Në një cep dëgjohej pastruesja që fshinte.

— A ta bëj një kafe, Rabie? — i thashë.

— Prit, sa mbaroj.

— Ta vë xhezvenë? — e pyeta. Nuk e di, atë paradite isha në qejf dhe doja ta qerasja pastruesen plakë me sy të ashpër.

— Ta them unë kur të vësh, — tha ajo.

Mora fletoren e llogarive dhe nisa të shkruaja. Atë çast hyri në sallë Refiku. Ishte bashkë me dy shokë. Njërin e njihja. Ishte Astriti një magazinier, i gjatë, me një fytyrë eshtake e sy të vegjël. Tjetrin ishte hera e parë që e shikoja.

Magazinieri me shokun e tij zunë vend pas një shtylle, duke lëvizur me zhurmë karriget, Refiku ndenji në këmbë. Foli diçka me ta, pastaç u drejtua tek sporteli.

— Na mbush tri gota konjak, Erzi, — tha buzagaz dhe më shkeli syrin si pa gjë të keq.

— Nuk je në punë?

— Kam shkuar në magazinë për t'u furnizuar — dhe duke trokitur gishtat mbi dërrasën e lë-

zmuar të sportelit, shtoi: — Mos i vono konjakët, nuse!

Desha t'i flisja e t'i thosha se nuk bën mirë që pi në orar të punës, por prapë heshta. U mbusha gotat. Ai u nis drejt tryezës me kujdes, që mos të derdhë konjakun. Po e mbyll bufenë, mendova, do t'u them se do të shkoj në drejtori. Hoqa me të shpejtë përparësen e bardhë.

— Nuse, na i mbush edhe një herë, — dëgjova nga pas zërin e burrit tim.

Heshta një çast, pastaj thashë me zë të lehtë:

— Do ta mbyll bufenë. Do të shkoj në drejtori.

— E, moj, dhe ti. Një minutë punë është.

Mblodha përparësen shuk, e flaka në një cep dhe mbusha gotat.

— Nuk mund të shkosh më vonë në drejtori?

— Jo.

Refiku më shikoi ngultas, pastaj tha:

— Atëherë na e ler këtu shishen e konjakut.

Edhe unë e shikova ngultas. Shikimi im donte të thoshte: «Nuk ta le shishen. Kështu nuk është mirë. Lere me kaq këtë punë».

Edhe Refiku nuk m'i ndante sytë. Shikimi i tij donte të më thoshte: «E ke kot. Unë jam burri yt dhe ti do të më bindesh. Do ta lesh shishen se s'bën».

Ky dialog i heshtur do të kishte vazhduar edhe më, por Refiku mori gotat dhe u nis drejt tryezës ku rrinin magazinieri me atë tjetrin.

Mbylla sirtarin, mora drynin dhe dola jashtë duke tërhequr derën. Vura re se ajo nuk mbyllej. Atë çast pashë se pas meje ishte Refiku. Ai kishte vënë këmbën dhe s'e linte të mbyllej. Qëndrova e

palëvizur, me fytyrën të kthyer nga dera. Dëgjova pas veshit frymëmarrjen e tij. Kundërmonte erë konjak. «Tani duhet t'i flas, mendova, t'i jap fund kësaj historie një herë e mirë. Kështu nuk mund të vazhdoj më. Heshtja ime atij i duket dobësi, nënshtrim».

Ai i mëshonte shumë derës. U përpoqa ta mbaja, por ai e hapi dhe hyri brenda në bufe. Mori shishen dhe, pa më shikuar në sy, shkoi tek shokët. Duke dalë nga salla, dëgjova që foli diçka. Magazinieri dhe ai tjetri zunë të qeshnin.

Qeshjen e tyre m'u duk se e dëgjoja edhe rru-gës. Nisa të shaja veten rëndë pér heshtjen time, që ishte burimi i të gjitha të këqiave, dhe pér dobësinë që tregoja ndaj tij. Dobësi? Jo, jo, unë nuk jam e dobët. Kjo ishte diçka tjetër. Çfarë? Dashuri, kujdes i tepruar pér të mos e fyer para të tjerëve, apo besim se ai do ta' kuptonte që ishte në rrugë të shtrembër dhe do të pendohej? Nuk e them dot, por dobësi nuk ishte. Atë ditë u solla rrugëve, duke bluar me vete mendime të zymta.

U ktheva në shtëpi e vendosur që t'i flisja patjetër. Por Refiku u kthye vonë. Në mëngjez e dëgjova që u zgjua shpejt dhe doli duke mbyllur pa zhurmë derën e apartamentit.

Atë ditë nuk erdhi në bufe. Unë futa në arkë paratë e shishesë së konjakut, duke psherëtirë e mërzitur.

U takuam në darkë. Shkëmbyem disa fjalë të përgjithshme me një ton të thatë, pa u shikuar në sy. Kur ramë pér të fjetur, ai u kthye me fytyrë nga muri dhe pas pak e mori gjumi. Unë nde-nya zgjuar deri vonë. Mendoja. Në rrugë dëgjohej zhurma e kamionëve, që shkonin pér t'u ngarkuar

në port. Dritat e tyre rrëshqisnin nëpër faqet e mureve të dhomës sonë.

Disa ditë më vonë isha mbyllur brenda në bufe, duke bërë llogaritë. Atë çast trokiti dera. E kuptova se ishte Refiku. Dëgjova zërin e tij: «Erzi, hape derën». Nuk u përgjegja. Ai vazhdoi: «E di që je brenda. Hape, do të marr vetëm një paqetë cigare. Hape». Prapë nuk ju përgjegja. E dija se ai donte të pinte. Ai ndenji disa minuta aty, pastaj këputi një të sharë dhe u largua duke turfulluar. Atë çast më shkoi nëpër mend që të shkoja të flisja me shefin, për t'i kërkuar që të më conte në një bufe tjetër. Por si t'i thosha? Çfarë arësy kisha për të kërkuar largimin? Pastaj kjo gjë ishte shenjë dobësie dhe unë nuk jam e dobët.

Do të flas, thashë, do të flas me Refikun patjetër. Biseda do të jetë e vështirë, e ashpër, por ajo duhet bërë. Është e nevojshme. Ç'them kështu? Është e domosdoshme. Do të flas me të. Nuk do të hesht më.

NË ANEKS

Ai kishte dy vjet që kishte marrë apartament, dhe unë nuk i kisha vajtur asnjëherë për vizitë. Nuk kisha ndonjë miqësi të ngushtë me të; megjithatë, kur takoheshim më të rrallë, bisedonim ose pinim ndonjë kafe në klubin e pallatit të kulturës.

Të shtunën e takova në një ekspozitë të re pikture (ai nuk le asnjë aktivitet artistik pa ndjekur) dhe më ftoi në shtëpi.

— Do të vij nesër, — thashë i vendosur.

— Të pres, — tha ai i gjëzuar.

Të dielën, në orën katër e gjysmë, trokita në derën e apartamentit të Nardit. Ma hapi ai vetë: ishte bashkë me gruan.

— Kjo është gjysma ime, — tha me shaka dhe tërë fytyra ju çel nga një buzëqeshje.

Gruaja dukej më e re se ai: ishte e veshur me shije, kishte tipare të rregullta dhe dukej mjaft e përzemërt.

Më futën në kuzhinën plot dritë e ajër, të cilën e përdornin edhe si dhomë pritjeje.

— Kuzhinën e paskeni të madhe, — thashë duke hedhur sytë përreth.

Nardi më tregoi se aty kishin dy dhoma: në

njérën flinte ai me gruan, kurse tjetrën ja kishin lënë vajzës së tyre dymbëdhjetëvjeçare.

— Pse u bë dymbëdhjetëvjeçë vajza? — u habitë, pasi e mbaja mend që e kisha parë nja dy herë me të atin, dhe më ishte dukur e vogël.

— Posi, — tha i kënaqur Nardi.

— E shoqja thirri vajzën dhe pas pak ajo hyri në kuzhinë.

— Kjo është Brunhilda, — thanë gati me një gojë.

Ajo ishte trupshkurtër, pak e ngjallur, me flokë që dukeshin të pakrehur, dhe me sy të mëdhenj e si të hutuar.

Unë e njihja pak Nardin. Dija vetëm se është pedagog i shkencave të natyrës në filialen e Universitetit, që është hapur në qytetin tonë. Duke biseduar, mora vesh se e shoqja ishte shefe llogarie në komunale dhe vajza studjonte për piano në shkollën e muzikës.

— Po ju si shkoni në teatër? — më pyeti e shoqja, duke mbështetur grushtin e mbledhur poshtë mjekrës vezake.

I fola për premierën që po pregatisnim. Ajo më pyeti për disa aktorë; pastaj zuri të flasë për filmat e rinj, për premierat që jepeshin në kryeqytet. Vura re se edhe ajo, ashtu si i shoqi, ishte e informuar për çështjet e artit.

— Edhe vajza lexon shumë, — tha Nardi.

— Kjo do të sëmuret ndonjë ditë, — pshëreti u e ëma. — Po e mori librin në dorë, nuk ë le pa e mbaruar.

Duke dëgjuar ato fjalë, vajza mbante sytë në dysheme, ndërsa Nardi miratonte fjalët e gruas dhe tundte ngadalë kokën.

Ra zilja. Salloni u mbush me tingujt e saj të hollë. Brunhilda doli dhe u kthyte pas pak:

— Ka ardhur Andrea, baba. Ka një fjalë me ty.

— Është komshiu, — tha Nardi dhe doli ja-shtë. Pas tij u nis e shoqja, pasi i tha diçka nën zë vajzës.

Zura të shikoj me kujdes dhomën. Faqet e mureve ishin të lyera me dy ngjyra. Aty-këtu ishin disa tablo origjinale dhe një riprodhim i bukur i Van-Gogut. Në tryezën e vogël, të mbuluar me një xham të zi, ishte një vazo e gjatë, elegante. Në cepa kishte graçë me lule. Edhe parvazi i dritares ishte plot me lule. Pranë tij ishte televizori, i vënë mbi një tryezë të lartë, që kishte përsipër një xham të trashë. Tërë faqja e murit përballë dritares ishte e mbuluar me një perde të bukur, me lule e figura gjometrike. «Aty do të jetë me siguri aneksi», — mendova unë.

Teksa shikoja perden, vura re se ajo lëvizi. Brunhilda u ngrit nga vendi dhe u zhduk në aneksi. Zura të shikoj prapë tablotë e varura në mure. Atë çast dëgjova një çuçuritje zérash. Në fillim pandeha se flisnin në sallon. Vura re se zërat vinin nga aneksi. Përveç zërit të vajzës, dëgjohej edhe një zë tjetër i thellë, i trashë.

— Kush është aty? — dëgjova që tha shkoqur zëri i trashë. Vajza i tha diçka nën zë. Pastaj foli prapë zëri i trashë.

— Ohu dhe ti! — dëgjova shkoqur zërin e Brunhildës që foli e mërzitur.

Pastaj ajo doli nga aneksi. Mbante në dorë një tabaka. Eci drejt meje me kujdes, që të mos i derdhej gota e likerit.

— Vetëm ju banoni këtu? — e pyeta duke

marrë gotën. Atë çast vura re duart e saj: ishin të bardha, të lëmuara, megjithëse gishtat m'u dukën pak të trashë.

— Po, — tha ajo gati mekanikisht dhe më shikoi e hutuar.

— M'u duk se dëgjova një zë burri në aneks.

— Ah, po, është gjyshi.

— Babai i babait, apo i nënës?

— I babait.

Piva likerin. Brunhilda hyri prapë në aneks me gotën e zbrazur.

Zëri i trashë i plakut u dëgjua përsëri.

— Ma bëj një kafe, — tha ai shkoqur. Vura re se zëri i tij nuk ishte lutës, por shprehte një zemërim të përmbajtur. Të paktën mua kështu m'u duk.

Nuk e dëgjova përgjegjen e vajzës. Ajo nuk foli fare.

Fillova të mendohem për atë plakun që rrinte në aneksin e asaj shtëpie të mobiluar mirë e me plot tablo të bukura. Nardi më tha se një dhomë e kishte ai me gruan, një tjetër vajza e tyre. Domethënë plaku banonte në kuzhinë, ose në aneks.

— Më fal, — tha Nardi dhe u ul aty ku ishte më parë. Ndezi një cigare dhe, duke shikuar ja-shtë, tha:

— Erdhi për punën e djalit të tij. Ka rrezik t'i mbetet në klasë. I dhashë një letër për Samiun, pedagogun e fizikës. Të kuptohemi, nuk ndërhyra që ta kalojë me hatër, por vetëm të ketë kujdes.

— Mirë bëre, se Andoni është njeri i mirë, — tha e shoqja. — Pastaj edhe ai na është gjindur kur kemi pasur ndonjë hall.

— Epo kështu ështëjeta, — tha Nardi rëndë-rëndë dhe thithi cigaren.

Papritmas në aneks u dëgjuan zëra të lartë. Plaku dhe vajza flisnin përnjëheresh. Fjalët e tyre përziheshin e ngatérroheshin, saqë nuk merrej vesh se ç'toshin. Vetëm një gjë kuptohej: ata po grindeshin, Nardi dhe e shoqja u shikuani në sy. Ai u ngrit menjëherë në këmbë dhe, i ndjekur nga e shoqja, hyri pas perdes.

Zërat në aneks nuk pushuan. Foli Nardi dhe u vendos qetësia. Pastaj ai tha me zë të lartë:

— Fjalë është kjo që thua, i dashur baba? Posi, posi, ashtu është. Brunhilda, bëji shpejt kafenë babait.

Doli së andejmi buzagaz, i ndjekur gjithnjë nga e shoqja.

— Gjëra pa rëndësi, — tha dhe më zgjati një cigare.

Nisëm të flasim për ekspositën që vizituam mbrëmë. Vura re se ai fliste bukur dhe shprehu disa mendime interesante. Në bisedë u fut edhe e shoqja.

— Që sonte do të më çosh ta shikoj edhe unë ekspositën, — tha ajo.

— Me gjithë qejf. Unë vetë dua ta shikoj edhe një herë, se më pëlqen maniera e atij piktori.

Folëm edhe për gjëra të tjera. Vura re se biseda ecte me zor, ndizej e shuhej, ndizej prapë e prapë shuhej, si një shkrepse e lagur. Mua më trazonte diçka. Më ishte krijuar në kraharor, një boshillëk, më kishte pushtuar një gjendje e cuditshme. Nuk mund të ngul këmbë se burimi i të tèrave ishte vetëm ai zëri i trashë, i thellë e nervoz që vinte

nga aneksi. Kishte edhe disa zëra të tjerë që ma shkaktonin atë gjendje.

Brunhilda solli kafenë. Unë nisa ta rufisja ngadalë.

— Shko e studjo, — i tha eëma.

Më dha dorën dhe, duke më shikuar me sytë e e saj të hutuar, shqiptoi ngadalë «mirupafshim».

— Studjon piano në shkollë, — tha Nardi, — çdo ditë kjo punë. Ka një vullnet, që të habit. Më pëlqen shumë sidomos kur ekzekuton Shopenin. Ka një delikatesë të rrallë.

— Edhe atë fugën e Bahut e bën, — tha e shoqja.

— Ashtu vërtet, por mua më pëlqen më shumë mënyra si luan Shopenin.

— Duhet t'ja blejmë patjetër pianon, Nardi. Po ta ketë instrumentin në shtëpi, do të studjojë më mirë, apo jo?

— Ke të drejtë, — tha Nardi, pastaj u kthyte nga unë. — Kushton ca, por do të shtrëngohemi dhe do t'ja blemë. Prindët duhet të sakrifikohen për fëmijët.

— Se më vonë edhe ata do t'ua shpërblejnë prindërve sakrificat, — thashë unë dhe vazhdova të rufis ngadalë kafenë.

Atë çast ra zilja. Burrë e gruaj u ngritën dhe dolën nga dhoma, pasi më kërkuan ndjesë.

«Sa të kthehen, do të ngrihem e të iki», — thashë me vete. Hodha sytë jashtë dritares. Dukej tarraça e një pallati, e mbushur me antena televizorësh. Mbi ta qelli ishte i kaltër. Në dhomë dëgjohej vetëm zukatja e frigoriferit.

— Si je, mor djalë? — dëgjova atë zërin e trashë, që tanë e njihja.

Ktheva kokën. Pas perdes së ngritur të anek-sit po rrinte një plak i hollë, eshtak, me një palë mustaqe të thinjura e sy të futur thellë, që shikonin ngultas. Kishte veshur një këmishë pa jakë dhe sipër mbante një jelek dalë boje. Në këmbët e mbuluara nga një palë pantallona të gjera, mbante gallloshe të vjetra, të çara anash. Pas tij vura re një minder dërrase, mbuluar me një jorgan të vjetër, të mbushur me arna.

— Mirë, faleminderit, po ju si jeni?

Ai nuk foli. Una shikoja futuren e tij, sytë e thellë e të trishtuar, mustaqet e thinjura e galloshet e çara.

Në sallon u dëgjuan disa zëra. Pastaj u mbylli dera. Ai uli perden dhe u zhduk pas saj.

— Erdhi prapë komshiu, — tha Nardi kur hyri brenda, — nuk e kishte gjetur në shtëpi pedagogun e fizikës.

Mua më shkuan sytë përsëri te perdja. Kisha gjithnjë para sysh plakun që banonte aty, në minderin prej dërrase.

— Është perde e bukur, — tha gruaja e Nardit.

— Shumë...

Pa i mbaruar mirë fjalët u ngrita.

— Është shpejt, — tha Nardi.

— Kam punë, — thashë unë.

— Si të duash, — tha prapë Nardi.

Në sallon, e shoqja vuri buzën në gaz dhe tha:

— Na urdhëroni prapë.

Nuk fola. Nuk më hiqej nga sytë figura e atij plaku të hollë, eshtak, me sytë e trishtuar, me jekun dalë boje. Ai banonte në një familje, ku bisedohej për ekspozita e shfaqje, ku shpérndaheshin çdo natë figurat e televizorit, ku frigoriferi zukaste

si një mace e përgjumur dhe në mur rrinte varur riprodhimi i Van-Gogut; ai flinte në një minder prej dërrase, mbuluar me një jorgan të arnuar, ndërsa i biri grumbullonte para... Donte t'i blente piano vajzës, që luante me aq delikatesë Shopenin, edhe Bahun...

Dola në rrugë dhe mora frymë thellë. I mbusha mushkëritë me ajër të pastër.

D H O M A E E R R E T

E fundit foli nëna. Pastaj u bë heshtje. Ajo nuk më tha ndonjë gjë të veçantë, madje nuk e shprehu deri në fund mendimin që kishte; megjithatë, pas saj asnjeri nuk foli. U dëgjua çakmaku i babait që kërciti disa herë. Motra e vogël ja kishte ngulur sytë kopertinës së revistës «Ylli», ku ishin disa aksionistë të qeshur, që tundnin shaminë nga treni. Ariana rrinte gjithnjë me fytyrë të kthyer nga dritarja dhe shikonte jashtë. Sytë i mbante të mbërthyer tek mapoja, kur hynin e dilnin pare-shtur njerëz. Megjithëse nuk ishte errur mirë, reklama ishte ndezur.

- Domethënë, kjo punë mbetet prapë pezull,
- tha babai, pa ju drejtuar askujt.
- Pse pezull? — tha nëna dhe shikoi nga Ariana.

— Desha të them se ne, si prindër, nuk jemi në gjendje të vendosim. Këtë punë e ka në dorë Ariana. Po nuk dha ajo pëlqimin, kjo gjë do të mbetet pezull...

- Ose nuk bëhet fare! — tha motra e vogël

me zë të ulët, pa ja shkëputur sytë kopertinës së revistës.

— Babai e shikoi me inat. U mat të fliste, po e zuri kolla dhe nuk foli.

— Mos pí kaq shumë duhan, — i tha nëna më qërtim.

Ai ngriti supet.

Në mapo hynin e dilnin njerëz. Ariana pa një çift, që kishte qëndruar tek vitrina e stofrave. Djali diç i thoshte duke treguar me dorë. Ajo tundte kokën. Ai i zuri dorën dhe të dy hynë brenda.

— Ke pér të thënë gjë ti, Ariana? — tha pas pak babai.

— Jo, — u përgjegj ajo. Mendoi: «Pse hyri brenda ai çift. Do të blenë ndonjë stofë pér njëri-tjetrin. Po pér kë vallë? Janë të fejuar, apo...»

— Si, moj, «jo» — u nxeh babai dhe i mëshoi zërith. — Ne të kemi thirrur pér të të propozuar goxha djalë dhe ti, si pa gjë të keqe, thua «jo». Ky është kulmi!

«Pesë herë», — tha me vete buzagas motra e vogël. Gjatë asaj ore, babai kishte thënë pesë herë «ky është kulmi». Ajo ja kishte numëruar, siç bënte me mësuesin e gjeografisë, që përsëriste me dhjetëra herë «domethënë».

— Dëgjo, baba, mos u nevrikos, — tha Ariana, duke u përpjekur që zëri i saj të ishte sa më i qetë. — Ti duhet të kuptosh...

— Po është djalë i mirë, me diplomë, me shtëpi të tijën e me njëmijë të mira, — ndërhyri nëna.

— Nuk po e shan njeri, moj mama. Në është i mirë, është pér veten e tij.

— Ashtu? — thirri babai dhe cigarja i ra mbi

qilim. Nëna u ul e mori dhe e vuri në tavëll. — Eshtë djalë i mirë për veten e tij? Jo, jo, do të jetë djalë i mirë për ty. Kupton? Për ty. Moj po si e ke hallin ti? Nuk do të fejohesh? E çfarë do të bësh, pa më thuaj pak? Do të gjesh ndonjë tjetër... Do të të lerë edhe ai, do të gjesh një të tretë e kështu me radhë... derisa të bëhen gazi i qytetit, çfarë them edhe unë, turpi i qytetit. Ky është...

Mori cigaren dhe zuri ta thithë me afsh.

— Pse thua kështu, baba? — tha Ariana dhe gjaku i vërshoi në fytyrë, sikur ta kishin qëlluar me shuplakë.

— Se ashtu e meriton, — ja ktheu babai.

Ariana u mat të fliste. Pastaj heshti dhe shikoi prapë jashtë dritares. «Do të flas sa më pak», vendosi me vete, megjithëse e dinte se e kishte të vështirë.

Në rrugë lëviznin pareshtur njerëz. Në mes të turmës, ajo pa Suzanën me të atin, që ecnin qetësisht, duke biseduar. Çifti i mëparshëm doli nga mapoja. Nuk flisnin. Shkuan prapë para vitrinës. Një veturnë e zezë rrëshqiti ngadalë, pa zhurmë. Neonet e porsandezura reflektoheshin në xhamet e dyqanit. Kaloi urbani i kuq, që shkonte në spital.

— Dëgjo, moj vajzë, — tha babai dhe bëri një pauzë të shkurtër, — e ke kot që e zgjat këtë punë. Fejesa do të bëhet, se kjo është për të mirën tënde dhe të familjes.

Priti pak. Thithi cigaren. Dhe i hodhi një sy rënës, që rrinte me duart e mbledhura në prehër, duke shikuar qilimin e shtruar në mes të dhomës. Motra ktheu qetësisht një faqe të revistës.

— Ti e di se unë nuk jam fanatic, — vazhdoi

babai. — Me atë djalë u njohe që në gjimnaz. Ne ta dinim që atëhere. Kur të pyeta, më the se do të fejoheshit dhe as unë as nëna nuk të thamë gjë. Ti këtë e di mirë. Bëre tre vjet dashuri me të... E mori vesh tërë qyteti. Sa fjalë kam dëgjuar unë pér këtë punë... Megjithatë, nuk të thashë asgjë, nuk ndërhyra. Por tani që u ndatë dhe ai iku në një qytet tjeter dhe ti e pranove vetë se jeni pri-shur, kjo punë nuk mund të vazhdojë më. Tani e kemi marrë ne çështjen tënde në dorë. Të kemi gjetur goxha djalë dhe të propozojnë të fejohesh. Kurse ti kundërshton. E po ky është kulmi! E pro-vove dashurinë. Mirë. Nuk të doli gjë. Tani na dëgjo dhe bëj si të themi ne.

— Po pse doli i pabesë Luani, kjo nuk do të thotë se unë nuk kam më të drejtë të zgjedh shokun e jetës, — tha Ariana duke kthyer kokën nga babai. At e bijë u panë sy në sy. Ajo u përpoq të fliste edhe kësaj here qetësisht, por nga fundi e ngriti zërin.

Në dhomë u bë qetësi. Nga jashtë vinin zhur-mat e mytura të rrugës, që vlonë nga njerëzit. Muri përballë rrugës ndriçohej nga një refleks i dobët.

— Pastaj, mor baba, unë nuk dua të fejohem tani pér tani. Nuk më iku koha, de! — tha Ariana, duke u përpjekur të zbuste zemërimin që kishin shkaktuar fjalët e saj.

— Nuk e ka keq Ariana, — tha papritmas mo-tra e vogël, pa ja hequr sytë revistës. — Të mba-rojë njëherë fakultetin, pastaj le të fejohet.

— Nuk të pyeti njeri ty, — ju shkreh babai.

— Fajin e kemi ne që të lemë të dëgjosh kësi bis-dash, që janë pér të rriturit.

— Jam katërmëdhjetë vjeçë, baba, — tha ajo, e fyer.

— Mirë, mirë, mos e zgjat, — tha mamaja, duke i bërë me shenjë nga babai.

U dëgjua prapë krisma e çakmakut që ndizet me vështirësi. Babai ndezi një cigare tjetër.

«Perdet janë zverdhur nga tymi i duhanit», — mendoi e shoqja, duke kthyer kokën nga dritarja.

Motra e vogël mbylli revistën dhe shikoi përrapa vetes.

«Prapë aty qenka ai çifti i mëparshëm», — mendoi Ariana, duke ja ngulur sytë dy të rinjve. Vajza bënte me dorë, duke i treguar diçka djalit, që fliste më pak dhe që dukej sikur ngurronë përdicë. Kaloi me shpejtësi një autoambulancë e bardhë. Nga lart ajo pa sinjalin e kuq që ishte ndezur. «Ç'do të jenë vallë ata të dy? Të fejuar, apo... Sa budallaqë që jam... e ç'më duhet mua... Ja, ajo e zuri për dore. Djali ju afrua dhe diç po i pëshpërit në vesh. Ja po qeshin. Ajo e tërheq, ai nuk lëviz nga vendi. Vallë edhe unë me Luanin kështu bënim në rrugë, pa pyetur se ishim në mes të njerezve?»

— Unë nuk e kuptoj ngurrimin tënd! — dëgjoi zérin e babait.

Urbani po kthehej nga spitali. Pas dritareve të ndriçuara ajo pa dhjetëra ftyra. Kishte rënë mbrëmja e qetë, e kaltër e mbushur me drita e zëra. Nga larg era solli shtatë trokitjet e orës së madhe të qytetit.

Nëna u mat të ndizte dritën, por kjo ndoshta do ta bënte më të vështirë atë bisedë. Më mirë bisedohej në gjysmerrësirë. Motra e vogël mendonte se, po të mos ishte puna e fejesës së Arianës, ajo do

ta kishte ndezur televizorin për të dëgjuar ndonjë koncert. «Sa e keqe jam, — mendoi ajo pas pak. — Këtu po vendoset një gjë kaq e rëndësishme për Arianën, kurse unë po mendoj për koncertin!»

Papritmas babai u ngrit më këmbë.

— Këtë punë nuk mund ta zgjatim më, — tha dhe bëri disa hapa nëpër dhomë. — Është e treta herë që bisedojmë dhe jemi aty ku ishim në fillim. Familja e djalit kërkon përgjegje dhe unë nuk kam ndër mend ta shtyj më gjatë. Sonte do të japësh fjalën, Ariana. Hajt tani, mos na mundo më gjatë. Bëhu e arësyeshme, mos na e thyej zemrën.

Fjalët e fundit i tha me një ton lutës dhe Arianës i erdhi keq për të. E dinte se babai e donte shumë dhe shpesh sillej me të më shumë si shok sesa si prind autoritar. Rrallë kishte ndërhyrë në punët e saj. E kishte lenë të vendoste vetë. Ndarja e saj me Luanin e kishte dëshpëruar dhe trembur. Që nga ajo ditë kishte ndryshuar shumë. Ishte bëré nevrik, i ashpër dhe rrinte i ngrysur. Ariana e dinte se ndarja e saj me Luanin e bënte babanë t'i shikonte ndryshe shumë gjëra që lidheshin me dashurinë, me fejesën. Ajo mendonte se ndoshta nuk ishte vetëm ndarja e saj që e kishte bëré të tillë, mundet që ai kishte edhe telashet e ndërmarrjes që drejtonte... Po këto telashe ai i kishte pasur gjithmonë dhe kurrë nuk ishte treguar i tillë, sidomos me të. Megjithatë, ajo kishte besim se kjo do të kalonte.

— Pres përgjegje, Ariana, dhe besoj se do të jetë përgjegje pozitive, — foli prapë babai me zë të qetë, por asaj ju duk se pas asaj qetësie të shtirë fshihej kërcënimi.

Tani dhoma ishte në errësirë. Rruga vlonët nga gjallëria. Dy të rintjtë nuk ishin më para vitrinës së mapos. Kushedi ku kishin shkuar... Dy vajza të reja, të veshura me fustanë të çelur, kishin qëndruar në mes të rrugës. Një veturë bojë mjalti frenoi para tyre. Ato qeshën dhe hipën në trotuar. Një fshatare hyri në mapo, e zënë për krahu me një ushtar të gjatë.

— Hë, Ariana? — tha prapë babai. Ndezi çakmakun dhe flaka e vogël largoi për disa çaste hijet, që u strukën në cepat e dhomës.

— E keni kot që ngulni këmbë, — tha Ariana dhe u kthyte nga ata. — Kjo është fjala ime e fundit: unë nuk fejohem me atë djalë. Nuk fejohem.

Papritmas u shkëput nga dritarja, hapi derën dhe doli nga ajo dhomë e errët. Kaloi korridorin, zbriti me nxitim shkallët dhe doli në rrugën plot drithë dhe njerëz.

— Ky është kulmi! — thirri babai dhe doli nga dhoma, i ndjekur nga mamaja.

— Shtatë herë! — numëroi motra e vogël buzagaz. U ngrit dhe ndezi televizorin.

PARMENDA DHE PUSHKA

Po errej. Hijet ngjiteshin nga fushat si një tym ca i kaltër e ca i murmë. Vetëm kreshtat shkëlqenin ende. Mbi të qelli bëhej i bruztë, si uji i një liqeni.

Në arën e vogël që shtrihej në mes të kresh-tave e të fushave, një njeri lëronte tokën. Silueta e tij lëvizte pareshtur herë duke qëndruar drejt, herë duke u përkulur përpara, për t'i mëshuar dorakut të parmendës. Dy qetë e dobët ishin të lodhur e çapiteshin ngadalë, shfrynin, nganjëherë qëndronin. Njeriu mbante hostenin në një dorë, por nuk i shponte qetë, se e dinte që ata ishin të dobët, të moshuar e lodheshin menjëherë. Toka ishte e fortë, ngjyrë gështenje dhe aty-këtu zbar-dhete nga gurët.

— A mbarove, o Sadik? — u dëgjua një zë, që dukej sikur vinte nga larg, nga kreshtat e ndri-tura, ose nga fushat e përhime.

— Kam edhe nja dy brazda! — u përgjegj ai, duke shikuar nga kasollja që ngrihej në cep të arës së vogël. Pastaj shtoi, sikur fliste më shumë me vete:

— Do t'i mbaroj edhe këto.

U thirri qeve dhe zëri i tij ishte i butë, i ëmbël, sikur u fliste njerëzve. Pastaj e shtyu përpara par mendën, duke i mëshuar dorakut.

Sadiku e ndjeu se ishte lodhur. Krahët i dhembnin. Edhe këmbët i ishin vrarë nëpër plisat e arës. Megjithatë, kishte vendosur t'i mbaronte edhe ato dy brazda, se të nesërmen kishte ndër mend të mblidhët misrin.

Duke ecur pas qeve, ngriti kokën dhe shikoi kreshtat që ende shkëlqenin. Poshtë tyre pa pyllin e dendur. Aty rrinte çeta partizane. Ata tani po preqatiteshin për të zbritur nga kreshtat, se natën do të sulmonin postën e armikut në hyrje të fshatit. Bashkë me ta do të shkonin edhe disa fshatarë, në mes të tyre edhe Sadiku. Ai do të mbaronte lërimin, do të hante një kafshatë bukë, do t'i kthe nte njërin ka Metushit, që ja kishte marrë hua, do të çlodhej një grimë sa të pinte një duhan e pastaj do të merrte pushkën e do të shkonte të luftonte me çetën, si kishte bërë edhe herë të tjera.

Qetë ecnin ngadalë dhe shfrynin ajrin me forcë. Sadiku shihte kaun e zi, që ishte mbrehur nga e djathta, dhe vinte re se ai ishte më i dobët dhe tërhiqte më pak se shoku i tij, megjithëse përpiquej të mos qëndronte prapa, se e shtynte trupin përpara.

Sadiku mendonte për aksionin që do të bënin atë natë. Shikonte brazdën që zgjatej, dhe ashtu i gjatë ishte edhe mendimi i tij, që ai lëronte pare shtrur në mendje.

«Pushkën e kam të vajisur, por duhet ta fshij edhe një herë para se të nisem me partizanët. Rrapijn do ta forcoj, se afër qytës është gati në të këputur... O burra t'i kthej qetë e të nis brazdën e fundit... Toka është e fortë. Nuk ka rënë shi... Sa

ushtarë armiq mund tē jenë tek posta që do tē sulmojnë sonte? Ku ta dish. Para një javë, fashistët prunë përforcime... Kulla e tyre është e fortë... Nga ç'anë do ta sulmojmë?»

Ktheu qetë dhe nisi brazdën e fundit. Kafshët papritmas u gjallëruan, sikur e kuptuan se ajo ishte rruga e fundit. Sadiku i mëshonte dorakut. Plori çante dheun e fortë dhe brazda zgjatej e zgjatej. Sadiku ndjente krismën e butë tē dheut dhe kundërmimin e tij tē njojur e tē dashur, me tē cilin ai ishte mësuar që foshnjë.

Kasollja ishte e qetë. Në zabel dikush priste dru dhe krismat përhapeshin në mbrëmjen e asaj dite në fund tē pranverës. Babai që e pyeti pak përpara, nuk foli më. Gruaja e tre fëmijët nuk ishin aty. Bedrija po lante plaçkat tek pérroi, që zbriste me rrëmbim nga kreshtat, kurse fëmijët diku lozni.

Ai zuri prapë tē mendohej dhe mendimi i tij zgjatej e zgjatej, si brazda që hapte parmenta në arën e vogël në mes të kreshtave e tē fushës.

«Sonte do tē bëhet luftë e madhe. Kjo është posta e parë që sulmojmë në anët tonë. Kur i zummë pritë autokolonës italiane javën e kaluar bashkë me çetën, e patëm më tē lehtë, se ishim lart, nëpër gërxhe, dhe armikun e kishim nën vete, kurse posta... Sidoqoftë, komandanti me komisarin do tē kenë bërë planin dhe do ta kenë gjetur mënyrën si do ta sulmojmë. Pushkën e kam tē vjetër, me gjithatë qëllon mirë. Vetëm duhet t'i forcoj rripin që është duke u këputur...»

Pas pak u thirri qeve dhe ata qëndruan. Mori frymë i lehtësuar. Edhe brazda e fundit mori fund.

Tani ara e vogël ishte lëruar fund e krye dhe mund të mbillte misrin.

U liroi zgjedhën qeve dhe u fërkoi me dashurë qafat e fuqishme, që ua kishte vrarë druri i parmandës. Kafshët dihatnin dhe e shikonin me sytë e tyre të mëdhenj, të rrumbullakët. I la të merrnin frymë një çast. Hoqi opingat dhe i shkundi tek gjuri për të nxjerrë copat e dheut dhe guraçokët që i kishin hyrë brenda. Pastaj ngriti në sup parmandën dhe e pështeti pranë hyrjes së kasolles. U kthye tek qetë. Ata nuk kishin lëvizur nga vendi. Ai u ra vitheve ngadalë dhe i shtyu përpara, drejt shtëpisë së Metushit.

Kur u kthye në kasolle, ishte errësuar dhe aty ndjehej kundërmimi i athët i tymit. Babai i tij i moshuar rrinte pranë zjarrit. Sadiku u ul në një cep të kasolles dhe mori pushkën që e mbante të fshehur.

— Mbarove, mor bir? — e pyeti pas pak i ati.

— Po.

Plaku diç foli me vete. Pastaj e pyeti prapë:

— Ja çove kaun Metushit?

— Ja ktheva, — u përgjegj Sadiku dhe lëvizi shulin e pushkës. Në kasolle u dëgjua krisma e tij e thatë.

— Do të shkosh edhe sonte me partizanët?

— Po, baba.

Plaku prapë diç foli me vete. Sadiku nuk e vuri re. Ai e dinte se babai e kishte bërë zakon të fliste me vete; sidomos që nga koha që ishte bërë ulok dhe rrinte tërë ditën vetëm. Ai zuri të pastronte pushkën me duart e tij të mëdha, që mbanin kundërmimin e dheut të porsalëruar të arës

së vogël, që shtrihej në mes të kreshtave dhe të fushës.

* * *

Sadiku zuri vend pas një sopi të rrumbullakët. Pranë tij rrinte shtrirë një partizan. Ai nuk e njihte. Edhe partizanët e tjerë kishin zënë pozicion dhe, të heshtur, prisnin urdhërin për të sulmuar postën italiane.

Përreth ishte qetësi dhe puhizat e natës sillnin nga larg kundërmime lulesh dhe shushurima të émbla rrëkesh e përrrenjsh, që rridhnin nëpër bri-njët e malit. Qielli ishte plot me yj të mëdhenj, të ndritshëm, të shqetësuar. Sadiku nuk e dinte sa ishte ora, ndoshta kishte kaluar mesnata, ndosh-ta jo.

Ndërtesa e postës ngrihej e zymtë, e errët. Nga dritaret e vogla vinte një dritë e mekur dhe herë pas here dëgjoheshin zëra.

Sadiku, që rrinte pështetur në ije, ndjeu se gjymtyrët ja pushtoi nga pak një kapitje e émbël. U shkund dhe lëvizi shulin, duke ja futur në gojë fishekun pushkës së vjetër. Pas pak dëgjoi se edhe partizani që kishte në krah lëvizi shulin.

— Kush je ti, or mik? — e pyeti Sadiku.

— Malo më quajnë. Po ti si e ke emrin?

— Sadik. Jam nga të fshatit unë.

Nuk folën më.

Pas pak u dha urdhëri për të qëlluar. Breshëri pushkësh u dëgjuan njëheresh nga shumë anë. Pastaj plasi një bombë dore. Brenda ndërtesës së postës u shuan dritat dhe shumë zëra folën njëheresh.

Nga një dritare vezulloi flaka e një mitralozi. Filloi beteja dhe nata e qetë e pranverës u mbush me krisma, me zjarre.

Sadiku qëllonte i shtrirë pas sopit, duke shënuar dritaren nga dilte zjarri i mitralozit. Ajo lodhje e dremitje që e kishte pushtuar teksa prisnin urdhërin për të qëlluar, tani i kishte kaluar fare dhe ai e ndjente veten të çlodhur, të mbushur me fuqi dhe mendjen e kishte të kthjellët.

Luftha vazhdonte. Grykat e maleve përcillnin oshëtimat deri larg. Ato me siguri dëgjoheshin edhe poshtë, tek fusha e mbuluar nga errësira e natës. Bombat e dorës pëlcisnin me uturimë dhe për disa çaste çdo gjë përreth ndriçohej, ashtu si ndodh kur shkrep rrufeja në një natë me stuhi. Sadiku qëllonte pa u ngutur, duke e matur mirë plumbin. Pranë dëgjonte mauzerin e Malos, që lëshonte një krismë të thatë e pak të zgjatur. Pas pak mitralozi brenda postës pushoi dhe kollitja e tij u ndërpri. Prej andej dëgjoheshin vetëm të shtënët e një automatiku dhe të ndonjë pushke.

«Ja, edhe pak e fashistëve po u vjen fundi, — mendoi Sadiku. — Qeni i madh heshti. Tani e kanë radhën të myllin gojën edhe këlyshët e vegjël. Sa do të jetë ora? Ku ta dish. Qielli ende nuk ka nisur të ndryshojë nga lindja. Po ka nisur të fryjë era e freskët dhe agimi nuk është larg. Sa të zbardhë, do të marr farën dhe do të mbjell misrin tek ara e vogël. Moti është i mirë. Farën e kam ndarë mënjanë. Më duket se ai kau i zi i Metushit është i sëmure. Do t'i them që të thërrasë Bektaшин që t'ja shohë një herë, se ai i njeh mirë kafshët...»

Atë çast u dha urdhëri për t'u hedhur në sulm.

Të gjithë u ngritën në këmbë dhe u sulën drejt postës nga vinin disa krisma pushkësh. Sadiku ju qep të përpjetës, duke mbajtur pushkën përpara. Pranë tij edhe Maloja, kurse përpara tyre dhe anash partizanë të tjerë shkonin drejt ndërtesës së postës me pushkët e shtrira përpara.

Pas pak fashistët u dorëzuan. Partizanët u futën brenda në postë. Krismat u shuan. Përreth dëgjohej kundërmimi i barutit dhe shtëllunga tymi ngriheshin aty-këtu. Sadiku nuk hyri në postë. Ndenji në oborr me disa partizanë të tjerë. Tre partizanë shoqëruan robërit. Në mes të tyre ecte një oficer kokëjashtë, me duart gjysmë të ngritura. Ai kishte një mjekër të zezë, të dendur që ja shpupriste era e agimit. Pas pak, nga brenda dolën partizanë të tjerë, duke mbajtur ndër duar armë e municione. Në mes tyre ishte dhe komandanti. Një partizan i gjatë mbante në krah mitralozin me tri këmbë.

Pa e zgjatur i vunë zjarrin postës armike dhe çeta mori urdhër të largohej. Partizanët ecnin në radhë, duke biseduar e duke qeshur. Njëri prej tyre ja mori këngës. Ajo ishte një këngë e re, që bënte fjalë për aksionin që sapo kryen.

Përreth çdo gjë shkëlqente. Flakët ngriheshin drejt qiellit, që ishte i mbushur me yj. Zjarri i madh me siguri dukej edhe në fshatrat përreth, edhe atje në fushë, ku ishin forcat e tjera fashiste.

Sadiku ecte andej nga mesi i çetës me pushkën hedhur krahëqafë. Duke ecur, ai vuri re se, nga lindja, qelli zuri të zbardhëlløhej e yjtë fikeshin një nga një, si shkëndijat e një zjarri që nis të shuhet. Ai ecte dhe mendonte për mbjelljet, për

arën e vogël, që priste të ndjente brenda saj kokrrat e misrit, për kaun e zi të Metushit, që një ditë përpara i kishte bërë shumë përshtypje.

Tek përroi qëndroi. U përshëndet me shokët e çetës. Pas pak aty arriti komisari dhe falënderoi Sadikun dhe fshatarët e tjerë që morën pjesë në atë aksion.

Sadiku u nda nga bashkëfshatarët e tjerë dhe ngjiti të përpjetën që conte te kasollja e tij. Ekte me hap të lehtë, sikur atë çast ishte zgjuar nga gjumi. Nga kreshtat frynte pandërprerë era e freskët e agimit dhe gjethet diç pëshpërisnin me zë të ulët. Qielli vazhdonte të zbardhej dhe yjtë shuheshin një nga një.

Para kasolles qëndroi. Shikoi arën dhe mori frysme thellë. Pastaj u afrua dhe e shtyu ngadalë derën. Gruaja ishte zgjuar. Edhe babai rrinte pranë zjarrit, kollitej dhe fliste me vete. Fëmijët flinin një cep dhe Sadiku dëgjoi frysma marrjen e tyre të qetë.

— A u ktheve? — e pyeti Bedrija duke qëndruar para tij.

— Po, tani mbaruam punë.

Sadiku e dinte se ajo, ashtu si herët e tjera, nuk kishte mbyllur sy dhe tërë natën kishte dëgjuar krismat e pushkëve dhe gjëmimet e bombave. Edhe babai me siguri kishte ndenjur zgjuar, i struktur aty pranë zjarrit, duke menduar: «Edhe këta qeratenj dinë ta luajnë gishtin! Pushkën e kam lenë në dorë të mirë».

Sadiku shkoi të merrte farën dhe u tregoi shkurt për aksionin që bënë atë natë. Pastaj, pa

ħumbur kohë, doli në oborr. Pushkën nuk e hoqi nga krahët. Qesenë e vari në qafë dhe rripat e saj u pérzien me rripin e pushkës. Me hap tē ngadal-shëm ai shkoi tek brazda e parë. Qëndroi. Mori frymë thellë, duke ngritur kokën nga kreshtat, që shkëlqenin nga drita. Pastaj me duart e tij tē më-dha, që ende mbanin erë barot, hodhi farën e re në tokën e lëruar.

SYTË E SHARLOTIT

- Sa është ora? — pyeti një kalimtar.
- Dy.
- Baba, qenkam vonuar.
- Si the?
- Jo, jo, fola me vete.

Shpejtoi hapin. Në orën dy fillonte filmi. Ai duhej të ndodhej në kinema të paktën një çerek ore para fillimit. I kishte dalë gjumi vonë, pasi e kishte zakon të shtrihej çdo drekë për t'u çlodhur. Nuk kishte orë në shtëpi dhe i binte murit për të pyetur mësuesin, që rrinte në dhomën pranë. Sot ai nuk ishte përgjegjur. Ndoshta kishte pasur punë në shkollë.

Te kinemaja nuk kishte njerëz. Ai pa operatorin që po rrinte para derës së hapur. Pshëretiu.

— Luaj këmbët, Pjetër, se po fillojmë.

Në hollin e ngushtë e të gjatë pa pronarin. I kishte kthyer shpinën hyrjes dhe bisedonte me dy burra.

Pjetri hyri në sallë. Aty kishte pak njerëz. Kështu ndodhë zakonisht në seancën e parë. Kaloi radhët e karrigeve të kinemasë së kredhur në gjysmerrësirë. Shkoi e u ul pranë pianos së vogël,

të vendosur ndanë ekranit. Vështroi sallën. Aty kishin zënë vend disa fëmijë, ndonjë i papunë që s'kishte nga të vërtitej, dy gra të mbuluara me ferekhe, ca ahengxhinj, që i kishte parë duke shkuar në dasma e synetllëqe me vegla ndër duar. Në fund të sallës, në njérën nga dy llozhat e vogla e të ulëta, ishte si zakonisht zoti Malo me një prostitutë. Ai gjithnjë vinte në kinema me ndonjerën prej tyre dhe zinte vend në llozhë.

U shuan dritat. Salla ndenji në errësirë. Nga dyert e dritaret e pambyllura mirë hynin copa drite. Pjetri hapi kapakun e pianos. Pas dritares së vogël, në murin përballë ekranit, pa operatorin që vërtitej rrëth aparatit. Disa fëmijë fishkellyen. Aparati kërciti.

Filloi filmi. Pjetri ngriti kokën nga ekrani. Ishte një film i shkurtër me Stan Laurelin dhe Oliver Hardin, ose, siç quheshin nga të gjithë «I Holli e i Trashi».

Pjetri nisi të luante atë polkën që shoqëronte filmin. Në sallë u përhapën notat e para të muzikës.

Filmi kishte një subjekt banal, të mbështetur në një keqkuptim. Dy shokët marrin vesh se një pasanik paguan një shumë të madhe, po t'i kthejnë tablonë e grabitur «Djali blu». I Holli e i Trashi punojnë në një stallë dhe aty kanë një kalë që ka po atë emër. Pa e zgjatur, marrin kalin dhe shkojnë në shtëpinë e pasanikut. Aty fillojnë një varg i gjatë episodesh gazmore. Midis të tjerave, pasaniku u thotë që «Djalin blu» ta vendosnin sipër pianos dhe ata marrin kalin dhe përpiken ta hipin mbi piano.

Salla shpërthente pareshtur në të qeshura të

potershme. Pjetri vazhdonte të luante polkën siç kishte bërë qindra herë, pasi ata filma shfaqeshin gjatë dhe ai i kishte mësuar përmendsh. Ishte një muzikë gazmore, një motiv operete, që ja kishte dhënë pronari për të shoqëruar filmat e të Hollit e të Trashit. Ai motiv që e luante nga ora dy deri në mesnatë, i ishte bërë një gjë krejt mekanike, një përsëritje e padurueshme, që e lodhët shumë.

Shoqërimi në piano i filmave pa zë në fillim i ishte dukur punë e bukur. Më në fund kishte gjetur një piano, ku mund të stërvitej dhe të fitonte një kafshatë bukë. Por shpejt e kishte kup-tuar se ishte një mundim i madh. Çdo ditë, papër-jashtim, detyrohej të luante tri-katër motive për dhjetë orë rrjesht. Shpesh, kur mbaronte punën, ishte si i dehur nga lodhja, nga ajri i rëndë i sallës së myllur dhe nga motivet e stërpërsëritura, që e goditnin si çekiç. Ai ishte shëndetlig dhe i merreshin mendtë, zemra i rrihte fort dhe pas punës endej rrugëve një orë për të thithur ajër të pastër, endej në rrugët e qytetit të fjetur bashkë me xhandarët, pazvanët dhe qentë pa strehë.

Në fillim kishte dashur të luante në piano disa motive të tjera, të kompozuara prej tij. Pasi e kishte dëgjuar një ditë, pronari i kishte thënë:

- C'qe ajo muzikë?
- Po ja, një gjë e re, një...
- Nuk ishte fare e bukur. As gazmore.
- Po unë...
- Lere atë. Bëj muzikën që të kam caktuar, dhe mbaroi.

Pjetri kishte hequr dorë nga motivet që kri-jonte vetë, dhe tanë luante vetëm ato që i kishte caktuar pronari i kinemasë.

Pianon e kishte mësuar me ndihmën e një mësuesi të vjetër muzike, që drejtonte bandën e qytetit dhe punonte në kafenenë e madhe të qytetit. Mësuesi, pasi kishte vënë re prirjen e atij djaloshi të varfër, që ishte rritur pa prindër në shtëpinë e xhaxhait, kishte nisur t'i mësonte pianon falas. Pjetri kishte mësuar me zell të madh dhe ushqente shumë ëndërra të bukura. Por mësuesi i vjetër pinte shumë, kollitej pareshtur dhe një ditë vdiq. Pjetri kishte vazhduar të mësonte vetë në pianon e tij, por pastaj e shoqja ja kishte shitur instrumentin pronarit të kinemasë. Dhe që nga ajo ditë — po bëheshin dy muaj — Pjetri punonte në kinema. Shoqëronte në piano filmat pa zë.

...Filmi po i afrohej fundit. Dy shokët, pasi e bëjnë rrëmujë shtëpinë e pasanikut, largohen me vrap. Pjetri shtoi ritmin e polkës. Gishtat fluturonin mbi tastet. Më në fund në ekran doli fjala «The end» dhe u ndezën dritat e sallës.

Spektatorët zunë të flisin me zë të lartë. Disa komentonin skenat e filmit, ndonjë fëmijë hipte mbi karrige dhe imitonë lëvizjet e dy heronjve gazmorë. Vetëm zoti Malo rrinte i qetë në llozhën e vogël, i ulur pranë prostitutës.

Filloi filmi i dytë. Prapë një film tjeter i shkurtër me të Hollin dhe të Trashin. Kësaj here ata kanë marrë një rekondim për t'u bërë shërbëtorë në një hotel luksoz.

Pjetri shoqëroi kuadrot me një foks-trot. Përshkroi me muzikë ambientin e një hoteli të madh, që pregatitej për të pritur një mysafir me rëndësi. Ja holli, njerëzit e mbledhur për pritjen, drejtori i shqetësuar. Hyjnë i Holli dhe i Trashi dhe zënë vend pranë banakut të portierit. Dikush pandeh

se njëri prej tyre është mysafiri me rëndësi dhe nisin t'i bëjnë nderime.

Salla queshte. Pjetri nisi foksin nga e para. Ai motiv gazmor ishte shumë i shkurtër e monoton dhe, derisa të mbaronte filmi, do t'i duhej ta përsëriste nja dhjetë herë.

Edhe në këtë film, dy shokët dështojnë e në fund i nxjerrin jashtë e mbeten prapë në katër rrugët. Ata të bënин pér të qeshur me ato fytyrat e tyre prej babaxhani, të shkulnin gazit me ato skenat e ngarkuara me bufoneri, megjithatë, kishte një fund të hidhur në një pjesë të madhe të filmave të tyre. Pjetri shpesh kishte pyetur veten: ata e pësonin pse nuk dinin të punonin, se ashtu u krijoeshin rrethanat, apo kishte ndonjë arësyte tjetër kryesore, që ishte burimi i tërë hallevë të tyre?

Gjatë kohës që shoqëronte filmat, ai kishte kohë të mendonte, pasi gjithmonë luante po ato motive në mënyrë mekanike. Atëhere shkëputej nga ajo kinema e vogël, nga salla e errët, nga farsat dhe aventurat e tjera sentimentale që shfaqeshin aty. Mendonte pér jetën e tij, pér dëshirën e madhe që kishte pér të kompozuar muzikë të vërtetë dhe pastaj të vazhdonte studimet dhe të jepte koncerте. Shpesh i kujtoheshin prindërit, që e kishin lënë të vogël, xhaxhai, që tanë ishte paralizuar dhe lëngonte në shtrat, i kujtohej mësuesi i vjetër i muzikës, që pinte dhe kollitej pareshtur. Tërë këto gjëra i kujtoheshin tekxa luante motive gazmore, polka dhe fokse të marra nga operetat.

Nuk e kuptoi si mbaroi edhe filmi i dytë. Më shumë se dritat, atë e sollën në vete zhurmat e spektatorëve, thirrjet dhe fishkëllimat. Shikoi sallën. Dy fëmijë nisën të zihen me grushte. Të gjig-

thë u ngritën në këmbë për të ndjekur zënkën e tyre. Nga lart zbriti operatori, që i zuri për veshi dhe i nxori jashtë, duke i qëlluar me shqelma. Vëtëm zoti Malo, i ulur pranë prostitutës, shikonte me sytë e tij të shuar e të qetë dhe nuk lëvizte nga vendi.

Nisi filmi i tretë. Ishte një film me Çarli Çaplinin. Pjetri, pasi shikoi sekuencat e para, nisi një mazurkë, që ja kishte mësuar pronari. «Me këtë do të shoqërosh filmat e Sharlotit», — i kishte thënë ai që ditët e para. — Është një shedëvr. E kam dëgjuar në Mulen Ruzh, kur isha në Paris». Pjetri ngriti kokën nga ekrani. Ja, në fund të një rruge u duk silueta e njojur e Sharlotit, me atë ecjen karakteristike, që mund ta dalloje në mes të mijëra të tjera. Ai mbante në dorë shkopin dhe në shpinë kishte hedhur një torbë të vogël, ku kishte mbledhur tërë q'kishtë. E çmonte dhe e donte shumë artin e atij aktori. Ai dhe ndonjë tjetër, ishte një përjashtim në tërë ato filma, që i binte rasti t'i shikonte dhjetëra e dhjetëra herë.

Sharloti ju afrua ekrani. Ja portreti i tij. Pjetri, siç bënte zakonisht, shikoi me vëmendje sytë e tij. Ata sy ishin të menduar dhe në të njëjtën kohë të trishtuar. Ata sy mbeteshin të tillë edhe kur bënte lëvizjet gazmore, në skenat që të shqyernin gazit. Ata sy shprehnin një trishtim të madh, një dramë të brendshme të atij Sharloti, që herë ishte punëtor, herë i burgosur, herë artist. Loja e tij ishte gjithmonë ajo e një kllouni të trishtuar.

Pjetri do të kishte dashur që filmat e tij t'i shoqëronte me një muzikë tjetër, më të thellë, më të menduar, më njerëzore. Muzika që i kishte dhënë pronari, nuk i shkonte fare, ajo ishte e përshtat-

shme për balerinat, që ngrinin këmbët duke u vërtitur nëpër dekore të sheqerosura si ndër kartolina të këqia. Jo, nuk mund të komentonate ajo muzikë dramën e njeriut të vogël, të thjeshtë, të dashur, endacakut të varfër, që në fillim të filmit vinte nga larg, me torbën krahëve, dhe në fund prapë largohej i përpire nga rruga e gjatë, plot pluhur. Pjetri në lojën e tij, në fatin e tij, në jetën e tij gjente diçka që ishte njëkohësisht edhe e vetja. Madje ai mendonte se secili nga ata që e shikonin në atë sallë, gjente tek Sharloti diçka të afërt e të ngjashme.

Pjetri i binte pianos me dëshirë, megjithëse ai motiv i ishte neveritur. Shikonte me vëmendje tërë filmin dhe gjithnjë e tërhoiqnin sytë e Sharlotit.

Mbaroi filmi dhe seanca e parë e pasditës. Salla gati u boshatis. Qëndruan vetëm disa fëmijë dhe ndonjë i papunë. Ikën ahengxhijntë, që kushti ku kishin punë atë mbrëmje. U ngrit edhe zoti Malo bashkë me prostitutën, që ishte një vajzë e gjatë, me supe të ngritura dhe me flokë të hedhura para syve.

Pjetri doli në holl dhe qëndroi tek dera. Operatori zbriti poshtë dhe zuri të priste biletat. Pronari nuk ishte aty. Me siguri kishte shkuar në kafenë përballë që të pinte kafenë dhe të lexonte gazetat e reja të ardhura nga Franca.

Sheshi që shtrihej para tij, ishte i vogël dhe i shëmtuar. Dy fshatarë tërhoiqnin me zor gomarët për kapistre. Përballë tyre ishte një malësor, që thërriste me zë të zvargur: «Hajde bozë, bozë!»

Në kinema hynin njerëz të tjerë. Disa i njihte, të tjerë i shihte për herë të parë. Një vajzë e re ju

afrua derës, zënë për dore me të ëmën. Ai ja ngulitë sytë. Ajo ngriti kokën dhe e shikoi vjedhurazi. E ëma i tërroqi dorën, diç i tha nëpër dhëmbë dhe u futën në sallë.

— Mot i poshtër! — tha operatori. — As shi, as diell. Mot i poshtër!

Pjetri shikonte sheshin. Pas dritareve të kafenesë dukeshin disa njerëz. Një polic kishte qëndruar para reklamave të kinemasë dhe pështynte përtokë. Një pajton përshkoi sheshin me zhurmë. Në të rrinin dy çingi, që i njihet tërë qyteti. Pjetri i kishte parë në dasma ato çingi të bukura, për të cilat ziheshin tregëtarët e qytetit.

— Mot i poshtër! — tha prapë operatori.

Pjetri u kthye në sallë. Seanca e dytë kishte më shumë njerëz. Zoti Malo nuk ishte kthyer. Siç duket, ende nuk kishte gjetur ndonjë prostitutë tjetër. Gruaja me vajzën kishin zënë vend në një cep të sallës.

U fikën dritat. Ai vuri duart mbi tastierë. Filloi polkën, pastaj foks-trotin dhe mazurkën. Salla qeshte, njerëzit thërrisin, grindeshin, kurse ai luanter në piano motivet monotone dhe mendonte se sa gjë e bukur do të ishte sikur të kompozonte muzikë të vërtetë dhe të jepte koncerте.

Pas seancës së dytë, nisi të errej. Pjetri doli tek dera dhe shikoi jashtë. Duart i zienin. Mollëzat e gishterinje kishin nisur t'i skuqeshin. Shesnin po e mbulonte muzgu, si një pluhur i trashë ngjyrë hiri, që vinte duke u errësuar. Vetëm kafeneja ishte ndriçuar. Nga minarja dëgjohej zëri i përgjumur i një hoxhe. Bënte gjithnjë vapë.

— Mot i poshtër! — tha prapë operatori.

Brenda ajri ishte i rëndë. Operatori shoi dri-

tat. Kërciti motori. Tufa e rrezeve që vinin nga kabina e vogël, përshkoi sallën dhe qëndroi në ekran. Nisi filmi. Pjetri vuri duart mbi tastierë. U dëgjuan notat e para të polkës, që u përhapën anë e kënd sallës me ajër të rendë.

Prapë filmi i shkurtër me të Hollin e të Trashin, që sillnin kalin në shtëpinë e pasanikut, shoqëruar nga një polkë... prapë filmi me ata të dy, që shkojnë në hotel për të hyrë në punë si shërbëtorë, prapë po ai foks-trot... Po ato gjëra që kishte parë mbrëmë, parmbërëmë, para tri ditësh, pesë ditësh... Ajo monotonji ishte e tmerrshme, ajo lodhje ishte e padurueshme...

Vetëm filmin e Çaplinit e shikonte me interes, se zbulonte diçka të re, diçka të afërt. Aty shikonte sytë e Sharlotit, sytë e tij të mirë, të zgjuar të trishtuar.

Kur nisi seanca e fundit, i merreshin pak mendë. Veshët i gumëzhinin. Salla kishte disa njerëz të shpérndarë aty-këtu. Ndonjë i dehur, dy-tri endacakë nga ata që flinin rrugëve dhe që vinin e rrinin në kinema deri në mesnatë, dhe zoti Malo, që kishte marrë një prostitutë të re dhe rrinte gjithnjë në llozhën atje, në fund të sallës.

Më në fund doli edhe një herë fjala «The end» e njerëzit u ngritën. Operatori hyri në sallë dhe nxori endacakët që flinin kutullaç sipër karrigeve. Pjetri nuk kishte lëvizur nga vendi. Shikonte ekranin e bardhë, të heshtur. Nuk kishte as fuqi të ngruhej. Krahët e duart nuk i ndjente fare. Ato i vareshin pa jetë. Veshët gjithnjë i gumëzhinin. I përzihej. Në gojë kishte një shije të idhët...

U ngrit me zor dhe filloi të ecte në mes të radhëve të zbrazura, duke u mbajtur te karrigjet.

Para vetes pa zotin Malo, që doli i fundit bashkë me prostitutën e re. Operatori goditi diçka me shqelma, që Pjetri nuk e mori vesh se ç'qe. Dëgjoi që ai përsëriti prapë fjalën «i poshtër».

Në mendjen e mjegulluar të pianistit përzireshin meloditë e polkës, të fokst-trotit dhe të mazurkës së dëgjuar në Mulen Ruzh. Notat e tyre përplaseshin me njëra-tjetërën, kacafyteshin pareshtur.

Në holl pa pronarin me tre shokë të tij. Ata kishin dalë nga kafeneja dhe tanë pregetishesin të shkonin pér të luajtur poker.

Pjetri eci edhe pak duke ju marrë këmbët. Njëri nga katër burrat e pa dhe u tha diçka shokëve. Ata kthyen kokat dhe nisën të qeshnin. Pianisti, i dërmuar, u mbështet tek muri, në hyrje të hollit. Aty ishte vetëm një perde dhe ai u rrëzua përtokë me zhurmë. Në holl plasi gazi i madh. U ngrit me zor në një krah. Vuri dorën pér t'u mbajtur tek një karrige, por ajo ishte me tri këmbë dhe Pjetri bashkë me karrigen u përplas përtokë. Në holl buçiti prapë një gaz i madh. U ngrit me zor në këmbë. Nuk shihte fare para vetes. Flokët i kishin zënë sytë. Futi dorën në xhep dhe nxori kreherin. Prapë ushtuan të qeshurat. Atë çast ai vuri re se, në vend të kreherit, kishte nxjerrë lapsin me të eilin shkruante notat. E futi në xhep, ngriti flokët me dorë dhe eci drejt hyrjes. Prapë i merreshin këmbët. Katër burrat qeshnin papushuar. Ai qëndroi para derës. Aty ishte një pasqyrë. Shikoi vëten në të. Dhe vuri re se sytë e tij u ngjanin çuditërisht syve të Sharlotit.

TE MUNDURIT

Malësorët qëndronin përballë të huajve. Ishin të shpërndarë mbi shpat, rrinin mbi gurë e shkëmbinj. Fytyrat i kishin kthyer ndaj armiqve dhe i shikonin ngultas, me vetulla të ngërthyera. Ndër duar mbanin pushkët.

Armiqtë rrinin të heshtur, kokulur, të topitur. Ajo mori e madhe prej njëmijë e pesëqind ushtarësh rrinte e ngjeshur dhe dukej si një njollë e stërmadhe ndryshku, shpërndarë mbi fushën e vogël, pranë malit të Boshit. Sipër tyre kishin zënë vend katërqind malësorët, që i kishin rrethuar dhe i kishin zënë rob.

Hijet ngarendnин тë heshtura dhe muzgu i gjatë i gushtit ishte i kaltër, i tejdukshëm. Nga maja e Boshit vinin rryma të freskëta ajri. Lumi i Shalës rridhete me potere, duke u përplasur nëpër guraçokët e bardhë.

Gjenerali i huaj rrinte i mbështjellë me kapotën e tij të rëndë, duke menduar gjëmën që i ndodhi brigadës së tij atë ditë vere të vitit 1915.

Pas tij kishin zënë vend oficerët. Edhe ata ishin të heshtur ~ herë shikonin ushtarët, që ishin

grumbulluar pas shpinës së tyre, herë gjeneralin e mbështjellë me kapotën e rëndë, që rrinte pa lëvizur. Disa prej tyre nuk kishin qenë në një mendje me gjeneralin për t'u dorëzuar dhe ta njih-nin veten të mundur, por ai s'ua kishte vënë veshin, se e dinte që, po të ndizte luftë me mësorët, ajo nuk do të përfundonte në fitim të tyre, pavarësisht nga epërsia numerike dhe pajisjet. Ai ua njihte trimëritë shqiptarëve dhe e dinte se brigada e tij do të shfarosej; kurse, duke u dorëzuar e duke u rënë në besë, kishte mundësi të shpëtonin dhe të largoheshin nga Shala pa pësuar asgjë të keqe.

Heshtja vazhdoi për një kohë të gjatë. Fituesit dhe të mundurit rrinin përballë njëri-tjetrit. Nga maja e Boshit vazhdonin të frynin rryma të freskëta ajri dhe lumi i Shalës rridhët me potere përmes guraçokëve të bardhë.

Malësorët nuk dinin ç'të bënin me atë masë të madhe ushtarësh. Nuk ishte e mundur t'i mbaje rob. Ku t'i shpinin? Ç'të bënin me ta?

U mblodhën dhe filluan të bisedonin me njëri-tjetrin. Të huajt i shikonin dhe heshtnin. Në sytë e disave dukej frika, në disa të tjerë një turbullim i madh, një pasiguri, ndërsa topitja, hutimi te të tjerët. Disa rrinin të ftohtë, të qetë, të nënshtruar. Gjenerali ishte më i tronditur se të gjithë, megjithëse përpiquej mos ta shfaqte. Muskujt e ftyrës i ishin ngurtësuar dhe ajo dukej e ftohtë, e bardhë, si një copë akulli, por, nën atë cipë akulli, ashtu si poshtë një lumi të ngrirë, endeshin ndjenja të turbullta, mendime të zymta, të ngarkuara me frikë, me turp. Kapotën e rëndë, të zbërthyer,

ja rrihte era e maleve dhe atij i shkonin mornica nëpër trup.

Malësorët vazhdonin të bisedonin. Ata shpreh-nin mendime të ndryshme. Flisnin ngadalë, pa u ngutur, i mendonin fjalët, pastaj i thoshin shko-qur, pa e ngritur zërin, pa bërë lëvizje me duart që shtrëngonin pushkët.

Disa thoshin që t'i mbanin peng ushtarët dhe oficerët armiq, derisa të ktheheeshin Mehmet Shpendi me tre shokët, që kishin shkuar në Cetinë për të biseduar me krajl Nikollën që të tërhoqte ush-trinë nga Shkodra e malësia; të tjerë ishin të mendjes të mbanin vetëm gjeneralin, se ushtarët nuk kishin as ku t'i strehonin, as si t'i ushqenin; di-kush ngulte këmbë se ata kishin rënë në besë dhe duheshin liruar që të ktheheeshin në vendin e tyre.

Ndër ata që ngulnin këmbë mós t'i lironin, ishte dhe një djalë i ri, rreth njëzet e tre vjeç, me një trup të imët, por të lidhur, fytyrë të hequr e sy të thellë, që fliste me zë të lartë, megjithëse më të moshuarit shpesh i thoshin: «Shuaje zanin». Atë e quanin Marash Deda.

Biseduan edhe disa minuta. Pjesa më e madhe ishte e mendimit që t'i lironin pasi t'u merrnin fjalën se do të largoheshin jo vetëm nga malësia, po edhe nga të gjitha tokat shqiptare.

— Ku ka fjalë e besë me armikun! — thirri Marashi.

— Shuaje zanin! — i tha një plak, që ishte pranë tij.

Djaloshi vuri re se vërtet kishte thirrur. Këtë e bëri pasi nuk donte që të huajt t'i linin të lirë. Nga ana tjetër, ai e kuptoi se ata kishin të drejtë, pasi nuk mund të mbanin atje njëmijë e pesëqind

ushtarë. Mirëpo atë çast diçka ju kujtua dhe tha prapë me atë zë të lartë:

— Atëhere të kërkojmë që të kalojnë nën pushkët tona.

Ky mendim i gjallëroi malësorët. Ata shikuan Marashin, pastaj njëri-tjetrin. Më pleqtë mbanin mend se të parët e tyre, kur zinin robër, vinin dy pushkë të kryqëzuara dhe i detyronin të huajt të kalonin nën to, për ta njojur veten të mundur.

Pak nga pak të gjithë e pranuan propozimin e Marashit. Djaloshi kérceu nga shkëmbi, mori dy pushkë dhe shkoi drejt të huajve. Qëndroi para gjeneralit. E shkoi një çast, pastaj vështroi oficerët dhe, pa humbur kohë, vuri qytat në tokë, rregulloi anash disa gurë që t'i mbanin, pastaj bashkoi dy tytat.

Të huajt e shikonin të heshtur dhe nuk kuptonin se çfarë po ndodhte. Marashi i preku edhe një herë pushkët për t'u siguruar që ishin vendosur mirë, pastaj tha:

— Do të largoheni prej Dukagjini, por më parë të gjithë duhet të kaloni nën pushkët tona.

Përkthyesi përktheu fjalët e malësorit. Zëri i tij ishte i lehtë, i thatë, pak i zvargur.

— Do të kaloni të gjithë, pa përjashtim, — shtoi pas pak Marashi, duke shikuar ngultas gjeneralin dhe oficerët.

U bë një heshtje e rëndë, e gjatë. Malësorët u grumbulluan para ushtrisë së huaj. Gjenerali uli sytë dhe shkoi dy pushkët që ngriheshin para tij. Ato ishin të gjata, kërcënuese. Ju dukën si një hark triumfi, që fitimtarët e ndërtuan para syve të tyre. Ai shkoi hapësirën në mes të pushkëve: ishte si një trekëndësh i ngushtë. Aty duhej të kalonin

ushtarët e tij, oficerët, ai vetë, me shpina të përkulura, nën sytë e malësorëve, që rrinin përballë tyre me pushkë në duar.

Një oficer i gjatë, që tërë kohën kishte ndukur mustaqet me dhëmbë, bëri një hap përpara. Ishte i skuqur në fytyrë dhe në faqen e djathëtë i rrihte një rremb. U mat t'i thoshte diçka gjeneralit, por ky ja bëri me dorë dhe oficeri u tërhoq prapa dhe ashtu, i skuqur, vazhdoi të ndukte mustaqet me dhëmbët e tij të verdhë.

Muzgu ishte shtrirë e qielli po humbiste shkëlqimet dhe po bëhej përherë më i bruztë. Era ishte bërë më e fortë, më e ftohtë. Lumi rridhëtë më me zhurmë përmes guraçokëve. Dy palët rrinin përballë njëra-tjetërës; në mes tyre ishin dy pushkët e kryqëzuara.

Gjenerali ktheu ngadalë kokën prapa. Shikoi oficerët, pastaj ushtarët. Fytyra e tij ishte gjithnjë e ftohtë, e ngurtësuar. Ai mori frymë thellë, pastaj pa folur, bëri një lëvizje të shkurtër, të shpejtë, në drejtim të dy pushkëve të kryqëzuara. Lëvizjen e tij e kuptuan të gjithë, megjithatë, asnjieri nuk luajti nga vendi. Të gjithë prisnin. Gjenerali u kthye, ju afrua një oficeri fytyrgjerë, me një blanë të gjatë në faqen e majtë dhe qëndroi para tij. E shikoi drejt në sy dhe ja bëri me kokë. Oficeri zuri të ecte me hap të ngadaltë drejt pushkëve. Para tyre qëndroi, i shikoi gjatë, pastaj theu gjunjët, uli kokën dhe me kujdes kaloi nën pushkët. Pasi doli në anën tjetër, qëndroi disa çaste ashtu me shpinë të përkulur dhe me vështrimin e ulur përtokë.

Pas tij filluan të kalonin të tjerët. Në fillim oficerët, pastaj ushtarët. Kalonin të heshtur. Një

herë dikush tha diçka, por disa zëra e bënë të heshtë menjëherë. Masa e madhe e ushtrisë së huaj u nda në dy pjesë dhe pjesa e parë vinte e rritej, ndërsa tjetra zvogëlohej pareshtur. Të mundurit ecnin drejt pushkëve, thyenin gjunjët, ulnin kokat dhe kalonin në anën tjetër.

Pas një copë here dy pjesët u bashkuan prapë në një të vetme. Në anën tjetër mbeti vetëm gjenerali. Ai nuk lëvizte dot nga vendi. Dukej sikur ishte kthyer në një trup pa jetë, në një statujë poshtëuese të të mundurit. Përballë tij ishin dy pushkët, ishin ushtarët e oficerët, ishin malësorët; në anën e tij nuk kishte njeri. Ai ndjehej i vemuar, i braktisur, fillikat në mes të atyre maleve të ashpra, të zymta të huaja.

Më në fund u shkëput nga vendi, duke bërë hapa të shkurtër, të rëndë. Nuk e ngrinte kokën lart. E dinte se në anën tjetër të pushkëve e shikonin ushtarët, oficerët e tij, e shikonin malësorët që e kishin mundur. Këpucët e rënda i têrhiqte bran nëpër tokën e fortë. Para pushkëve ai nuk qëndroi, por theu gjunjët dhe kaloi nën to, duke e lakuar trupin. Fytyra atë çast ju përcudnua nga një dhembje e menjëhershme. Pa kaluar mirë, deshi të ngrinte kokën, por cepi i kapelës i ndeshi në njerën tytë dhe ajo, si një dorë e hekurt, ja hoqi dhe ja hodhi në tokë. Ai bëri sikur nuk e vuri re këtë gjë, u ngrit në këmbë dhe shkoi drejt ushtarëve.

KOKA E GRUAS QE BUZEQESHTË

Arkeologu i huaj banonte në një shtëpi dykatëshe në të dalë të fshatit. Ajo ishte shtëpia e beut, të cilën ai e përdorte kur vinte aty për të kaluar ndonjë ditë. Në të nuk banonte njeri dhe beu ja kishte lëshuar arkeologut përsa kohë do të qëndronte në atë fshat për të bërë gërmime.

I huaji solli aty disa kuaj të ngarkuar me plakë dhe dy arka të mëdha dhe u vendos në atë shtëpi, të ndërtuar me gurë të përhimtë. Vuri disa llamba të forta petromaksi, një radio me bateri, që gjer natën vonë lëshonte mbi fshatin e fjetur zëra në gjuhë të huaj e tinguj muzike, solli dhe veglat e tij të punës dhe shumë libra. Ajo shtëpi e heshtur u gjallërua nga dritat e zërat. Fshatarët, sa herë kalonin andej, kthenin kokën dhe e shikonin si të ndrojtur. Kur dëgjoheshin fjalët dhe muzika nga radioja me bateri, ata mbanin vesh dhe thoshin: «Po çirret shtëpia e beut!»

Bashkë me arkeologun ishte edhe një burrë i shkurtër, me kokë të rrumbullakët e sy të futur thellë, që, siç dukej, ishte nga i njëjti vend, se të dy flisin atë gjuhë të pakuptueshme për fshatarët. Të dy banonin në shtëpinë e beut dhe aty

brenda nuk shkelte kurrë këmba e ndonjë vendasi.

Çdo ditë, arkeologu bashkë me ndihmësin e tij trupshkurtër shkonin te kodra në të dalë të fshatit dhe qëndronin me orë të tëra. Bënин matje, merrnin shënimë, gërmionin aty këtu me disa kazma të vogla dhe çdo copë gur a diçka tjeter që nxirrin nga toka, e fshinin me kujdes dhe e shikonin pér një kohë të gjatë me lentë të madhe. Fshatarët ishin të zënë me hallet e tyre dhe nuk pyesnin se çfarë kërkoni dy të huajt.

Kodra ishte vend i shkretë, i thatë, me shkurre të shëmtuara, të ulëta, që ngriheshin mbi dheun ngjyrë kafe, si tufa flokësh të shpupurit. Në një cep të saj, fare pranë kreshtës, duke shin disa gurë të mëdhenj, të vendosur njëri mbi tjetrin, si mbeturina të një muri, që dikur ngrihej në atë vend. Thuhej se para shumë shekujsh, aty ngrihej një qytet, që pastaj ishte zhdukur. Asnjeri nuk dinte më shumë. Një herë, në fushë, një fshatar kishte zbuluar me plorin e tij një rrasë, që diç kishte të shkruar. Meqë askush nuk dinte të lexonte, rrasën e mori gruaja e fshatarit dhe e shpuri në breg të lumbit pér të larë plaçkat. Me kohë shkronjat u shuan te rrasha që mbeti në breg të lumbit.

Një herë tjetër, një fshatar, duke hapur themellet e shtëpisë, gjeti dy qypa të vegjël. Për këtë u interesua një mësues i vjetër. I mori qypat dhe i vuri në një raft të shkollës, bashkë me disa gjëra të tjera të gjetura andej-këtej në atë zonë.

Pas disa ditësh që erdhi në fshat, arkeologu i huaj hapi fjalë se i duheshin disa punëtorë pér të gërmuar dheun, ku t'u thoshte ai. U mblodhën mjaft fshatarë të varfër dhe ai, pasi zgjodhi tetë

prej tyre, u tha se do të nisnin punën që të nesërmen.

I mori fshatarët dhe i çoi te kodra. Dy të huajt u treguan vendet ku do të gérmonin, duke i porositur që të punonin me kujdes të madh dhe çdo gjë që të gjenin, t'ua tregonin menjëherë atyre.

Kështu nisi puna në kodrën sipër fshatit. Çdo ditë, në mëngjez, fshatarët mblidheshin te kodra. Aty vinin dy të huajt veshur me çizme, me xhaketa lëkure dhe u tregonin ku të punonin. Pastaj ata shkonin nga një vend në tjetrin, udhëzonin, thërrisin, kur ndonjë gjë nuk ishte bërë si thoshin ata, mblidhnin çdo gjë që dilte në dritë, dhe e shikonin gjatë me thjerëzat e tyre të mëdha.

Fshatarët punonin të qetë, të heshtur. Ata nuk e kuptonin përsë u interesonte të huajve gërmimi që bëhej aty, dhe çfarë vlere kishin gjërat që nxirrin në sipërfaqe kazmat e tyre. E merrnin me mend se ata nuk kishin ardhur kot, se ato gjëra kishin vlerë, se ndryshe nuk do të harxhonian kohë e para dy njerëzit e ardhur nga viset e huaja, por hallet nuk i linin të thelloheshin më tutje.

Dy të huajt, sidomos arkeologu, ishin shumë të shqetësuar. Ndiqnin me vëmendje çdo gjë dhe diç prisnin me padurim. Megjithëse nuk kishte dalë ndonjë gjë e madhe, ata ishin të kënaqur dhe arkeologu shkruante vazhdimisht në letra të mëdha, bënte via e shenja dhe fotografi me një aparat të madh, të zi.

Mbrëmjeve, kur perëndonte dielli dhe dalëngadalë zbriste nata e marsit, punëtorët që punonin për arkeologun e huaj, linin veglat dhe shkonin

nëpër shtëpitë e tyre të lodhur, të heshtur. Rrallë shkëmbenin ndonjë fjalë më njëri-tjetrin.

Më i riu ndër ta ishte një djalë njëzetvjeçar, me një trup të gjatë e të hollë, me sy të mëdhenj, që kishin një shkëlqim të çuditshëm, e buzë të trasha. Quhej Bulin. Ai ishte jetim dhe jetonte fillkat në një kasolle të vogël në të dalë të fshatit, që fuste brenda erën dhe shiun. Prindërit nuk i mbante mend. E kishte rritur gjyshja, që kishte vdekur para tetë vjetësh. Që atëhere, megjithë trupin e tij të imët e atë fytyrë të hequr, si të një njeriu shëndetlig, Bulini kishte punuar në arat e beat ose si mëditës tek ndonjë fshatar i pasur.

Bulini ishte djalë i çuditshëm: ngrinte këngë që i këndonte vetë, i bënte gjethet, guaskat e arrave, degët e pemëve që të nxirrnin tinguj, që ai i bashkonte njëri me tjetrin, si një vandak i padukshëm, dhe atëhere lindnin melodi të bukura, si gurgullima e ujit të burimeve, si fëshfërima e gjethive, si kënga e zogjve. Fshatarët thoshin se Bulini edhe gurët i bënte të këndonin...

Nganjëherë Bulini merrte edhe rrënje pëmësh, sidomos rrënje bushi, dhe me to bënte llulla e cingarishte. Nuk ishin llulla të thjeshta: me një thikë të vogël, Bulini u jepte forma të ndryshme, madje nganjëherë i bënte si koka kafshësh, si trupi i një gruaje, si koka e një plaku me mjekëri. Ai vetë nuk e pinte duhanin, por ato llulla ua jepte pa para pleqve e burrave të fshatit dhe ata pinin duhan «me llullat e Bulinit», siç i quanin ata.

Kështu, po ta shikoje nga jashtë, ishte njeri i qetë dhe pak i vetmuar. Nuk i pëlqente të për-

zihej me shumë njerëz. Banonte në atë kasollen e vjetër, që fuste brenda shiun e erën, vishej me një palë rroba të vjetra, megjithëse i mbante pastër, dhe ushqehet si mos më keq, por në kokë i vlonin mendimet që i rriddhnin si një tufë e madhe bletësh. Shpesh ai ndjente se diçka i dridhet përbrenda. Çfarë ishte vallë? Ndonjë këngë, melodi, apo ftyrë, që ai ende nuk e kishte thurur, kënduar ose skalitur?

U gëzua shumë kur filloj punën me arkeologun e huaj. Më në fund do të kishte kafshatën e gojës të siguruar, se kohët e fundit kishte mbetur pa punë. Por ai njëkohësisht ishte i gëzuar, se i pëlqente ajo punë. I dukej se ishte punë e bukur, e ndryshme dhe me të papritura.

* * *

Një mëngjez — kishin dy javë që punonin me arkeologun — Bulini po punonte në një hended, që ishte i veçuar. Pak përtëj rrinte Nazifi. Ata gërmionin në heshtje. Qielli ishte i vrejtur, megjithëse dielli herë pas here ngrinte retë dhe shfaqej pér disa çaste. Frynte erë. Ajo vinte nga deti.

— Do të bjerë shi, — tha Nazifi duke ngritur kokën lart. Bulini nuk ju përgjegj. Atë ditë nuk kishte qejf pér të biseduar. Nuk kishte ndonjë arësye, por ashtu i ndodhët nganjëherë. Shikonte tokën e zezë, të ngjeshur dhe mendonte.

Arkeologu kishte ardhur disa herë pranë tyre dhe, me atë shqipen e tij të çalë, i kishte pyetur a kishin gjetur gjë. Ata kishin tundur kokën. Ai ishte larguar, por prapë ishte kthyer dy-tri herë

të tjetra. Bulini; sa herë fliste me dy të huajt, nuk i shikonte fare në fytyrë. Nuk qe grindur ndonjëherë me ta, por nuk i pëlqenin. Arkeologu i huaj kishte një fytyrë të shplarë, megjithëse me tipare të rregullta, mjekër katrore e sy të ftohtë, që nuk të ngjallnin fare simpati. Bulinit i vinte inat, kur arkeologu i huaj merrete gjërat që ai ose shokët e tij nxirrnin nga toka. E shikonte si i ndritnin sytë, si i kapte e i shtrëngonte si i babëzitur dhe i shpinte tek shtëpia e beut.

— Ky i huaji çdo gjë e merr për vete dhe me siguri e çon në vend të vet, apo jo? — kishte thënë disa herë Bulini, duke biseduar me shokët. Ata ngrinin supet dhe nuk e zgjatnin. Kishin hallet e tyre.

Teksa punonte ashtu në heshtje, i kredhur në mendimet e tij, Bulini vuri re se kazma i preku diçka të fortë. Kjo gjë e shkundi. La kazmën, u përkul dhe largoi dheun me dorë. Duart i prekën sipërfaqen e ftohtë të një gjëje prej mermeri. Shikoi përreth. Arkeologu ishte larg. Nazifi po punonte. U përkul edhe një herë dhe me dorë largoi dheun. Para syve u shfaqën tiparet e një gruaje. Ja balli, sytë, hunda dhe goja paksa e hapur. E shikoi i mahnitur. Para syve të tij rrinte, e mbuluar aty-këtu me dhé, fytyra e një gruaje, që po dilte në sipërfaqe pas qindra vjetësh dhe po shikonte prapë dritën me ata sytë e bukur dhe me gojën paksa të hapur.

U ngrit në këmbë gati i trembur. Dëgjoi disa zëra. Pa shikuar se kush foli, mbuloi me duart që i dridheshin fytyrën e gruas dhe ajo humbi prapë në mes të dheut. E mbuloi, me kujdes duke e ngjeshur tokën. Pastaj u ngrit dhe zur: të gërmonte në anën tjeter të kanalit.

Erdhi edhe një herë i huaji. Shikoi gërmimet dhe prapë pyeti a kishte zbuluar gjë. Bulini, duke u përpjekur të tregohej i shkujdesur, tundi kokën dhe vazhdoi punën i qetë, megjithëse e ndjente se i kishte nervat të tendosura dhe zemra i rrihet fort. Dëgjoi zhurmën e çizmeve të të huajit që u largua. Mori frysë i lehtësuar dhe shikoi buzagaz vendin ku ndodhej koka prej mermeri, që e kishte fshehur nga arkeologu i huaj.

* * *

Shiu vazhdonte. Në fillim nisi me rrëmbim dhe të gjithë pandehën se do të pushonte shpejt. Pastaj ai u bë më i shtruar dhe kishte ndonja dy orë që nuk reshtte. Punëtorët e kishin lenë punën qëkur. Bulini rrinte tek dera e kasolles dhe dëgjonte murmurimën e butë, të përgjumur të shiut dhe i dukej sikur dhjetëra zëra i pëshpërisnin diçka njëri-tjetrit. Në ajër ndjeheshin kundërmime të përziera, herë të athta, herë më të embla, por gjithnjë të forta. Bulinit i dukej se, kur binte shi, toka merrte frysë më fort dhe më lirisht. Vuri re se shiu nuk kishte ndër mend të pushonte. Mori një copë thes, e hodhi mbi kokë dhe u largua nga kasollja me hap të shpejtë.

Kanali ishte i mbushur me ujë, por vendi ku ai zbuloi e pastaj mbuloi gruan prej mermeri, ishte mbi një sap të vogël dhe aty ende nuk kishte arritur uji. Bulini shikoi përreth dhe hyri në kanal. Ndjeu se këmbët ju futën në baltë dhe uji i arriti deri afër gjurit. Preku tokën. Ajo ishte zbutur nga shiu dhe ai nisi ta largonte nga koka prej

mermeri. Ja, nisën tē duken tiparet e saj. Më nē fund ajo u zbulua fare. Mbi tē binte shiu dhe ajo fytyrë e bukur u mbulua nga currila uji, që i shkisnin nēpér ballë e sy, nēpér mollëza dhe, pasi qéndronin opak tek buzët e saj gjysmë tē hapura, zbrisnin poshtë mjekrës. Bulini e ndërpreu punën dhe e shikoi i habitur. Nga currilat e ujit u duk sikur ajo u gjallërua dhe po qante nga gëzimi që shihte përsëri dritë dhe që kishte pranë atë djalë me sy tē ndritshëm.

Bulini vuri buzën nē gaz nga ai mendim dhe fshiu ujin e shiut nga fytyra. Vuri duart anash, duke i futur sa më thellë, pastaj mblohdhi shuplakat nē formë kupe dhe e têrroqi nga vetja me sa fuqi që pat. Koka e gruas lëvizi nga vendi. Ai mori zemër dhe e shtoi forcën. Copa prej mermeri lëvizi më shumë, pastaj u shkëput nga dheu i lagët, duke lëshuar një zhurmë tē mbytur, që ngjante me një psherëtimë. Bulini pér pak e humbi ekuilibrin dhe u anua, por shtrëngoi këmbët e u kthyte nē pozicionin e mëparshëm. Shikoi disa çaste kokën, që mbante ndër duar. Ajo kishte pak qafë dhe asgjë tjetër. Bulini futi duart nē tokë, kërkoi rrëth gropës, por nuk gjeti asgjë. Koka ishte e shkëputur nga trupi, që kushedi ku gjendej. Vuri kokën nē një cep tē sopit tē vogël dhe me nxitim zuri tē mbulante prapë gropën e hapur. Pasi mbaroi punën, mori kokën ndër duar dhe ja shkundi currilat e ujit, që i ishin mbledhur nēpér fytyrë.

Hoqi me vështirësi këmbët nga balta dhe zuri tē ecte nēpér kanal, duke mbajtur ndër duar kokën prej mermeri. Para se tē dilte jashtë, hodhi sytë përreth dhe nuk pa njeri. Kërceu me kujdes dhe u nis drejt kasolles së tij. Shiu vazhdonte. Cū-

rrilat rriddhnin gjithnjë nëpër fytyrën e gruas prej mermeri. Atëhere ai hoqi thesin e vjetër, që e mbante mbi kokë, dhe e mbuloi që mos ta shikonte njeri.

Këmbët i futeshin në llonxha uji e në llucë. Por ai nuk qëndronte. Ishte i lagur, por ecte dhe padashur vinte buzën në gaz.

Tokën, pemët e barin e gjithshka tjetër përrreth i kishte mbuluar rrrjeta e imët e shiut dhe kudo dëgjohej murmurima e tij e butë, e gjatë, e pandërrerprerë, si një nanurisje që ndjell gjumin.

* * *

Ajo ishte para tij.' Bulini e kishte vënë sipër një stoli, në mes të kasolles, pranë kandilit të vogël. Ai rrinte përballë dhe e shikonte pa ja hequr sytë. Jashtë vazhdonte shiu. Fitili i kandilit kërciste. Bulini shikonte kokën e gruas së gdhendur në mermer.

Në mëngjez e kishte parë rrëshqitazi dhe shumë gjëra i kishin shpëtuar shikimit të tij. Pastaj ajo ishte e mbuluar nga dheu, që i fshihte shumë hollësi. Tani që ai e kishte pastruar, e shikonte më nge aty, brenda kasolles, tekxa nga jashtë vinte murmurima e butë e shiut. Koka ishte thuaçse fare e padëmtuar, përveç disa gërvishqeve të vogla në një cep të ballit dhe poshtë flegrave të hundës.

Drita e mekur e kandilit luhatej herë pas here nga era që depërtonte në kasolle, dhe lëshonte mbi fytyrën e gruas hije e drita që ndryshonin orë e çast. Këto lëvizje i jepnin asaj një gjallëri të çuditshme, e bënin të humbiste peshën prej guri, ja lar-

gonin ftohtësinë. Dukej sikur ajo merrte jetë për disa çaste, i bëhej e afërt, e dashur.

Bulini nuk ja hiqte sytë asnë çast, studjonte çdo tipar në vecanti, pastaj shikimi i tij përfshinte tërë fytyrën. Atij i bënte përshtypje çdo gjë tek ajo: sytë e rrumbullakët, balli i qetë e i lartë, valët e shtruara të flokëve të mbledhur pas zverkut, hunda e drejtë, e sidomos buzët gjysmë të çelura, me cepat pak të ngritur, që formonin atë buzëqeshje të ndrojtur, të çiltër, që i jepte dritë tërë fytyrës.

Bulini habitej pareshtur me vete: çfarë njeriu kishte qenë ai që e kishte gdhendur! Çfarë duarsh kishte pasur! Si kishte mundur ta shprehte tërë atë bukuri në një copë mermeri, duke bashkuar ato vija të drejta e në formë gjysmë harku!

Kush e kishte punuar atë kokë gruaje? Herë i bëhej si një mjeshtër i vjetër, që, në prak të vdekjes, kishte kujtar një grua të re, me të cilën ishte dashuruar që i ri, por nuk ishte martuar dot dhe, para se të vdiste, kishte dashur që fytyrën e saj ta bënte të përjetshme, pasi ishte vërtet një bukuri e rrallë; herë tjetër mendonte se atë kokë e kishte skalitur një i ri ditën që ishte martuar me atë grua të bukur, që gjithmonë ta kishte para sysh ashtu si kishte qenë atë ditë; ose i dukej se ishte punë e një babait artist për të kujtar të bijën, që kishte vdekur e re.

Këto mendime i silleshin në kokë orë e çast, megjithëse, në fund të fundit, nuk kishin ndonjë rëndësi të madhe: sido të ishte puna, ajo ishte aty e, duke kaluar shekuj, kishte ardhur deri tek Bulini; të vërtetën se cila ishte dhe kush e kishte bëré ndoshta nuk ishte në gjendje ta zbulonte askush.

Fitili i kandilit kërciste gjithnjë e më shumë.

Pastaj ai u shua. Në kasolle mbeti i ndezur vetëm vegimi i gruas që buzëqeshte.

Të nesërmen, qielli prapë u mbulua nga retë. Ato vinin që përtej detit shtëllunga — shtëllunga. Herë pas here binte një shi kokërrmadh, i vrullshëm, pastaj pushonte dhe qielli i larë shkëlqente. Pastaj prapë vinin re të tjera dhe shkarkonin mbi fushë e në kodra shi.

Dy të huajt ishin të shqetësuar e të mërzitur. Ecnin lart e poshtë e diç thoshin në gjuhën e tyre të pakuptueshme. Herë dukeshin se shanin ose mallëkonin dikë ose diçka, herë dukeshin sikur grindeshin njëri me tjetrin. Nja dy herë arkeologu i huaj erdhi pranë Bulinit dhe e shikoi ngultas. Djaloshi u turbullua dhe pyeti veten se mos donte gjë i huaji. Mos vallë e kishte parë njeri duke çuar në kasolle kokën prej mermeri dhe i kishte treguar atij?

Para se të bënin pushimin e drekës, arkeologu erdhi e u fut në kanalin ku ishte Bulini. Diç kërkonte. Bulini prapë u shqetësua, u mat ta pyeste, por, që të mos krijonte dyshime, nuk hapi gojë. Vazhdoi të gërmonte, duke u përpjekur të tregohej sa më i shkujdesur. Arkeologu kishte ardhur edhe herë të tjera në atë vend, ku punonte Bulini, por atë ditë djalit i dukej se ai dinte diçka, prandaj e kishte vështruar ashtu e prandaj kishte ardhur në kanal.

Teksa punonte, hodhi edhe një herë shikimin vjedhurazi nga grumbulli i vogël i dheut. Aty nuk dallohej asgjë. Askush nuk mund të dyshonte se

aty ishte hequr dheu e ishte marrë diçka. Ai ishte një sop i vogël si dhjetëra të tjerë, të shpërndara tutje kanalit që gérmonin fshatarët.

Kur u bë pushimi, Bulini doli nga kanali dhe u ul në një cep, sipër një guri të madh. Ca hapa më tej kishte zënë vend një fshatar i gjatë, me lëkurë të zeshkët e hundë të madhe. Ishte Veledini. Qe ulur këmbëkryq dhe para vetes kishte hapur një shami të madhe.

— Na, Bulin, ec e ha një kafshatë me mua, — i tha ai.

— Tani nuk më hahet, — u përgjegj djali.

— Leri nazet dhe hidhu e ha, — nguli këmbë fshatari dhe ja bëri me dorë.

Misérnikja kërciste në gojë. Bulini i kishte dhëmbët të fortë, megjithatë, hante ngadalë e rrinte i kredhur në mendime.

— E, o Bulin, nuk ta bluajnë dot misérniken mokrat që ke në gojë? — e ngacmoi Veledini dhe zuri të qeshte, duke zbuluar dhëmbët e tij të verdhë.

— Jo, jo, po ja që sot nuk paskam oreks.

— Ha, or derëzi, se je lodhur, — tha Veledini.

— Ama punë kjo jona. Rri e gérmo tërë ditën për t'i nxjerrë eshtrat tokës. Më duket vetja si varrmihës, sidomos kur shoh ata të dy sipër nesh.

— Thonë se janë gjëra të kushtueshme, — tha një fshatar që rrinte pak përtej.

— E di, or vëllaçko, — tha Veledini pa e shikuar, — ndryshe nuk do të vinte këtu ky çehrengry-suri, që më duket sikur e mbaj në shpinë bashkë me atë tjetrin, që më ngjan si m... i rrasur.

— Janë gjëra shumë të bukura dhe me vlerë, — tha pas pak Bulini, sikur fliste me vete.

Ju kujtua se një herë e kishte thirrur në shko-llë mësuesi. Aty i kishte treguar dy qypa të lyer me bojëra të ndryshme, që të linin gojëhapur. Në faqet e një qypi ishin pikturuar disa valltarë, burra e gra, që hiqnin valle të zënë përdore. Pak për-tej tyre, dy burra u binin fyejve. Bulini i kishte vështruar për një kohë të gjatë. I dukej sikur burrat e gratë nga një çast në tjetrin do të kërcenin nga faqet e qypit e do të hidhnin valle para syve të tij. Ai lëvizte qyppin në dorë dhe dukej sikur lëviznin valltarët: përkuleshin, hidheshin lart, thyenin gjunjët ose rrotulloheshin, siç bëjnë fshatarët në dasma. Ai kishte mbyllur sytë dhe atë çast dhoma e vogël e mësuesit ishte mbushur me avazet e fyejve dhe dyshemeja kërciste nën hapat e valltarëve.

— Mirë, o mirë, nuk them, të bukura janë, — foli Veledini, duke ju përgjegjur fjalëve të Bulinit, — po kush ua ka ngenë. Ne robtohemë dhe mezi mbushim barkun me bukë.

— Po të vjen inat kur këta të dy të huajt vijnë e marrin gjérat tonë, që i ka ruajtur toka jonë kushedi prej sa shekujsh. Kësaj i thonë grabitje! — u nxeh Bulini.

Veledini e shikoi i habitur. Nuk e kishte dëgjuar ndonjëherë të fliste ashtu atë djalë.

— Sa për këtë ke të drejtë, — tha ai. — Po kush të pyet këtu tek ne për këto gjëra, or vëllaçko. Shqipëria është bërë belik. Hajde nga anë e anës dhe merr ç'të duash dhe mos çaj b... për asnjeri.

Bulini pohoi me kokë. Velledini kishte thënë fjalë me vend. Ishte burrë i zgjuar ai, paçka se ishte ca gojështhurur. Bulini disa herë nuk ishte në një mendje me të, se ai ishte tepër i ashpër dhe çdo gjë

e shikonte me sy tē ftohtë. Megjithatë, Bulini mendonte se Veledini nuk ishte vërtet i tillë, vetëm sa fliste ashtu ligsht, se kishte zemër tē mirë dhe i donte gjérat e bukura.

Kur u ngritën tē punonin, Bulini vuri re se i dhimbte krahu i djathëtë dhe thuajse tërë kyçet i thernin. Kjo nuk i kishte ngjarë kurrë. Madje i merrshin edhe mendtë. Mendoi se kjo ishte diçka e rastit dhe nuk i vuri rëndësi. Hyri në kanal e zuri tē gërmonte gjithnjë i kredhur në mendime.

— C'ke, mor Bulin? — e pyeti Nazifi, pasi vu-ri re se ai lëvizte krahët me zor.

— Asgjë. Më merren pak mendtë.

— Që tani? — u habit Nazifi.

— Nuk më ka ngjarë kurrë.

Bulini vazhdonte tē punonte. Nazifi e shikoi gjatë, pastaj tha:

— Hidhi një grusht ujë fytyrës dhe férko damaрët e qafës.

— Do tē më kalojë.

Por Nazifi prapë nguli këmbë. Bulini la lopatën dhe njomi fytyrën. Férkoi edhe qafën. E ndjeu veten më mirë. Mori frymë i lehtësuar. Kyçet prapë i thernin.

«Po shkoj tē shlodhem disa minuta», tha Bulini dhe u ngjit në zgripin e kanalit dhe zuri tē ecte drejt një peme. Atë çast u dëgjuan disa zëra. Ai që-ndroi. Po nuk i flisnin atij. Dy tē huajt ishin pranë Nazifit dhe thërrisin e shanin në gjuhë tē tyre, du-ke lëvizur pareshtur duart.

Të gjithë lanë punën. Të huajt gati njehersh kërcyen brenda në kanal dhe e shtynë keqas Nazi-fin. Ai ra në mes tē ujtit dhe koka ju përplas në një cep guri, që ndodhej në një faqe tē kanalit. U dë-

gjua një klithmë e shkurtër, e fortë, si thirrja e një shpendi. Ajo u përhap në tërë kodrën, nën atë quell të mbushur me re të rënda.

— Si është puna? — pyetën disa zëra njehersh.

— Nazifi ka krisur padashje një qyp, — tha njjeri.

— Dhe ata e goditën si t'u kishte krisur qypin e nënës së tyre, — tha pa e ngritur zërin Veledini.

Dy të huajt vazhdonin të thërrisin dhe të lëviznin duart. Arkeologu mori në duar qypin e vogël prej balte, kurse ndihmësi i tij mori një grusht dhe e ja hodhi në fytyrë Nazifit, që mbante kokën në duar dhe ofshante.

Bulini mbeti i ngrirë në vend, me kokën kthyer nga kanali. Edhe të tjerët lanë punën e shikonin. Veledini u drejtua nga kanali, ku ndodhej Nazifi me dy të huajt.

— Çfarë do ti? — pyeti ndihmësi i arkeologut, duke e shikuar egër.

— Rrini e mos i bini në qafë Nazifit të gjorë, — tha Veledini, pa e shikuar dhe u hodh brenda kanalit dhe ju afrua Nazifit.

— Ikë, ti, kupton? — thirri arkeologu, duke tundur qypin e vogël që mbante në një dorë.

Veledini nuk ju përgjegj. Uli njërin gju në tokë dhe hapi kutinë e duhanit.

— Na, mo Nazif, vuri pak duhan plagës, — tha fshatari, duke parë gjakun që i kishte rrjedhur në-për qafën plot rrudha dhe i kishte stërpikur këmishtën.

Disa nga punëtorët lanë punën dhe ashtu si ishin, me kazma e lopata ndër duar, shkuan afër hendekut. Në mes të tyre ishte edhe Bulini, që nuk ja hiqte sytë Nazifit.

— Ky éshtë barbar, — thirri arkeologu dhe pastaj shtoi diçka në gjuhën e tij, duke folur shpejt.

Veledini rrinte gjithnjë i përkulur mbi fshatarin e plagosur. Në buzë të kanalit ishin fshatarët e tjerë të heshtur, të vrejtur.

Ndihmësi i të huajit u sul papritmas dhe e zuri për qafe Veledinin. Ky i dha një të shkundur kokës dhe u ngrit në këmbë. Pa e shikuar, mori kazmën e Nazifit, pastaj i tha duke folur në mes të dhëmbëve:

— Hë, deshe gjë?

U shikuau sy në sy. Veledini ishte i qetë, me gjithëse sytë i shkrepëtinin. Duart shtrëngonin fort bishtin e kazmës. U bë një heshtje e gjatë. Edhe Nazifi, me gjithë dhembjen që kishte, ngriti kokën dhe shikoi dy burrat, që rrinin përballë njëri-tjetrit brenda në kanal.

Arkeologu i foli diçka në gjuhë të huaj shokut të tij. Të dy ngritën kokën dhe shikuau fshatarët që rrinin në buzë të kanalit me kazma e lopata ndër duar.

Dolën nga kanali dhe u larguan me hap të shpejtë, pa kthyer kokën e pa thënë asnjë fjalë.



Kjo ngjarje nuk ju hoq nga mendja Bulinit të-rë ditën. Gjithnjë i dilte para sysh Nazifi me kokën e çarë. Kjo gjë e trondiste dhe ndjente një shtrëngim në zemër.

Pasi mbaroi punën, u kthye në kasolle dhe nuk lëvizi nga vendi. Në fillim pandehu se ndrydh-

ja i vinte nga ajo marrja e mendve dhe dhembja e kyçeve. Por tani e ndjente veten mirë dhe shkaku ishte ngjarja e Nazifit.

U shtri dhe vuri përpara kokën e gruas që buzëqeshte. Sytë i mbante të ngritur lart nga tavani i nxirë. Larg dëgjonte bubullimat dhe mendonte.

Nuk i flihej. Ishte i lodhur, por gjumi nuk e merrte. Nja dy herë e pushtoi një kapitje e ëmbël, por i hapi sytë shpejt dhe shikoi prapë tavanin e dëgjoi larg bubullimat.

Ndjeu të ftohtë. Gjymtyrët i ishin mpirë. U ngrit dhe bëri disa hapa nëpër kasolle.

Qëndroi para kokës së gruas. E shikoi i habitur, sikur po e shihte për herë të parë. Vuri re me kujdes tiparet e bukura dhe atë buzëqeshjen magjepsëse. U ul para saj. Atë çast nuk ndjeu as bubullimat, as lodhjen, asgjë tjetër. Sytë i mbante të mbërthyer tek gruaja e bukur.

Nuk kaloi shumë dhe prapë ju kujtua Nazifi me kokën e çarë. Në fillim desh ta largonte, i rrëmbyer nga bukuria e gruas që kishte përpara, por ai mendim e pushtoi të térin dhe ja largoi térë mendimet e tjera.

Pas disa minutash, kur shikoi kokën e gruas, provoi një ndjenjë tjetër: nuk ju duk aq e bukur e térheqëse. Ç'ishte ajo? Një copë gur i lëmuar, i ftohtë, pa jetë. Vërtet ishte punuar bukur dhe ajo buzëqeshja e lehtë të vinte në mendime, por, sidoqoftë, ishte gjithnjë një copë e ftohtë mermeri. Ajo kurrë nuk mund të krahasohej me kokën e një njeriu të gjallë, qoftë edhe të çarë, qoftë edhe të mbuluar nga gjaku...

Filloi prapë të ndjente therjet e kyçeve. Bubu-

llimat oshëtinin diku larg, si një vargan qerresh, që ecën mbi kalldrëm. Ashtu e zuri gjumi.

Pa në endërr kokën që i buzëqeshte, ajo u dy-fishua, pastaj u bënë tri kokë, pesë, tetë, një numër i madh kokash, që vinin rrrotull, i buzëqeshnin, i ngërdhesheshin dhe pastaj i largoheshin, i mblidheshin kutullaç dhe e zinin për fytì tërë kokat prej mermeri. Pastaj nga larg erdhi një kokë tjetër e madhe e kuqe: ishte koka e Nazifit. Kokat prej mermeri shkuan diku larg, u vunë në radhë, u ngulën si-për disa hunjve të lartë dhe qëndruan aty. Një dorë e bardhë zuri kokën e Nazifit: ja dora u bë e kuqe prej gjakut. Tani ishin të kuqe edhe koka, edhe dora. Kjo dorë e shtyu kokën e Nazifit me sa fuqi që pat. Ajo shkoi dhe rrëzoi kokën e parë prej mermeri, pastaj të dytën, të tretën, të pestën, të tetën...

* * *

Në gjumin e lehtë të mëngjezit hyri një zë burri. Ai thërriste emrin e djaloshit.

Bulini hapi sytë. Zëri u dëgjua prapë. Ai nuk e njuh. Ishte i përgjumur. Kishte fjetur keq dhe kishte bërë një gjumë të trazuar, me endërra të këqia, të llahtarshme.

— Ende nuk je zgjuar? — thirri prapë zëri i mëparshiëm. Atë çast u hap dera e kasolles.

Bulini hapi sytë, i habitur. Ishte Nazifi. E shikoi një copë herë pa folur dhe zemra i rrahu fort. I erdhën ndër mend endërrat e asaj nate që sapo kishte mbaruar. Apo ende nuk kishte mbaruar.

— Ç'ke që më vështron ashtu? — u habit Nazifi dhe nxori nga xhepi kutinë e duhanit.

Bulini e shikoi pa folur. Kokën e kishte lidhur me një copë peshqir të vjetër. Në mes të buzëve mbante bishtin e një cigareje, që ishte aq e vogël, sa dukej sikur do t'i digjte buzët.

— Sa është ora? — tha më në fund Bulini.

— Nuk e di, — tha qetë-qetë Nazifi, duke dredhur cigaren, — po të tjerët kanë filluar punën qëkur.

— Po ti? — pyeti Bulini.

Nazifi nuk u përgjegj menjëherë. Vazhdoi të dridhte cigaren më nge. Bulini shikoi gishtat e tij të trashë, të zeshkët, që mbanin letrën e bardhë dhe e vërtisnin për të mbledhur në të duhanin.

— Ai i huaji më tha se nuk do të punoj më aty, — tha Nazifi dhe zuri të kafshonte me dhëmbët e tij të verdhë letrën e bardhë.

Bulinit ju kujtua èndërra.

Nazifi tha përsëri:

— Po ti ke fjetur shumë. Tani është vonë.

— Kam bërë gjumë të keq.

— Edhe unë nuk kam mbyllur sy prej plagës.

— Si tha këto fjalë, vuri dorën padashje tek peshqiri, që i mbështillte plagën.

Bulini nuk dinte ç'të bënte. Megjithatë, u vesh dhe doli në oborr për të larë fytyrën. Kur u kthyesh prapë brenda, duke u fshirë me një shami të madhe, e gjeti Nazifin para kokës prej mermeri, duke e vështruar i habitur. Ishte ulur dhe dy kokat rrinin pranë e pranë.

Bulini qëndroi tek praku si i gozhduar në vend. Shikoi dy kokat: atë të Nazifit dhe kokën prej mermeri të gruas. Mbylli një çast sytë: në mendje i ka-

luan copa èndërrash. I hapi menjëherë sytë. Shikoi para vetes prapë dy kokat: më pranë tij ishte ajo e Nazifit, e mbështjellë me copën e peshqirit të vjetër. Duke thithur cigaren, ai lëvizi dhe ajo e zuri fare kokën prej mermeri. Tani dukej vetëm copa e peshqirit të vjetër.

Fshatari e ndjeu Bulinin dhe e pyeti:

— C'është kjo, mo Bulin?

— Asgjë, asgjë, — thà shpejt Bulini dhe nuk i erdhi mirë që Nazifi kishte parë kokën prej mermeri. U zbulua një e fshehtë, që ai kishte dëshirë ta ruante pér vete.

— Sa e bukur! — tha Nazifi. — Ku e more, Bulin?

Djali bëri sikur nuk e dëgjoi pyetjen. Nuk kishte dëshirë të fliste pér atë gjë. I tha Nazifit:

— Të tjerët në punë janë?

— Atje janë. Përveç Veledinit. Edhe atë e dëbuani. E pësoi i gjori nga unë.

Bulin u vrejt. I vinte keq pér të dy, se e din-te sa halle kishin.

— Po tani ç'do të bëni? — tha duke e shikuar Nazifin me sytë e tij të mëdhenj e të menduar.

— Nuk e di, — tha fshatari dhe prapë thithi cigaren. — Do të kërkojmë ndonjë punë tjeter, sa pér të mbajtur frymën gjallë.

Bulin pati përshtypjen se Nazifit nuk i erdhi mirë që ishte hapur kjo bisedë, se e preu në mes dhe pyeti duke bërë me shenjë nga koka prej mermeri:

— Ku e gjete?

Bulin tha:

— Atje.

Nazifi prapë:

— Dinë gjë ata?

Bulini:

— Jo.

Nazifi:

— Është shumë e bukur.

Heshtën. Nuk dinin ç'të thoshin. Secili mendonte për gjërat e veta. Bulini nuk vendoste ç'të bënte. «Të shkoj, apo të mos shkoj? Do të më përzënë, se jam vonuar. Sidomos sot, që janë të zemëruar edhe me Nazifin, edhe Veledinin e gjorë».

Një zë thirri nga jashtë:

— O Bulin!

Nazifi e njohu:

— Është Kasoja, — tha dhe e shikoi ngultas djalin. Ky, si i zënë në befasi, lëvizi nga vendi dhe e çoi kokën prej mermeri në një cep të kasolles. U largua nga vendi. Pastaj diç u kujtua, mori copën e thesit dhe ja hodhi përsipër. Vuri re se ajo rrëshqiti dhe zbuloi një pjesë të flokëve. Bulini u mat ta vinte në vend, por atë çast u hap dera e kasolles.

Hyri Kasoja. Ky ishte një burrë rrëth të tridhjetave, me një trup shulak, flokë të shkurtër dhe sy të gjallë, që nuk i qëndronin asnje çast në një vend.

— Më dërgoi ai të pyes pse nuk ke ardhur sot në punë, — tha Kasoja dhe vuri buzën në gaz.

— U ngrita vonë, — tha Bulini si i zënë në faj. E dinte se arkeologu e çmonte punën e tij të kujdesshme dhe ju bë qejfi që kishte dërguar të pyeste për të.

— Si do t'ja bësh? — tha Kasoja.

Bulini ngriti supet:

— Nuk di si të them.:.

— Eja në punë, o derëzi, se nuk u bë kiameti që u vonove. Pastaj do t'i them edhe unë se ke qe-

në pak i pamundur mbrëmë, — tha Kasoja, duke u përpjekur të tregohej sa më i përzemërt.

Bulini vuri re se ai hidhte sytë përreth. Shikimi i tij qëndroi tek copa e thesit që mbulonte kokën. E shikoi disa çaste dhe nuk tha gjë. Bulini u shqetësua. Kasoja ishte njeri i dyshimtë dhe shumë fshatarë nuk i besonin. E kishin parë disa herë duke biseduar sy më sy me beun. Madje thoshin se ai kishte hyrë edhe në atë shtëpinë me gur të përhimtë. Qëkur kishte ardhur në fshat arkeologu i huaj, Kasoja ishte bërë kryepunëtor. Shpesh e shikonin duke biseduar me ata të dy dhe askush nuk e dinte se ç'flisnin. Të gjithë thoshin se ai vente e u tregonte atyre çdo gjë që ndodhë dhe çdo gjë që dëgjonte.

Kason nuk e donin. «Eshtë si puna e gjarpërit, — thoshin punëtorët, — nuk i tregon kurrë këmbët».

— Hë, si thua, do të, vish, apo jo? — pyeti Kasoja duke e shikuar Bulinin.

— Mirë, po vij, — tha me të shpejtë djali. Ishte i shqetësuar për punën e kokës prej mermeri dhe donte që ta largonte Kason nga kasollja sa më parë.

Duke dalë, Kasoja ju kthyte Nazifit, që nuk kishte hapur gojë fare:

— Edhe puna jote do të rregullohet. Mos u bëj merak. Do të flas unë me ta. Ti je njeri halleksi dhe nuk mund të rrish pa punë, se fëmijët duan të hanë. Ç'ke ti, do të flas unë.

Zunë të ecnin me hap të shpejtë. Bulini ishte gjithnjë i shqetësuar. Ishte i sigurtë se Kasoja diçka kishte parë brenda në kasolle. I kujtohej shikimi i tij, kur qëndroi tek copa e thesit që kishte rrëshqitur, duke zbuluar pak flokët e gruas që buzëqesh-

te. Kishte ndjekur me vëmendje Kason, kur kishin dalë prej kasolles. Ai nuk kishte kthyer kokën an-dej dhe kjo sikur e qetësonte. Megjithatë, dyshonte, pasi kishte dëgjuar që ai ishte dhelËpër e vjetër.

Rrugës thuajse nuk folën fare. Arritën te koda. Bulini nuk mendonte më se çfarë do t'i thoshin të huajt. Mendjen e kishte gjithnjë te koka prej mermeri.

Kasoja shkoi e foli me arkeologun. U kthye shpejt dhe i tha Bulinit të fillonte nga puna.

Djali zbriti në kanal, pështyu duart dhe zuri të gërmonte me kazmë.

• • •

Bulini po bënte pushimin e drekës, pështetur pas një peme. Oreks nuk kishte. Ndjehej i lodhur. Mbante sytë të myllur dhe mendonte. Përreth ishte qetësi. Fshatarët rrinin të heshtur.

— Këtu qenke, Bulin? — foli dikush.

Ai hapi sytë me përtim. Ishte Fotoja, një fshatar me mustaqe të mëdha e shpatulla të gjera. Mbante në dorë një gavetë.

Bulini nuk ju përgjegj. Mbylli sytë. Dëgjoi hapat e fshatarit.

— Mos ka qenë gjë Kasoja tek ti sot? — pyeti Fotoja.

Bulini hapi sytë. Para tij qëndronte fshatari me gavetë në dorë.

— Pse pyet? — tha Bulini dhe e shikoi pak i shqetësuar.

— Dëgjova se diç i tha të huajit për ty...

— Çfarë i tha?

— Nuk e dëgjova mirë. Isha futur thellë në kanal dhe ata nuk më panë. Kasoja seç kishte parë tek ti dhe ja tha atij të gjatit. Po nuk e mora vesh mirë, se fliste nën zë.

Bulini u ngrit më këmbë me një frysme, si ta kishte goditur njeri. E shikoi i tronditur fshatarin.

— Po ti, pse bëhesh kaq merak?

Bulini nuk u përgjegj. Qëndroi disa çaste në mëdyshje. Papritmas u largua dhe zuri të zbriste kodrën.

— O Bulin, Bulin, — e thirri dikush nga prapa. E kupto se nuk ishte zëri i Fotos. Kush e thi-rrri? Kasoja, apo ndonjë nga të huajt? Nuk e dinte. Tani nuk kishte më asnjë dyshim. Kasoja i kishte treguar arkeologut se në kasollen e tij kishte parë diçka të dyshimitë, diçka që kishte të bënte me gërmimet.

Bulini ecte gjithnjë e më shpejt. Ende nuk kishte vendosur se ç'do të bënte. Mendime të ndryshme i vërtiteshin në kokë.

Nja dy herë ktheu kokën për të parë në e ndiqnin. Nuk pa njeri.

Hyri në kasolle. Aty çdo gjë ishte si e kishte le-në në mëngjez. Koka prej mermeri ishte gjithnjë e mbuluar me copën e thesit që kishte rrëshqitur anash.

Qëndroi disa çaste në mes të kasolles. U mendua. Me një lëvizje të shpejtë ju afrua gruas. E zbuloi. Ajo i buzëqeshi. Kjo e tronditi më shumë se herët e tjera. E mori ndër duar. Pastaj i vuri për-sipër copën e thesit dhe e mbuloi mirë.

Doli nga kasollja pa e myllur derën. Qëndroi një çast në oborr, se ju duk që dëgjoi zhurmë hapshe dhe zëra.

U fsheh pas një kaçubeje me trëndafila të egër, që ishin pértej kasolles. Qëndroi pa lëvizur, duke mbajtur ndër duar kokën prej mermeri. Priti.

Nuk i kishin bërë veshët. Tani hapat dëgjo-heshin shkoqur. Ato po i afroheshin gjithnjë e më shumë kasolles.

Ishin dy të huajt dhe Kasoja. Pa folur u drejtuan tek dera. Aty qëndruan.

Dy të huajt seç thanë në gjuhën e tyre. Folën shpejt. Pastaj arkeologu ju drejtua Kasos.

— Ku éshtë ai?

— Nuk e di. Dera e hapur tregon se ka ardhur këtu para nesh.

— E ka marrë?

— Të shohim një herë brenda.

Hynë të tre në kasolle. Bulinit i rrihte zemra. Merrte frymë me nxitim. Nuk e kishte lodhur vrapi që kishte bërë, por ishte i ngashëryer.

«Nga të vete? Për ku të nisem, që të mos më gjejnë? Po me këtë ç'do të bëj? Nejse, të largohem një herë që këtej, pastaj shohim e bëjmë. Puna éshtë që ajo të mos bjerë në duart e tyre».

Truri i punonte me shpejtësi. Nuk kishte lëvizur nga vendi. Nuk duhej vonuar, se ata mund të dilnin nga një çast në tjetrin. Ndoshta do të kontrollonin rreth kasolles.

Rrëshqiti ngadalë tutje kaçubes. Degët e saj të mprehta ja çorën rrobat. Njëra ja grisi pak pulpën e majtë.

Pas kaçubes shtrihej një fushë e gjerë. Në fund të fushës ishte pylli. Nisi të vaponte, duke mbajtur para duarve kokën prej mermeri.

E thirri njeri, apo i bënë veshët? Ndoshta ata kishin dalë prej kasolles dhe po e shikonin duke

vrapuar fushës. Mendoi një herë të qëndronte e të shikonte prapa.

Nuk qëndroi. As nuk e ngadalësoi hapin. Vraponte sa i hanin këmbët. Toka ishte e lagur dhe aty-këtu me llonxha. Shpesh këmbët i futeshin në to. Uji kërcente anash me forcë.

Para se të futej në pyll qëndroi. Merrte frymë me mundim. Kraharori i ulej e i ngrivej më vërtik. Ktheu kokën: në mes të fushës pa tre njerëz që vraponin drejt tij. I njohu: ishin dy të huajt bashkë me Kason. Eenin pranë njëri-tjetrit. Kasoja mund të vraponte edhe më shpejt, se ishte i fortë, por nuk donte të ndahej nga arkeologu, që vraponte më mundim, pasi ishte burrë i thyer.

Bulini shikoi pyllin. Ai ishte i dendur, megjithëse jo i madh. Të fshihet aty, apo të vazhdonte më tej? Çfarë vinte pas pyllit? Ishte një luginë e bukur dhe e thellë. Nga perëndimi vinte një fushë e vogël, pastaj ishte një e tatëpjetë dhe në fund të saj shtrivej deti. Nga lindja, përtej luginës, kishte kodra të tjera. Djalit ju kujtua se tek një kodër ishte një shpellë. Ai kishte qenë disa herë aty, pasi tek hyrja e saj ishte një shkurre bushi dhe me rrënjet e saj ai bënte llullat. Vendosi të shkonte atje. Rru-ga ishte e largët, por atje do të fshihet mirë.

Tërë këto gjëra i mendoi shpejt. Pa humbur kohë i ktheu shpinën fushës dhe u fut në pyll.

Në fillim harroi se po e ndiqnin dhe zuri të ecët ngadalë, sikur kishte dalë shitetje. Hidhte sytë anash i qetë. Pylli i bënte shumë përshtypje. Kishte një bukuri magjepsëse, që nuk e gjeje në asnje vend tjetër. Zhurma e pemëve, lojrat e dritës dhe të hijes, gurgullima e vijave të ujit, kënga e zogjeve,

gjithshka e tērhiqtë dhe e bënte pér vete. Merrte frymë me tērë mushkëritë dhe shikonte me sy tē etur atë botë, që ngjasonte me një ambient përralle.

Kjo zgjati disa çaste. Ai u shkund. Zuri tē vraptonte, duke ecur nēpér shtigjet e ngushta tē pyllit. Kalonte shpejt nga drita nē hije dhe nga hija nē dritë. Kjo ja lëbyrte sytë dhe nē tē njëjtën kohë i shkaktonte një ndjenjë ngazëllimi fëminor.

Në tē dalë tē pyllit qëndroi para një vije uji. U përkul tē pinte. Kokën prej mermeri nuk e hoqi nga duart, se ndruhej mos e harronte, ose mos ja merrte kush.

Duke rufitur ujin, dëgjoi zërat e tre burrave. Ata kishin hyrë nē pyll. Zërat kalonin pértej pemëve, me gjethe tē reja dhe vinin deri tek ai tē pérziera. Bulini nuk kuptoi se ç'thoshin.

U ngrit dhe, pa bërë zhurmë, zuri tē ecte. Nuk vraptonte që tē mos tērhiqtë vëmendjen e tyre. Duke shikuar një zog që u ngrit fluturim, këmbët shkelën disa degë tē thara, që kërcitën. Kjo gjë do t'u tregonte atyre se ku ndodhej ai. Shpejtoi hapin. Pemët filluan tē rralloheshin. Kjo donte tē thosh-te se pylli po mbaronte. Ai eci edhe pak.

Zuri tē vraptonte tek fusha që ishte sipér luginës. Tani ndjehej mirë, i frekët, sikur atë çast kish-te nisur tē vraptonte. Këmbët fluturonin mbi barin e njomë tē fushës. Bulini merrte frymë me gojën e hapur dhe ecte pérpara. Në duar mbante kokën e gruas që i buzëqeshte.

Ktheu kokën prapa: po afroheshin siluetat e tre burrave. Ata e kishin parë dhe me siguri do tē vinin drejt tij.

Arriti fundin e fushës. Pértej saj niste tatëpjetë dhe poshtë ishte deti.

Aty qëndroi dhe mori frymë thellë. Koka e gruas ishte gjithnjë pranë tij.

Tani duhej vendosur. Përpara ishte deti. Prapa ndjekësit. Era ja rrihete ftyrën. Në buzët e thara ndjente shijen e njelmët të kripës.

Duke shikuar anash, vuri re një sop poshtë tatëpjetës. Aty ngrivej një pemë e re, e drejtë, me gjethë që lëviznin orë e çast nga era, si të ishin të shqetësuara. Sop është i bukur, i mbuluar me bar dhe gati i sheshtë në majë. Po sikur...

Ai mendim e gjallëroi. Nuk kishte rrugë tjetër, para ishte deti, prapa ndjekësit.

Zuri të ekte drejt sopit. Këmbët e bënин tokën e tharë nga era që të rrëshqiste poshtë. Me një kapërcim u ngjit sipër sopit. E mbështeti kokën e gruas tek trungu i pemës me ftyrë të kthyer nga deti.

Zuri të kërkonte përreth. Mori dy copa dru. Njëra ishte e mprehtë. Nisi të gërmojë dheun me vrull. Druri ngulej pa vështirësi. Hoqi barin duke marrë edhe dheun nën të. Disa çaste punoi me drurin, pastaj nisi me duar.

Punonte me ngulm, megjithëse ndjente përbrenda një boshillëk, që vinte duke u bërë gjithnjë më i madh.

Gërmoi pa u ndaluar. Shikoi gropën. Tani ajo mjaftonte për të futur në të kokën prej mermeri.

Futi kokën prej mermeri në gropën e pòrsahapur. E mbështeti ngadalë në tokën e butë, të lagështitur. Pastaj hodhi me nxitim dheun përsipër, e ngjeshi mirë, që mos të dyshonte njeri se aty ishte fshehur diçka.

U ngrit në këmbë. Shikoi gropën. Dëgjoi fëshfëritjen e gjetheve, që tregonin se pranvera ishte pranë. Pastaj **mbushi kraharorin** me ajër dhe u nis tatëpjetë, duke vrapiuar drejt detit.

P E R M B A J T J A

Faqe

Të shtunën pas dite	3
Pantomimë	85
Rrugë të mbarë, Dizi!	48
Monolog	58
Heshtja	72
Në aneks	80
Dhoma e errët	88
Parmenda dhe pushka	95
Sytë e Sharlotit	104
Të mundurit	114
Koka e gruas që buzëqeshte	120

